



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

RAPORTI I STABILITETIT FINANCIAR

Numër | 09

Korrik | 2016

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Raporti i Stabilitetit Financiar

Numër 9

BOTUES © Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Departamenti i Analizave Ekonomike dhe i Stabilitetit Financiar
33 Garibaldi, Prishtinë 10 000
Tel: ++381 38 222 055
Fax: ++381 38 243 763

Faqja e internetit www.bqk-kos.org

Adresa elektronike economic.analysis@bqk-kos.org

KRYEREDAKTOR Arben MUSTAFA

REDAKTOR Albulena XHELILI

AUTORË Arta NUSHI
Taulant SYLA
Zana GJOCAJ

REDAKTOR TEKNIK Butrint BOJAJ

SHKURTESAT:

AJN	Asetet e Jashtme Neto
APR	Asetet e Peshuara ndaj Rrezikut
ASK	Agjencia e Statistikeve të Kosovës
ATM	Bankomatë (<i>anglisht: Automated Teller Machines</i>)
ATP	Agjensionet për Transferimin e Parave
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQE	Banka Qendrore Evropiane
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CIS	Commonwealth of Independent States
DST	Të Drejtat Speciale të Tirazhit
EJL	Evropa Juglindore
EQL	Evropa Qendrore dhe Lindore
FKPK	Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
HHI	Indeksi Herfindahl-Hirschman
IHD	Investimet e Huaja Direkte
IMF	Institucionet Mikro-Financiare
KJP	Kreditë joperformuese
KMA	Kthimi Mesatar në Asete
KMK	Kthimi Mesatar në Kapital
KNK	Kthimi në Kapital
KTD	Korporatat Tjera Depozituese
MEF	Ministria e Financave
MNI	Margjina Neto e Interesit
OJSHEF	Organizatat Jofitimprurëse në Shërbim të Ekonomive Familjare
POS	Pika të Shitjes (<i>anglisht: Point of Sales</i>)
pp	Pikë Përqindje
PPT	Përgjegjësia ndaj Palës së Tretë
PTK	Posta dhe Telekomit i Kosovës
RLI	Indeksi i Sundimit të Ligjit (<i>angl.: Rule of Law Index</i>)
TMK	Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

Vërejtje: Përdoruesit e këtyre të dhënave kërkohen të citojnë burimin.
 Citimi i sugjeruar: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (2016),
 Raporti i Stabilitetit Financiar Nr. 9, Prishtinë: BQK.
 Çdo korigjim i nevojshëm bëhet në verzionin elektronik.

PËRMBAJTJA:

1. Fjala hyrëse e Guvernatorit -----	13
2. Përmbledhje -----	15
3. Eurozona dhe Ballkani Perëndimor -----	19
4. Ekonomia e Kosovës -----	27
5. Sistemi Financiar i Kosovës-----	34
5.1. Karakteristikat e Përgjithshme -----	34
5.2 Ekspozimi ndaj sektorit të jashtëm -----	35
6. Sektori Bankar i Kosovës -----	39
6.1 Struktura e Sektorit Bankar -----	39
6.2. Aktiviteti i Sektorit Bankar -----	40
6.3. Performanca e Sektorit Bankar -----	56
6.4 Rreziqet e Sektorit Bankar -----	60
6.5. Analiza Stres-Test-----	78
6.6. Infrastruktura Financiare në Kosovë-----	83
7. Sektori Pensional -----	86
8. Sektori i Sigurimeve-----	89
8.1. Aktiviteti i sektorit të sigurimeve -----	89
8.2. Performanca financiare e sektorit të sigurimeve -----	92
9. Sektori mikrofinanciar dhe Ndihmësit Financiar-----	93
9.1. Aktiviteti i sektorit mikrofinanciar-----	93
9.2. Performanca e sektorit mikrofinanciar-----	97
9.3 Ndihmësit Financiar-----	99
10. Shtojca statistikore -----	100
11. Referencat-----	121

LISTA E FIGURAVE	19
Figura 1. Shkalla e inflacionit në eurozonë	19
Figura 2. Norma e kreditimit ndërbankar EURIBOR dhe norma e rifinancimit e BQE-së	20
Figura 3. Rritja vjetore e kreditimit dhe shkalla e KJP-ve	20
Figura 4. Treguesit e profitabilitetit të sektorit financiar në vendet kryesore të eurozonës	20
Figura 5. Rritja vjetore e kredive dhe depozitave në vendet e Ballkanit Perëndimor	21
Figura 6. Norma e këmbimit të euros ndaj valutave kryesore	21
Figura 7. Struktura e aseteve të PCH-së	22
Figura 8. Ecuria e kredive dhe depozitave të PCH –së	23
Figura 9. Treguesit e efikasitetit të PCH –së	23
Figura 10. Struktura e aseteve të RBI-së	24
Figura 11. Ecuria e kredive dhe depozitave të RBI-së	24
Figura 12. Treguesit e efikasitetit të RBI-së	25
Figura 13. Struktura e aseteve të NLB Group	26
Figura 14. Ecuria e kredive dhe depozitave të NLB group	26
Figura 15. Treguesit e efikasitetit të NLB Group	26
Figura 16. Norma reale e rritjes së BPV-së,	28
Figura 17. Lëvizja e çmimeve të komponentëve kryesorë	28
Figura 18. Importet, eksportet dhe bilanci tregtar	29
Figura 19. Pranimet e remitencave	30
Figura 20. Struktura e investimeve të huaja direkte sipas komponenteve	31
Figura 21. Ecuria e tregut të letrave me vlerë	31
Figura 22. Shuma e shpallur dhe e ofertuar	32
Figura 23. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë sipas afatit të maturimit	32
Figura 24. Normat mesatare të interesit të letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës sipas maturimit	32
Figura 25. Raporti i mbulimit shumë e ofertuar/shumë e shpallur	33
Figura 26. Norma mesatare e interesit në letrat me vlerë të qeverive në Ballkanin Perëndimor	33
Figura 27. Asetet e sistemit financiar dhe sektorëve përbërës	34
Figura 28. Struktura e aseteve të sistemit financiar	34
Figura 29. Ndërmjetësimi financiar sipas sektorëve në Kosovë	34
Figura 30. Ndërmjetësimi financiar i sektorit bankar në vendet e Ballkanit Perëndimor	35
Figura 31. Struktura e aseteve në sektorin e jashtëm	36
Figura 32. Struktura e detyrimeve të jashtme	36
Figura 33. AJN-të sipas sektorëve financiarë	37
Figura 34. Ekspozimi i jashtëm sipas sektorëve financiar	37
Figura 35. Struktura e aseteve të sektorit bankar	39
Figura 36. Shkalla e koncentrimit në sektorin bankar	39
Figura 37. Struktura e aseteve të sektorit bankar	40
Figura 38. Asetet e sektorit bankar	40

Figura 39. Struktura e letrave me vlerë -----	41
Figura 40. Kontributi i sektorëve në rritjen e gjithsej kredive-----	41
Figura 41. Struktura e kredive sipas veprimtarisë ekonomike-----	42
Figura 42. Kreditë për sektorin e industrisë -----	43
Figura 43. Kreditë sipas veprimtarisë ekonomike -----	43
Figura 44. Struktura e kredive sipas afatit të maturimit -----	44
Figura 45. Kreditë sipas afatit të maturimit -----	45
Figura 46. Gjithsej kreditë dhe kreditë e reja -----	45
Figura 47. Kreditë e reja -----	45
Figura 48. Kreditë e reja sipas sektorëve-----	46
Figura 49. Kreditë e reja sipas sektorëve dhe qëllimit të përdorimit -----	46
Figura 50. Gjithsej kreditë, kreditë e reja, kreditë e paguara dhe kreditë e pakthyera-----	46
Figura 51. Ndryshimet e përgjithshme në ofertën kredituese dhe në kërkesën për kredi në gjashtë muajt e fundit-----	47
Figura 52. Pritjet e bankave rreth standardeve kreditore dhe kërkesës për kredi në gjashtë muajt e ardhshëm-----	47
Figura 53. Standardet e aplikuara kreditore për ndërmarrjet dhe pritjet e bankave për gjashtë muajt e ardhshëm-----	48
Figura 54. Standardet e aplikuara kreditore për ekonomitë familjare dhe pritjet e bankave për gjashtë muajt e ardhshëm-----	48
Figura 55. Kërkesa për kredi nga ndërmarrjet dhe pritjet për ndryshimet në gjashtë muajt e ardhshëm -----	48
Figura 56. Kërkesa për kredi nga ekonomitë familjare dhe pritjet për ndryshimet në gjashtë muajt e ardhshëm -----	48
Figura 57. Depozitat e sektorit bankar -----	50
Figura 58. Depozitat e ndërmarrjeve -----	50
Figura 59. Depozitat e jo-rezidentëve -----	50
Figura 60. Struktura e depozitave sipas afatit të maturimit-----	51
Figura 61. Depozitat e afatizuara -----	51
Figura 62. Norma mesatare e interesit -----	52
Figura 63. Normat e interesit në Kosovë dhe vendet e Ballkanit Perëndimor -----	52
Figura 64. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare -----	52
Figura 65. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve, sipas qëllimit-----	53
Figura 66. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve, sipas maturimit-----	53
Figura 67. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve, sipas veprimtarisë ekonomike-----	54
Figura 68. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare, sipas qëllimit -----	54
Figura 69. Norma mesatare e interesit në depozita-----	55
Figura 70. Norma mesatare e interesit në depozitat e ndërmarrjeve -----	55

Figura 71. Norma mesatare e interesit në depozitat e ekonomive familjare -----	55
Figura 72. Performanca financiare e sektorit bankar -----	56
Figura 73. Të hyrat e sektorit bankar -----	56
Figura 74. Të hyrat e interesit të sektorit bankar-----	57
Figura 75. Të hyrat e sektorit bankar -----	57
Figura 76. Shpenzimet e sektorit bankar -----	57
Figura 77. Shpenzimet e sektorit bankar -----	58
Figura 78. Shpenzimet e interesit dhe jointeredit sipas kategorive-----	58
Figura 79. Kreditë joperformuese dhe provizionet për humbjet e kredive -----	58
Figura 80. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar -----	59
Figura 81. Raporti shpenzime/të hyra -----	59
Figura 82. Harta e rreziqeve të sektorit bankar -----	60
Figura 83. Kreditë dhe depozitat e sektorit bankar-----	61
Figura 84. Raporti asete likuide 'gjithëpërfshirëse'/ detyrime afatshkurtëra-----	62
Figura 85. Rezervat e sektorit bankar -----	62
Figura 86. Hendeku i likuiditetit -----	62
Figura 87. Raporti KJP/gjithsejkreditë-----	63
Figura 88. Raporti KJP/gjithsej kreditë në Kosovë dhe në disa vende të Ballkanit Perëndimor	64
Figura 89. Gjithsej kreditë dhe KJP-të-----	64
Figura 90. KJP-të sipas veprimtarive ekonomike-----	64
Figura 91. Struktura e kredive sipas klasifikimit-----	65
Figura 92. Ecuria e kredive sipas klasifikimeve kreditore-----	65
Figura 93. KJP-të dhe provizionet -----	65
Figura 94. Koncentrimi i rrezikut kreditor -----	66
Figura 95. Kapitalizimi i sektorit bankar -----	66
Figura 96. Kapitali rregullator dhe APR-të-----	67
Figura 97. TMK në sektorin bankar në Kosovë dhe disa vende të Ballkanit Perëndimor-----	67
Figura 98. Leva financiare në sektorin bankar në Kosovë dhe disa vende të Ballkanit Perëndimor-----	67
Figura 99. Struktura e kapitalit rregullator -----	68
Figura 100. Struktura e kapitalit të klasit të parë-----	68
Figura 101. Struktura e kapitalit të klasit të dytë -----	69
Figura 102. Struktura e APR sipas peshës së rrezikut -----	69
Figura 103. Raporti i APR-ve ndaj gjithsej aseteve të sektorit-----	69
Figura 104. Pozicionet e hapura në valutë të huaj ndaj Kapitalit të Klasit të Parë-----	71
Figura 105. Kreditë dhe depozitat në valutë të huaj -----	71
Figura 106. Kreditë dhe depozitat e ndjeshme ndaj normave të interesit -----	72
Figura 107. Hendeku i aseteve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normave të interesit -----	72
Figura 108. ndeksi i përgjithshëm i stabilitetit të sektorit bankar -----	73
Figura 109. Kriteret përbërës të indeksit të stabilitetit të sektorit bankar-----	74

Figura 110. Asetet e sektorit pensional -----	86
Figura 111. Struktura e investimeve të sektorit pensional-----	86
Figura 112. Asetet e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës -----	87
Figura 113. Asetet e Fondit Slloveno-Kosovar të Pensioneve -----	87
Figura 114. Struktura e aseteve të sektorit të sigurimeve -----	89
Figura 115. Asetet e sektorit të sigurimeve -----	89
Figura 116. Struktura e aseteve të sektorit të sigurimeve -----	90
Figura 117. Detyrimet dhe kapitali i sektorit të sigurimeve -----	90
Figura 118. Bruto primet e arkëtuara -----	90
Figura 119. Struktura e primeve të shkruara bruto -----	91
Figura 120. Struktura e bruto primeve të shkruara të sigurimit 'jetë' -----	91
Figura 121. Dëmet e paguara -----	91
Figura 122. Primet e pranuar dhe dëmet e paguara -----	92
Figura 123. Treguesit e profitabilitetit të sektorit të sigurimeve-----	92
Figura 124. Asetet e sektorit mikrofinanciar-----	93
Figura 125. Struktura e aseteve të sektorit mikrofinanciar -----	93
Figura 126. Kreditë ndaj ekonomive familjare sipas afatit të maturimit-----	94
Figura 127. Kreditë e sektorit mikrofinanciar sipas veprimtarive ekonomike -----	94
Figura 128. Rritja e kredive të sektorit mikrofinanciar ndaj ndërmarrjeve -----	95
Figura 129. Kreditë ndaj ndërmarrjeve sipas afatit të maturimit-----	95
Figura 130. Lizingjet e sektorit mikrofinanciar -----	96
Figura 131. Struktura e lizingjeve të sektorit mikrofinanciar-----	96
Figura 132. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar -----	97
Figura 133. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar -----	97
Figura 134. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar -----	98
Figura 135. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar-----	98
Figura 136. Treguesit e kualitetit të portfolios kreditorë të sektorit mikrofinanciar -----	99

LISTA E TABELAVE----- 19

Tabela 1. Rritja reale vjetore e BPV-së në eurozonë -----	19
Tabela 2. Numri i institucioneve financiare -----	35
Tabela 3. Struktura e aseteve të sektorit bankar -----	40
Tabela 4. Struktura e detyrimeve të sektorit bankar -----	49
Tabela 5. Treguesit kyç të efikasitetit të sektorit bankar -----	59
Tabela 6. Tregues të kapacitetit të sektorit bankar-----	60
Tabela 7. Indeksi i përgjithshëm i stabilitetit të sektorit bankar-----	73
Tabela 8. Indikatorët e përdorur për vlerësimin e rëndësisë sistemike të bankave në Kosovë -	75
Tabela 9. Rezultatet e rëndësisë sistemike të bankave në Kosovë, sipas kritereve -----	77
Tabela 10. Përmbledhje e rezultateve të stres-testit: rreziku kreditor -----	81

Tabela 11. Përmbledhje e rezultateve të stres-testit: Rreziku i likuiditetit -----	82
Tabela 12. Pjesëmarrja e instrumenteve të pagesave në gjithsej transaksionet e SEKN-së, në përqindje-----	84
Tabela 13. Rrjeti i sektorit bankar -----	85
Tabela 14. Pjesëmarrja e vlerës së transaksioneve me kartela sipas terminaleve në gjithsej vlerën e transaksioneve me kartela -----	85
Tabela 15. Struktura e sektorit pensional-----	87

LISTA E KUTIVE ----- 22

Kutia 1. Performanca e grupeve kryesore bankare që operojnë në Kosovë-----	22
Kutia 2. Indeksi i stabilitetit të sektorit bankar -----	73
Kutia 3. Identifikimi i bankave me rëndësi sistemike në Kosovë -----	75

1. Fjala hyrëse e Guvernatorit

Ekonomia globale gjatë vitit 2015 u karakterizua nga zhvillime më të favorshme, ku kontribut mjaft të rëndësishëm kishte rikuperimi i ekonomisë së eurozonës. Masat e lehtësimit sasior të ndërmarrja nga Banka Qendrore Evropiane forcuan kërkesën e brendshme, e cila paraqiti shtytësin kryesor të rritjes ekonomike. Zhvillimet në eurozonë u reflektuan pozitivisht në ekonomitë e Ballkanit Perëndimor, të cilat në përgjithësi përshpejtuan ritmin e rritjes ekonomike. Presionet deflacioniste në Eurozonë vazhduan të jenë të pranishme edhe gjatë vitit 2015, duke parashtruar nevojën e vazhdim të masave të lehtësimit sasior. Zhvillimet e çmimeve në eurozonë vazhduan të reflektohen edhe në ekonomitë e Ballkanit Perëndimor, ku u regjistruan norma të ulëta të inflacionit.

Ekonomia e Kosovës gjatë vitit 2015, ngjashëm me zhvillimet në eurozonë dhe në vendet e rajonit, përshpejtoi ritmin e rritjes. Rritja e konsumit dhe investimeve të sektorit privat paraqesin faktorët me kontributin kryesor në rritjen ekonomike, përderisa norma e lartë e deficitit tregtar vazhdoi të ketë ndikim negativ në rritjen e ekonomisë së vendit. Lëvizjet e çmimeve të mallrave të importuara kanë vazhduar të diktojnë në masë të madhe ecurinë e nivelit të përgjithshëm të çmimeve në Kosovë, që në vitin 2015 u karakterizua me deflacion. Rritja e shpenzimeve buxhetore në linjë me kufijtë e përcaktuar nga rregulla fiskale, krahas rritjes së qëndrueshme të të hyrave buxhetore, vazhdon të mbajë deficitin buxhetor dhe borxhin publik në shkallë të ulët, gjë që reflekton stabilitet të financave publike në ekonominë e vendit. Kosova vazhdon të ketë një sistem financiar të shëndoshë, i cili përfaqëson një burim shumë të rëndësishëm të rritjes dhe stabilitetit të ekonomisë së vendit.

Sektori bankar ka shënuar përshpejtim të rritjes së kredimit, veçanërisht për ndërmarrjet, duke shërbyer kështu si një burim i rëndësishëm i financimit të rritjes së investimeve private gjatë vitit 2015. Ndër sektorët me rritjen më të lartë të kredive të pranuar ishin sektorët e bujqësisë dhe prodhimit, gjë që tregon për një orientim të kreditimit bankar drejt financimit të sektorëve potencialisht më produktiv të ekonomisë. Përshpejtimi i ritmit të rritjes së kreditimit reflekton përmirësimin e kushteve të kreditimit nga ana e bankave dhe rritjen e kërkesës për kredi nga ana e ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare. Ndikim të posaçëm në nxitjen e rritjes së kredive kishte zvogëlimi i theksuar i normës së interesit në kredi, e cila tani më ka zbritur në nivel të përafërt me mesataren e normës së interesit në vendet tjera të rajonit. Përshpejtimi i rritjes së kredive dhe përmirësimi i kushteve të kreditimit tregon se Kosova ka shënuar progres të rëndësishëm në lehtësimin e qasjes në financa, që paraqet një ndër parakushtet më të rëndësishme për të pasur zhvillim më të madh ekonomik.

Krahas zhvillimeve më të favorshme për sa i përket rritjes së kreditimit dhe lëvizjeve në strukturën e kredive, sektori bankar ka arritur të fuqizojë edhe më tepër qëndrueshmërinë e tij. Niveli i kapitalizimit të sektorit bankar ka shënuar rritje të mëtutjeshme, duke vazhduar kështu të ketë një normë mjaft më të lartë se sa minimumi i kërkuar rregullativ. Cilësia e portofolit kreditor, e cila edhe ashtu ishte mjaft e kënaqëshme, ka shënuar përmirësim të mëtutjeshëm. Norma e kredive joperformuese arriti nivelin më të ulët të regjistruar në vitet e fundit, duke vazhduar kështu ta mbajë sektorin bankar të Kosovës si sektorin me cilësinë më të mirë të portofolit kreditor në mesin e vendeve të rajonit. Sektori bankar i Kosovës vazhdoi të ketë shkallë të lartë të likuiditetit dhe ekspozim të ulët ndaj rrezikut të tregut.

Gjatë vitit 2015, sektori bankar vazhdoi të zgjerojë infrastrukturën, duke avancuar në këtë mënyrë kushtet për rritjen e efikasitetit të shërbimeve financiare. Rritja e numrit të pajisjeve si bankomatët dhe pikat e shitjes, së bashku me rritjen e numrit të llogarive bankare që shfrytëzojnë platformat e internetit, kontribuuan që të rritet vëllimi dhe vlera e transaksioneve të realizuara përmes sistemit ndërbankar të pagesave.

Për sa i përket zhvillimeve në komponentët tjerë të sistemit financiar, investimet e fondeve pensionale regjistruan kthim pozitiv gjatë vitit 2015, por më të ulët krahasuar me vitin paraprak si rrjedhojë e zhvillimeve në tregjet globale financiare. Institucionet mikrofinanciare vazhduan rritjen e aktivitetit kredidhënës, duke shërbyer si një burim i rëndësishëm i financimit të ekonomisë, sidomos për individët dhe ndërmarrjet e vogla. Zhvillime më pak të favorshme karakterizuan sektorin e sigurimeve, i cili gjatë vitit 2015 regjistroi një rënie të lehtë të vlerës së primeve të shkruara, përderisa performanca financiare e sektorit vazhdon të jetë e brishtë.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) mbetet e përkushtuar në zbatimin e objektivave të saj ligjore, ku stabiliteti financiar vazhdon të jetë objektivi primar. Vlerësimi i stabilitetit financiar dhe informimi i vazhdueshëm i publikut lidhur me zhvillimet e rëndësishme për stabilitetin financiar të vendit do të vazhdojnë të jenë prioritetet e rëndësishme për BQK-në.

Bedri HAMZA

Guvernator

2. Përmbledhje

Aktiviteti ekonomik në eurozonë gjatë vitit 2015 është rikuperuar, mbështetur kryesisht nga kërkesa e brendshme. Norma reale e rritjes ekonomike në eurozonë vitin 2015 ishte 1.7 përqind, krahasuar me normën e rritjes prej 0.9 përqind të shënuar në vitin 2014, gjë që tregon për përmirësim të mëtejshëm të aktivitetit ekonomik krahasuar me vitin paraprak. Gjatë vitit 2015, rritja ekonomike në eurozonë është mbështetur nga rritja e kërkesës së brendshme, që mund të atribuohet kryesisht ndikimit pozitiv që kishin masat e programit të lehtësimit sasior të ndërmarrë nga Banka Qendrore Evropiane (BQE). Për dallim nga viti 2014, kur ekonomitë e eurozonës u karakterizuan me rënie vjetore të kreditimit, në vitin 2015 eurozona shënoi një kthesë pozitive në aktivitetin kreditues, mbështetur kryesisht nga rritja e shënuar e kreditimit në Gjermani, Itali dhe Francë. Gjithashtu, sistemi financiar në eurozonë është përforcuar, përderisa treguesit kryesor të shëndetit financiar tregojnë për një përmirësim të nivelit të kapitalizimit, pozicion të kënaqshëm të likuiditetit, si dhe përmirësim të kualitetit të portfolios kreditore. Eurozona u karakterizua me presione të dobëta inflacioniste gjatë vitit 2015, përderisa shkalla mesatare vjetore e inflacionit të regjistruar ishte 0 përqind. Përforcimi i kërkesës së brendshme në eurozonë gjatë vitit 2015 është reflektuar pozitivisht në zhvillimet ekonomike të vendeve në Ballkanin Perëndimor. Gjatë kësaj periudhe, aktiviteti ekonomik në këtë rajon u karakterizua me rritje, mbështetur nga përforcimi i kërkesës së brendshme dhe kërkesës së jashtme. Në vitin 2015, rritja reale e BPV-së në Ballkanin Perëndimor vlerësohet të ketë qenë rreth 2.4 përqind. Çmimet e ulëta të naftës, energjisë dhe ushqimit në tregjet ndërkombëtare ndikuan edhe në nivelin e çmimeve në vendet e Ballkanit Perëndimor, ku norma mesatare e inflacionit vlerësohet të ketë qenë 0.9 përqind në vitin 2015. Sektori bankar në vendet e Ballkanit Perëndimor po ashtu u karakterizua me ecuri pozitive, e cila u reflektua në përmirësimin e indikatorëve kyç të shëndetit financiar. Politikat e lehtësuara monetare në vendet e rajonit rezultuan në rënie të kostos së ndërmjetësimit financiar, duke ndikuar kështu në rritjen e aktivitetit kreditues. Gjithashtu, në vitin 2015 kundrejt vitit paraprak, vendet në Ballkanin Perëndimor u karakterizuan me rënie të nivelit të kredive joperformuese.

Ekonomia e Kosovës në vitin 2015 ndoqi një ritëm të përshpejtuar të rritjes. Vlerësimet e BQK-së sugjerojnë se vlera nominale e BPV-së në vitin 2015 ka qenë 5.73 miliardë euro, që paraqet një normë reale të rritjes prej 3.5 përqind (1.2 përqind në vitin 2014). Rritja ekonomike gjatë këtij viti ishte rezultat i rritjes së kërkesës së brendshme, gjegjësisht konsumit privat dhe investimeve. Projektionet e BQK-së për vitin 2016 sugjerojnë se rritja ekonomike do të jetë 3.7 përqind. Në vitin 2015, niveli i përgjithshëm i çmimeve në Kosovë, shprehur nëpërmjet indeksit të çmimeve të konsumit, është karakterizuar me deflacion prej 0.5 përqind, krahasuar me inflacionin prej 0.4 përqind në vitin 2014. Kosova vazhdon të ketë pozicion të qëndrueshëm fiskal. Në vitin 2015, deficiti i përgjithshëm sipas rregullës fiskale, ku janë zbritur shpenzimet nga të hyrat vetanake të bartura dhe shpenzimet e AKP-së, ishte rreth 78 milionë euro apo -1.3 përqind e BPV-së (-2.2 përqind e BPV-së në vitin 2014). Në vitin 2015, borxhi publik ka arritur në 748.9 milionë euro (28.5 përqind rritje vjetore), përderisa si përqindje e PBB-së ka arritur në 12.98 përqind (10.63 përqind në vitin 2014).

Përderisa vlera e shtuar nga sektorët prodhues në vend mbetet e ulët, rritja e kërkesës së brendshme është përkthyer në rritje të importit, duke ndikuar kështu në rritjen e deficitit të llogarinë rrjedhëse. Megjithatë, në vitin 2015, sektori i jashtëm i Kosovës u karakterizua me rritje të konsiderueshme të remitencave dhe Investimeve të Huaja Direkte (IHD). Remitencat e pranuar në vend shënuan një rritje vjetore prej 8.5 përqind në vitin 2015. Në të njëjtën periudhë, IHD-të e pranuar në Kosovë arritën vlerën prej 324.4 milionë euro, një rritje e konsiderueshme krahasuar me vlerën e shënuar prej 151.2 milionë euro në vitin 2014.

Sistemi financiar i Kosovës gjatë vitit 2015 është karakterizuar me rritje të aktivitetit dhe nivel të lartë të qëndrueshmërisë në të gjithë sektorët përbërës të tij. Sektori bankar shënoi përshpejtim të rritjes së kreditimit, duke përforcuar kështu rolin e tij në financimin e aktivitetit ekonomik në vend. Vlera e gjithsej kredive në vitin 2015 arriti në 2.02 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 7.3 përqind. Poashtu, kreditë e reja të lëshuara nga sektori bankar deri në dhjetor 2015 u karakterizuan me rritje vjetore prej 10.9 përqind, në kuadër të të cilave rritjen më të theksuar e shënuan kreditë ndaj ndërmarrjeve për qëllime investive. Rritja e aktivitetit kreditues reflekton lehtësimin e ofertës kreditore nga bankat shprehur përmes zvogëlimit të theksuar të normës së interesit në kredi, si dhe rritjen e kërkesës për kredi nga ndërmarrjet dhe ekonomitë familjare. Struktura e kreditimit të ndërmarrjeve mbetet e ngjashme me vitet paraprake, ku kreditë e destinuar për sektorin e tregtisë paraqesin kategorinë më të madhe me pjesëmarrje prej 51.7 përqind në gjithsej kreditë për ndërmarrjet. Ndërsa rritja më e lartë e kreditimit u realizua ndaj sektorit të bujqësisë, shërbimeve financiare dhe patundshmëri si dhe sektorit të prodhimitarisë. Struktura e kredive sipas afatit të maturimit ka pësuar ndryshime në favor të kredive me afat më të gjatë maturimi. Kreditë me afat maturimi ‘mbi 2 vite’ kanë rritur pjesëmarrjen derisa kreditë me afat maturimi ‘deri 1 vit’ zvogëluan pjesëmarrjen në gjithsej kreditë e sektorit.

Rritja e aktivitetit kreditues në vend është financuar nga rritja e depozitave të mbledhura brenda vendit. Depozitat në sektorin bankar të Kosovës në vitin 2015 arritën vlerën prej 2.70 miliardë euro, që paraqet rritje vjetore prej 6.5 përqind. Depozitat e ekonomive familjare të cilat dominojnë strukturën e depozitave shënuan rritje vjetore prej 6.4 përqind që rrjedhimisht edhe ndikuan në rritjen më të përshpejtuar vjetore të gjithsej depozitave. Struktura e depozitave sipas afatit të maturimit ka pësuar ndryshime të theksuara në dy vitet e fundit. Përderisa para dy viteve depozitat e afatizuara dominonin strukturën, në vitin 2015 kategoria kryesore e depozitave u përfaqësua nga depozitat e transferueshme. Ky zhvillim në strukturën e depozitave reflekton nivelin e ulët të normave të interesit në depozita që ka mbizotëruar në Kosovë në dy vitet e fundit.

Sektori bankar gjatë vitit 2015 u karakterizua me zvogëlim të konsiderueshëm të normës së interesit në kredi, dhe rritje të lehtë të normës së interesit në depozita. Norma mesatare e interesit në kredi u zvogëluar në 7.7 përqind në dhjetor 2015 nga 9.3 përqind sa ishte në dhjetor 2014. Ndërsa, norma mesatare e interesit në depozita në dhjetor 2015 shënoi rritje në 1.2 përqind nga 1.1 përqind sa ishte në dhjetor 2014. Rrjedhimisht, dallimi në mes të normës mesatare të interesit në kredi dhe depozita në dhjetor 2015 u zvogëluar në 6.5 pikë përqind, nga 8.2 pikë përqind sa ishte në dhjetor 2014. Normat e interesit në kredi dhe depozita të sektorit bankar në Kosovë qëndrojnë në nivele të përafërta me ato të vendeve të rajonit.

Treguesit e shëndetit financiar të sektorit bankar vazhdojnë të reflektojnë shkallë të lartë të qëndrueshmërisë. Sektori bankar ka shënuar rritje të theksuar të performancës financiare duke regjistruar profit neto në vlerë prej 94.3 milionë euro në vitin 2015, kryesisht si rezultat i reduktimit të theksuar të shpenzimeve, veçanërisht atyre për provizione dhe shpenzimeve të interesit në depozita. Pozita e likuiditetit të sektorit bankar mbetet në nivel të kënaqshëm, ku në vitin 2015 raporti i asetëve likuide gjithëpërfshirëse ndaj detyrimeve afatshkurtëra qëndroi në 44.9 përqind, që është dukshëm mbi nivelin minimal prej 25 përqind të kërkuar nga Banka Qendrore. Nivelin e kapitalizimit të sektorit bankar mbetet i lartë dhe në vitin 2015 arriti në 19.0 përqind nga 17.8 përqind sa ishte një vit më parë. Rritja e kapitalit rezultoi nga profiti i lartë i realizuar gjatë vitit 2015. Rrjedhimisht, cilësia e kapitalit u përmirësua edhe më tej, ku raporti i kapitalit të klasit të parë ndaj gjithsej kapitalit u rrit në 87.7 përqind nga 82.1 përqind në vitin paraprak.

Cilësia e portofolit kreditor të sektorit bankar ka shënuar përmirësim të mëtejshëm gjatë vitit 2015, kur pjesëmarrja e kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive zbriti në 6.2 përqind, që paraqet nivelin më të ulët që nga viti 2012. Sektori bankar në Kosovë mban nivelin më të ulët të kredive joperformuese krahasuar me mesataren prej 15.9 përqind të vendeve të rajonit.. Gjithashtu sektori bankar ka rritur shkallën e mbulueshmërisë së kredive joperformuese me provizione për mbulim të humbjeve të mundshme nga kreditë, në 115.1 përqind nga 114.4 përqind sa ishte në vitin 2014. Shkalla e koncentrimit kreditor në sektorin bankar të Kosovës, ka shënuar rënie për të dytin vit me rradhë. Koncentrimi i rrezikut kreditor që matet si raport i vlerës së gjithsej ekspozimeve të mëdha ndaj kapitalit të klasit të parë, në vitin 2015, u zvogëlua në 65.7 përqind nga 97.1 përqind në vitin paraprak.

Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut të tregut vazhdon të mbetet në nivel të ulët duke marrë parasysh shkallën mjaft të ulët të pjesëmarrjes prej 1.93 përqind të pozicionit të agreguar neto të hapur në valutë të huaj ndaj kapitalit të klasit të parë¹, pjesëmarrjen e ulët prej vetëm 0.3 përqind të kredive në valutë jo-euro në gjithsej portofolin kreditor, si dhe ndjeshmërinë e ulët të aseteve dhe detyrimeve ndaj lëvizjeve në norma të interesit konsideruar faktin se pjesa më e madhe e kredive dhe depozitave bartin norma fikse të interesit. Rezultatet e analizës stres-test vazhdojnë të sugjerojnë aftësi të lartë të sektorit bankar për të përballuar tronditjet e mundshme në kualitetin e portofolit kreditor dhe në nivelin e kapitalizimit, që mund të pasojnë nën skenarët hipotetik të rritjes së normës së KJP-ve, zhvlerësimit të euros, zvogëlimit të normave të interesit për asetet dhe rritjen normave të interesit për detyrimet si dhe dështimit të kredimarrësve më të mëdhenjë. Sektori bankar në tërësi është në gjendje të përballojë një raport të KJP-ve ndaj gjithsej kredive deri në 18.2 përqind pa u paraqitur nevoja për injektim të kapitalit shtesë për mbajtjen e raportit të kapitalit në nivelin e kërkuar rregullator prej 12 përqind. Poashtu, sektori bankar ka treguar aftësi në ruajtjen e gjendjes së likuiditetit nën supozime hipotetike të tërheqjeve të konsiderueshme të depozitave. Sektori mund të jetë në gjendje të përballojë tërheqjen e rreth një të tretës (1/3) së gjithsej depozitave brenda një dite pa pasur nevojë për mjete likuide shtesë.

Infrastruktura bankare gjatë vitit 2015 vazhdoi të zgjerohet. Rritja e numrit të bankomatëve dhe pajisjeve POS rezultoi me rritje të numrit dhe vlerës së tërheqjeve përmes bankomatëve dhe shitjeve përmes POS-ve. Gjatë kësaj periudhe, numri i transaksioneve të kryera përmes sistemit ndërbankar të pagesave në Kosovë u rrit për 8.7 përqind duke arritur në 9.8 milionë ndërsa vlera e transaksioneve të kryera u rrit për 9.4 përqind në 7.5 miliardë euro. Po ashtu, është shënuar rritje e numrit të gjithsej llogarive bankare, llogarive bankare E-banking, si dhe numrit të kartelave debiti dhe krediti. Të gjitha këto zhvillime ndikuan në rritjen e efikasitetit të shërbimeve bankare.

Me rritje të aktivitetit u karakterizuan edhe sektorët tjerë përbërës të sistemit financiar, që përfshijnë sektorin pensional, sektorin e sigurimeve dhe sektorin e institucioneve mikrofinanciare. Sektori pensional vazhdon të jetë sektori me normën më të lartë të rritjes së aseteve në kuadër të sistemit financiar të Kosovës, ku vlera e aseteve të sektorit në vitin 2015 arriti në 1.24 miliard euro duke shënuar rritje vjetore prej 13.1 përqind. Sektori pensional gjithashtu vazhdoi të shënojë performancë të mirë financiare, me rritje të çmimit të aksionit në mjetet e investuara dhe rrjedhimisht kthim pozitiv nga investimet. Sektori i sigurimeve ka shënuar rritje të aktivitetit, ku në vitin 2015 vlera e aseteve të sektorit arriti në 152.7 milionë euro, që përkon me rritje vjetore prej 9.1 përqind. Mirëpo, performanca financiare e këtij sektori vazhdon të jetë jo e kënaqëshme si rezultat i humbjes së realizuar edhe gjatë vitit 2015. Aktiviteti i sektorit mikrofinanciar gjatë vitit 2015 u karakterizua me rritje të theksuar vjetore prej 6.0 përqind, duke arritur vlerën 119.7 milionë euro. Poashtu në këtë vit sektori

¹ Sipas Rregullores së BQK-së për rrezikun nga aktiviteti me valuta të huaja, shkalla maksimale e zërave të hapur për çdo valutë të veçantë ndaj kapitalit të klasës së I-rë është 15%, ndërsa maksimumi i kësaj shkalle për shumën e të gjitha valutave të huaja është 30%.

mikrofinanciar u karakterizua me përmirësim të performancës financiare në krahasim me tre vitet e fundit, duke realizuar rritje të konsiderueshme të profitit, gjë që u pasqyrua në përmirësimin e indikatorëve të profitabilitetit.

3. Eurozona dhe Ballkani Perëndimor

Eurozona

Norma reale e rritjes ekonomike në eurozonë në vitin 2015 ishte 1.7 përqind, krahasuar me normën e rritjes prej 0.9 përqind të shënuar në vitin 2014, gjë që tregon për përmirësim të mëtejshëm të aktivitetit ekonomik krahasuar me vitin paraprak (tabela 1). Gjatë vitit 2015, rritja ekonomike në eurozonë është mbështetur nga rritja e kërkesës së brendshme, që mund t'i atribuohet kryesisht ndikimit pozitiv që kishin masat e programit të lehtësimit sasior të ndërmarrë nga Banka Qendrore Evropiane (BQE). Gjithashtu, çmimet e ulëta të mallrave kryesore në tregjet ndërkombëtare, që mbretëruan gjatë gjithë vitit 2015, janë përkthyer në rritjen e të hyrave të disponueshme të konsumatorëve.

Tabela 1. Rritja reale vjetore e BPV-së në eurozonë


Përshkrimi	2012	2013	2014	2015
Eurozona	-0.9	-0.3	0.9	1.7
Gjermania	0.4	0.3	1.6	1.7
Franca	0.2	0.6	0.6	1.3
Italia	-2.8	-1.7	-0.3	0.8
Austria	0.8	0.3	0.4	0.9
Spanja	-2.6	-1.7	1.4	3.2
Greqia	-7.3	-3.2	0.7	-0.2

Burimi: Eurostat (2016)

Rritja e aktivitetit ekonomik mbeti kryesisht e koncentruar në ekonomitë qendrore të eurozonës, gjegjësisht në Gjermani, Francë dhe Spanjë, përderisa vendet tjera të eurozonës vazhduan të karakterizohen me rritje të dobët ekonomike. Në vitin 2015, ekonomitë në zhvillim si Kina, Rusia dhe Brazili, u përballën me ngadalësim të rritjes së aktivitetit ekonomik. Zvogëlimi i kërkesës nga këto vende shkaktoi dobësim të pozicionit të neto eksporteve të eurozonës. Megjithatë, rritja e kërkesës nga vendet e zhvilluara si dhe dobësimi i valutës euro kundrejt valutave tjera ka neutralizuar deri në një masë ndikimin negativ nga vendet në zhvillim. Parashikimet e BQE-së sugjerojnë se rritja reale e BPV-së në vitin 2016 pritet të arrijë në 1.6 përqind. Kjo rritje pritet të mbështetet kryesisht nga masat e programit të lehtësimit sasior, çmimet e ulëta të naftës, përmirësimi i vazhdueshëm i kushteve në tregun e punës dhe lehtësimi i politikës fiskale.

Në vitin 2015, shkalla mesatare vjetore e inflacionit në eurozonë ishte 0.0 përqind, përderisa parashikimet e BQE-së për vitin 2016, mbështetur kryesisht në rënien e vazhdueshme e çmimeve të mallrave kryesore në tregjet ndërkombëtare, sugjerojnë se shkalla e inflacionit pritet të jetë 0.2 përqind (figura 1).

Figura 1. Shkalla e inflacionit në eurozonë, në përqindje



* Parashikim i BQE-së
Burimi: Eurostat (2016)


BQE-ja vazhdoi të mbajë të pandryshuar normën bazë të rifinancimit gjatë vitit 2015. Megjithatë, lansimi i programit të gjerë stimulues që nga marsi i vitit 2015 ka ndikuar në rënien e normave 1 mujore dhe 12 mujore të interesit të kreditimit ndërbankar Euribor. Në vitin 2015, normat 1 mujore të Euribor kanë rënë në mesatarisht -0.07 përqind nga 0.12 përqind në vitin 2014. Në anën tjetër, normat mesatare për periudhë 12 mujore kanë shënuar rënie në mesatarisht 0.17 përqind në vitin 2015, nga mesatarja prej 0.48 përqind në vitin 2014 (figura 2).

Në vitin 2015, pas dy vite stagnimi në aktivitetin kreditues, eurozona u karakterizua me një rritje mesatare të kreditimit prej 0.9 përqind (-3.3 përqind në vitin 2014). Rritje më të theksuar të kreditimit shënoi Gjermania, pasuar nga Italia dhe Franca, përderisa në vendet si Greqia, Austria dhe Spanja, kreditimi mbeti në territor negativ edhe në vitin 2015 (figura 3). Sa i përket cilësisë së portfolios kreditore, ekonomitë kryesore të eurozonës u karakterizuan me rënie të nivelit të kredive joperfermuese (KJP-ve), me përjashtim të Greqisë, ku norma e KJP-ve u ngrit në 34.8 përqind (33.9 përqind në vitin 2014).

Indikatorët tjerë të performancës, siç janë Kthimi në Mesataren e Aseteve (KMA) dhe Kthimi në Mesataren e Kapitalit (KMK), shënuan gjithashtu përmirësim në shumicën e vendeve të Eurozonës, me përjashtim të Greqisë ku ka përkeqësim të KMA në -2.0 përqind (-0.3 përqind në vitin 2014) dhe të KMK-s në -24 përqind (-3.5 përqind në vitin 2014) (figura 4).


Niveli kapitalizimit të sektorit bankar, shprehur përmes raportit të kapitalit rregullativ ndaj mjeteve të peshuara me rrezik, u përmirësua në mesatarisht 18.0 përqind në Gjermani (17.6 përqind në vitin 2014), 16.3 përqind në Austri (16.2 përqind në vitin 2014), 16.8 përqind në Francë (16.0 përqind në vitin 2014), dhe 14.3 përqind në Spanjë (13.6 përqind në vitin 2014). Përderisa niveli i kapitalizimit bankar në Itali ishte pothuajse i njëjtë me vitin 2014, Greqia u karakterizua me përkeqësim të nivelit të kapitalizimit të sektorit në vitin 2015 në mesatarisht 12.7 përqind (15.3 përqind në vitin 2014). Vendet kryesore të eurozonës gjithashtu u

Figura 2. Norma e kreditimit ndërbankar EURIBOR dhe norma e rifinancimit e BQE-së




Burimi: Euribor (2016) dhe BQE (2016)

Figura 3. Rritja vjetore e kreditimit dhe shkalla e KJP-ve



Burimi: FMN (2016)

Figura 4. Treguesit e profitabilitetit të sektorit financiar në vendet kryesore të eurozonës



Burimi: FMN (2016)

karakterizuan me nivel të kënaqshëm të likuiditetit në sektorin bankar, ku në vitin 2015 niveli mesatar i likuiditetit ishte rreth 28 përqind.

Ballkani Perëndimor


Përforcimi i kërkesës së brendshme në eurozonë gjatë vitit 2015 është reflektuar pozitivisht në zhvillimet ekonomike të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Gjatë kësaj periudhe, aktiviteti ekonomik në këtë rajon u karakterizua me rritje, mbështetur kryesisht nga rritja e kërkesës së brendshme dhe përforcimi i kërkesës së jashtme. Në vitin 2015, norma mesatare e rritjes reale të BPV-së në Ballkanin Perëndimor vlerësohet të ketë qenë rreth 2.4 përqind, përderisa për vitin 2016, FMN-ja parashikon një përshejtim të rritjes së BPV-së në 3.2 përqind.

Çmimet e ulëta të naftës, energjisë dhe ushqimit në tregjet ndërkombëtare ndikuan edhe në nivelin e çmimeve në vendet e Ballkanit Perëndimor, ku norma mesatare e inflacionit vlerësohet të ketë qenë 0.9 përqind në vitin 2015. Në kuadër të vendeve të rajonit, Shqipëria kishte shkallën më të lartë të inflacionit prej 2.2 përqind në vitin 2015, përderisa vetëm Kosova u karakterizua me deflacion prej 0.5 përqind. Për vitin 2016, FMN-ja ka parashikuar se inflacioni në vendet e Ballkanit Perëndimor do të arrijë në 1.7 përqind.

Në vitin 2015, kreditimi në rajon shënoi rritje, kryesisht si rezultat i standardeve më të lehtësuara të kreditimit nga bankat dhe rritjes së kërkesës për kredi. Rritjen më të shpejtë të kreditimit në vitin 2015 e shënoi Maqedonia (9.5 përqind), pasuar nga Kosova (7.3 përqind). Në anën tjetër, me rënie vjetore të kreditimit u karakterizuan Shqipëria (2.6 përqind) dhe Kroacia (0.2 përqind). Gjithashtu, sektori bankar në vendet e rajonit u karakterizua me rritje të nivelit të përgjithshëm të depozitave, ku rritja më e shpejtë vjetore u regjistrua në Mal të Zi (13.7 përqind) dhe Serbi (7.2 përqind) ndërkaq rritja më e ngadalshme u shënua në Shqipëri (3 përqind) (figura 5).


Edhe indikatorët kyç të shëndetit financiar në vitin 2015 u karakterizuan me ecuri pozitive. Vendet e rajonit në këtë periudhë regjistruan një nivel mesatar të likuiditetit prej rreth 28 përqind përderisa mesatarja e kapitalit rregullator ndaj asetëve të peshura me rrezik ishte 16.8 përqind. Cilësia e portfolios kreditore gjithashtu shënoi përmirësim, ku niveli mesatar i KJP-ve zbriti në rreth 15.9 përqind në vitin 2015 (17.2 përqind në vitin 2014). Niveli më i ulët i KJP-ve prej 6.2 përqind në vitin 2015 u regjistrua në Kosovë, ndërsa niveli më i lartë prej 21.6 përqind ishte në Serbi.

Figura 5. Rritja vjetore e kredive dhe depozitave në vendet e Ballkanit Perëndimor, 2015



Burimi: Bankat Qendore të vendeve përkatëse (2016)

Figura 6. Norma e këmbimit të euros ndaj valutave kryesore



Burimi: BQK (2016)


Programi i lehtësimit sasior nga BQE-ja dhe politika e lehtësuar monetare, në vitin 2015 janë reflektuar në dobësimin e monedhës së euros kundrejt valutave kryesore (figura 6). Norma mesatare e këmbimit të euros ndaj dollarit amerikan në vitin 2015 kundrejt vitit 2014 u zhvlerësua për 16.6 përqind. Ndaj sterlinës britanike dhe ndaj frankës zvicerane, euro u zhvlerësua për 9.3 përkatësisht 12.2 përqind. Sa i përket valutave të vendeve të rajonit, në vitin 2015, euro është vlerësuar kundrejt dinarit serb për mesatarisht 3 përqind, përderisa është zhvlerësuar kundrejt kunës kroate dhe lekut shqiptar për 0.2 përqind.

Kutia 1. Performanca e grupeve më të mëdha bankare që operojnë në Kosovë ²

ProCredit Holding – PCH (Gjermani)

Vlera e gjithsej asetëve të grupit bankar ProCredit Holding (PCH) arriti në 6.0 miliardë euro në vitin 2015, duke shënuar rritje vjetore prej 0.7 përqind. Sipas shtrirjes regjionale, struktura e asetëve të grupit është e përqendruar në Evropën Juglindore e cila përfshinë 44.8 përqind të gjithsej asetëve të grupit. Segmenti i dytë më i rëndësishëm është Gjermania me 17.2 përqind të gjithsej asetëve të grupit, pasuar nga Amerika Jugore dhe Evropa Lindore me pjesëmarrje prej 15.6 përqind përkatësisht 12.5 përqind dhe pjesa e mbetur e asetëve prej 9.9 përqind përbëhet nga njësitë të cilat janë në proces të mbylljes. Rritja më e ngadalësuar e asetëve të PCH (nga 2.2 përqind në vitin 2014 në 0.7 përqind në vitin 2015) mund të jetë influencuar nga shitja e njësive në regjionin e Afrikës dhe njësive në Armeni gjatë vitit 2015 (figura 7). Për PCH-në, Kosova është një nga vendet më të rëndësishme sepse përfaqëson rreth 13.3 përqind të gjithsej asetëve të grupit.

Figura 7. Struktura e asetëve të PCH-së, në përqindje



Gjatë vitit 2015, pjesa më e madhe e asetëve të grupit ishte e investuar në vendet e Evropës Juglindore ³, regjion i cili u karakterizuan me rritje të moderuar ekonomike. Ky regjion vazhdoi të ndjejë efektin negativ të tensioneve politike në mes të Ukrainës dhe Ruisë, krizës në Greqi dhe kërkesës së ulët të Eurozonës në importimin e mallrave nga Evropa Juglindore. Megjithatë, grupi ka rritur prezencën në këtë regjion me hapjen e një filiale në Bullgari. Ndërsa zhvillimet pozitive makroekonomike në Gjermani, si tregu i dytë më i rëndësishëm, nuk kishin ndikim aq të theksuar në performancën e gjithë grupit bankar. Politika e aplikuar nga Banka Qendrore Evropiane për uljen e normave të interesit që së bashku me shkallën e lartë të punësimit dhe valën e refugjatëve në Gjermani është reflektuar në rritjen e kërkesës së brendshme për konsum që është një nga faktorët më kontribuues në rritjen ekonomike të vendit.

Vendet e Evropës Lindore në të cilat operon PCH-ja u ndikuan nga kriza politike e cila po vazhdon në mes të Ukrainës dhe Ruisë. Ekonomitë e Ukrainës dhe Moldavisë në vitin 2015 shënuan rënie vjetore prej 10.0 përqind përkatësisht 1.0 përqind. Kurse, ekonomia e Gjeorgjisë shënoi rritje ekonomike prej më pak se 2.0 përqind gjatë kësaj periudhe. Të tri vendet gjatë vitit 2015 u karakterizuan me rënie të theksuar të remitencave dhe eksporteve (kryesisht si rezultat i kërkesës së dobët në tregjet e Ruisë dhe Greqisë). Ukraina u përball me devalvim të valutës, me mbyllje të shumë bankave, me rënie të kreditimit dhe depozitave, rritje të kredive joperformuese dhe rrjedhimisht rënie të profitit. Mirëpo, pavarësisht gjendjes jo të favorshme makroekonomike në këtë regjion, bankat e grupit ProCredit Holding operuan me profit kryesisht si rezultat i konkurrencës së dobët bankare në këto vende. Vendet e Amerikës Jugore ⁴ në të cilat

² Bazuar në raportet vjetore të publikuara nga ProCredit Holding, Raiffeisen Bank International, dhe Nova Ljubljanska Banka.

³ Vendet e Evropës Juglindore: Shqipëria, Bosnia, Bullgaria, Kosova, Maqedonia, Rumania dhe Serbia.

⁴ Bolivia, Ekuador, Kolumbia dhe Meksika.


operon PCH, në vitin 2015 u karakterizuan me ngadalësim të rritjes ekonomike krahasuar me vitin e kaluar, përveç Meksikës që shënoi rritje të lehtë ekonomike. Zhvillimet ekonomike në këto vende u ndikuan nga vlerësimi i dollarit në raport me valutat e tyre si dhe nga rënia e çmimit të naftës që është produkti kryesor i eksporteve të këtyre vendeve.

Modeli i biznesit të grupit PCH vazhdon të jetë tradicional, ku aktiviteti kredidhënës financohet kryesisht nga depozitat e rezidentëve. Në vitin 2015, gjithsej kreditë e grupit shënuan vlerën prej 4.1 miliardë euro, që paraqet rënie vjetore prej 5.2 përqind. Mirëpo, rënia e gjithsej kredive ishte rezultat i mbylljes së njësive në Amerikën Qendrore, në Afrikë (Republika e Kongos) dhe Armeni. Ndërsa, kreditimi nga njësitë e tjera që kanë vazhduar të operojnë ka shënuar rritje prej 5.6 përqind. Kosova dhe Serbia kanë kontribut të theksuar në rritjen e gjithsej portfolios kreditorë të grupit në këtë regjion (rritje vjetore prej 7.1 përqind përkatësisht 8.7 përqind). PCH ka ndjekur strategjinë e promovimit të kreditimit ndaj ndërmarrjeve më shumë se sa kreditimin ndaj ekonomive familjare. E njëjta ndodhi edhe me ecurinë e depozitave të cilat në vitin 2015 arritën vlerën prej 3.8 miliardë euro që paraqet një rënie vjetore prej 5.0 përqind (figura 8). Kjo rënie përkon me mbylljen e njësive të ProCredit në disa vende. Realisht, depozitat shënuan rritje me normë prej 5.4 përqind në të gjitha njësitë e tjera që ende operojnë. Poashtu, ProCredit ndoqi strategjinë që të zgjerojë më shumë shërbime në fushën e transaksioneve të pagesave dhe rritjen e depozitave pa afat të bizneseve.

Grupi PCH edhe në vitin 2015 shënoi përmirësim të indikatorit të përgjithshëm të efikasitetit, shprehur përmes raportit të shpenzimeve ndaj të hyrave, i cili në vitin 2015 ishte 68.5 përqind, që paraqet një rënie prej 3.0 pikë përqindje krahasuar me vitin paraprak (figura 9). Përmirësimi i atribuohet rënies më të theksuar prej 8.8 përqind të shpenzimeve operacionale krahasuar me rënien e të hyrave operacionale për 3.4 përqind. Rënia e shpenzimeve operacionale ishte rezultat i reduktimit të shpenzimeve për personelin, që shënuan rënie vjetore prej 14.5 përqind, si dhe reduktimit të shpenzimeve administrative që shënuan rënie vjetore prej 3.3 përqind.

Në kuadër të të hyrave, të hyrat nga interesi shënuan rënie vjetore prej 7.9 përqind, kryesisht si rezultat i rënies së normave të interesit në kredi si dhe ndërprerjes së kreditimit në shumta të vogla të cilat bartnin norma të larta të interesit. Ndërsa, të hyrat nga tarifat dhe komisionet shënuan rritje vjetore prej 2.0 përqind në vitin 2015. Përkundër rënies së të hyrave, zvogëlimi i shpenzimeve siguroi që profiti i grupit në vitin 2015 të jetë dukshëm më i lartë krahasuar me vitin 2014. Në vitin 2015, profiti i realizuar arriti në 61.3 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 22.1 përqind. Rritja e profitit ndikoi në përmirësimin e normës së Kthimit Mesatar në Kapital (KMK), e cila arriti në 10.5 përqind krahasuar me 9.4 përqind sa ishte në vitin 2014. Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit (TMK) shënoi vlerën prej 12.1 përqind në vitin 2015 (12.8 përqind në vitin 2014), duke vazhduar t'i përbushë kërkesat rregullatore të mjaftueshmërisë së kapitalit (figura 9). Në vitin 2015 raporti i kredive ndaj depozitave u zvogëlua në 108.2 përqind nga 108.5 përqind sa ishte në vitin 2014.


Figura 8. Ecuria e kredive dhe depozitave të PCH-së, në përqindje



Burimi: ProCredit Holding (2016)

depozitave të cilat në vitin 2015 arritën vlerën prej 3.8 miliardë euro që paraqet një rënie vjetore prej 5.0 përqind (figura 8). Kjo rënie përkon me mbylljen e njësive të ProCredit në disa vende. Realisht, depozitat shënuan rritje me normë prej 5.4 përqind në të gjitha njësitë e tjera që ende operojnë. Poashtu, ProCredit ndoqi strategjinë që të zgjerojë më shumë shërbime në fushën e transaksioneve të pagesave dhe rritjen e depozitave pa afat të bizneseve.

Figura 9. Treguesit e efikasitetit të PCH-së, në përqindje



Burimi: ProCredit Holding (2016)

shënuan rënie vjetore prej 14.5 përqind, si dhe reduktimit të shpenzimeve administrative që shënuan rënie vjetore prej 3.3 përqind.


Performanca e grupit në vitin 2016 pritet të përmirësohet si rezultat i zhvillimeve pozitive makroekonomike dhe kushteve të favorshme në tregjet financiare në vendet në të cilat operon. Regjioni i Evropës Juglindore (përfshirë Kosovën) ku PCH ka të koncentruar pjesën më të madhe të aseteve pritet që gjatë vitit 2016 të shënojë përshejtim të rritjes ekonomike. Gjermania gjatë vitit 2016 pritet që të shënojë rritje më të lartë ekonomike krahasuar me vitin 2015 e ndikuar kryesisht nga rritja e kërkesës së brendshme (konsumit publik dhe privat) mbështetur nga kushtet e favorshme në tregun e punës dhe kushtet më të lehtësuara për financim. Regjioni i Evropës Lindore do të vazhdojë të jetë problematik si rezultat i konfliktit në Ukrainë, duke ndikuar direkt në ekonominë dhe tregjet financiare në këtë regjion, edhe pse Ukraina gjatë vitit 2016 pritet të dalë nga recesioni i viteve të fundit. Tregu i Amerikës Jugore pritet të ndikohet nga zhvillimet në tregun e çmimeve të naftës, duke marrë parasysh që nafta paraqet produktin kryesor në eksport.

Raiffeisen Bank International – RBI (Austri)

Vlera e gjithsej aseteve të grupit bankar Raiffeisen Bank International (RBI) zbriti në 114.4 miliard euro në vitin 2015, që paraqet një rënie vjetore prej 5.8 përqind. Zvogëlimi i aseteve të RBI-së në masë të madhe u ndikua nga zhvillimet në aktivitetin kredidhënës. Sipas shtrirjes regjionale, Austria mbanë pozitën udhëheqëse në strukturën e aseteve, duke përfaqësuar 28.3 përqind të gjithsej aseteve të grupit, pasuar nga Evropa Qendrore si treg tjetër mjaft i rëndësishëm që përfaqëson rreth 23.5 përqind të gjithsej aseteve të grupit. Evropa Juglindore me 19.3 përqind është e treta dhe pasohet nga Evropa Lindore me përfaqësim prej 12.4 përqind të gjithsej aseteve të grupit. Pjesa tjetër përfshinë asetet e njësisve në Azi dhe Amerikë të cilat janë planifikuar të reduktohen apo të shiten deri në fund të vitit 2017 (figura 10). Raiffeisen Bank që operon në Kosovë vazhdon të ketë pjesëmarrje mjaft të ulët prej 0.74 përqind në gjithsej asetet e RBI-së.

Pjesa më e madhe e vendeve në të cilat operon RBI gjatë vitit 2015 shënuan rritje të ekonomisë. Më konkretisht, regjioni i Evropës Qendrore u karakterizua me rritje solide ekonomike gjatë vitit 2015 krahasuar me vitin paraprak. Kjo rritje erdhi si rezultat i rritjes ekonomike në Gjermani dhe rimëkëmbjes ekonomike në vendet e eurozonës. Po ashtu, regjioni i Evropës Juglindore u karakterizua me përshejtim të rritjes ekonomike, përderisa regjioni i Evropës Lindore shënoi rënie ekonomike. Austria në vitin 2015 shënoi përshejtim të rritjes së konsumit të brendshëm (në masë të madhe shpenzimeve qeveritare) dhe zhvillimeve në sektorin e tregtisë me jashtë (rritje të eksporteve dhe importeve).


Figura 10. Struktura e aseteve të RBI-së, në përqindje



Burimi: Raiffeisen Bank International (2016)

Modeli i biznesit të grupit bankar RBI vazhdon të bazohet kryesisht në aktivitetin kredidhënës, të financuar nga depozitat (figura 11). RBI për të tretin vit me radhë shënoi rënie të aktivitetit kreditor. Në vitin 2015, gjithsej kreditë shënuan rënie vjetore prej 10.3 përqind, duke zbritur në 69.9 miliardë euro. Kjo rënie ishte si rezultat i zvogëlimit të kreditimit ndaj ndërmarrjeve për shkak të shtrëngimit të politikave kredituese nga RBI në disa tregje. Zvogëlimi mi i theksuar i kreditimit ishte i pranishëm në njësitë në RBI Austri, Poloni, Azi dhe Rusi. Vlera e depozitave në vitin 2015 arriti në 69.0 miliardë euro, duke shënuar një

Figura 11. Ecuria e kredive dhe depozitave të RBI-së, në përqindje




Burimi: Raiffeisen Bank International (2016)

rritje vjetore prej 4.4 përqind. Kjo rritje ishte si rezultat i rritjes së depozitave të ekonomive familjare, veçanërisht në Poloni, Sllovaki, Republikë Çeke, Rusi dhe Rumani. Ndërsa, depozitat e ndërmarrjeve shënuan rënie, veçanërisht në njësitë Azi dhe Rusi, kundrejt rritjes në njësitë në Sllovakia dhe në Republikën Çeke. Si rrjedhojë e rënies së theksuar të kredive krahas rritjes së nivelit të depozitave, raporti kredi/depozita u zvogëluar në 101.3 përqind në vitin 2015, rënie për 16.6 pikë përqindje krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

RBI shënoi rënie të indikatorit të përgjithshëm të efikasitetit, shprehur përmes raportit të shpenzimeve ndaj të hyrave, i cili në vitin 2015 u rrit në 59.1 përqind nga 56.5 përqind në vitin paraprak (figura 12). Kjo rritje prej 2.6 pikë përqindje i atribuohet rënies më të shpejtë prej 7.9 përqind të të hyrave operacionale, krahas rënies së shpenzimeve operacionale prej 3.6 përqind në vitin 2015. Rënia e gjithsej të hyrave operacionale u ndikua kryesisht nga të hyrat nga interesi që shënuan rënie vjetore prej 12.2 përqind, si rrjedhojë e luhatjeve të mëdha valutore (zhvlerësimi valutore në Evropën Lindore). Po ashtu, ndikim në zvogëlimin e tyre kishte edhe rënia e normave të interesit dhe gjithsej stokut të kredive në RBI Austri.

Figura 12. Treguesit e efikasitetit të RBI-së, në përqindje



Burimi: Raiffeisen Bank International (2016)

Në kuadër të shpenzimeve operacionale, shpenzimet e personelit u karakterizuan me rënie vjetore prej 4.2 përqind në vitin 2015, ndërsa shpenzimet tjera administrative shënuan rënie prej 1.7 përqind në vitin 2015. Gjatë vitit 2015, RBI ka ndarë 486.2 milionë euro më pak provizione ndaj humbjeve të mundshme nga kreditë. Zvogëlimi i shpenzimeve për provizione ndaj humbjeve nga kreditë ishte më e theksuar në Evropën Lindore dhe atë Qendrore. Në vitin 2015, grupi RBI regjistroi profit neto në vlerë prej 378.8 milionë euro krahasuar me humbjen prej 616.8 milionë euro në vitin e kaluar. Profiti i realizuar gjatë vitit 2015 ndikoi në përmirësimin e Kthimit Mesatar në Kapital (KMK) në 8.5 përqind, që paraqet një rritje të konsiderueshme krahasuar me normën prej 0.2 përqind sa ishte për vitin 2014. Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit (TMK) në vitin 2015 qëndroi në 17.4 përqind, krahasuar me 16.0 përqind sa ishte në vitin 2014, që mbetet mjaft mbi nivelin minimal të përcaktuar me kërkesat rregullatore (figura 12). Kurse, raporti i kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive në vitin 2015 u rrit në 11.9 përqind, krahasuar me 11.4 përqind sa ishte në vitin 2014. Ndërsa, mbulueshmëria e kredive joperformuese me provizione arriti në 71.3 përqind në vitin 2015 nga 67.5 përqind sa ishte në vitin 2014. RBI vazhdon të jetë e vetmja nga tri grupet bankare kryesore që operojnë në Kosovë që tregton aksionet e saj në bursë. Çmimi për aksion të RBI-së në bursën e Vjenës në ditën e fundit të vitit 2015 u rrit në 13.61 euro, krahasuar me 12.54 euro sa ishte në ditën e fundit të vitit 2014.

Zhvillimet ekonomike në vendet ku vepron grupi RBI pritet të ndikojnë pozitivisht në performancën e grupit. Ekonomia e Austrisë pritet që gjatë vitit 2016 dhe 2017 të shënojë rritje të përsheptuar ekonomike krahasuar me vitin 2015. Poashtu konsumi dhe investimet private pritet të rriten, ndikuar nga zhvillimet pozitive në tregtinë me jashtë. Ngjashëm, ekonomitë e Evropës Juglindore pritet që gjatë vitit 2016 të kenë ritëm të përsheptuar të rritjes ekonomike. Trend pozitiv të rritjes ekonomike pritet të kenë edhe në vendet e Evropës Qendrore si rezultat i rritjes ekonomike në Gjermani që është partneri më i madh tregtar i këtyre vendeve. Ndërsa, ekonomia e Rusisë pritet që edhe gjatë vitit 2016 të ndikohet nga vazhdimi i sanksioneve ekonomike dhe rënia e çmimit të naftës.

Nova Ljubljanska Banka- NLB (Slloveni)

Grupi bankar NLB gjatë vitit 2015 u karakterizua me rënie të lehtë të aktivitetit, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Vlera e gjithsej asetëve të grupit në vitin 2015 ishte 11.8 miliard euro, që paraqet një rënie vjetore prej 0.7 përqind. Sa i përket shtrirjes regionale, Sllovenia, që është vend i origjinës të grupit bankar NLB, përfaqëson tregun kryesor me 70.1 përqind të gjithsej asetëve të grupit. Evropa Juglindore paraqet tregun tjetër më të rëndësishëm për grupin NLB, duke pasur parasysh që 29.3 përqind e gjithsej asetëve të grupit janë të investuara në këtë region. Pjesa e mbetur e asetëve të grupit prej 0.5 përqind janë të investuara në regionin e Evropës Perëndimore dhe 0.1 përqind në regionin e Evropës


Qendrore (figura 13). NLB Banka që operon në Kosovë, ka një pjesëmarrja prej 3.9 përqind në gjithsej asetet e grupit në vitin 2015.

Edhe grupi NLB ndjekë një model tradicional të biznesit duke marrë parasysh që aktiviteti i grupit është kryesisht kredidhënës dhe financohet nga depozitat. Ngjashëm me grupin RBI, edhe grupi NLB gjatë kësaj periudhe u karakterizua me rënie të aktivitetit kredidhënës. Në vitin 2015, vlera e gjithsej kredive ishte 8.3 miliard euro, që paraqet rënie vjetore prej 7.8 përqind. Rënia e kreditimit ishte kryesisht si rezultat i programit 2012-2017 për ristrukturimin e bankës NLB. Ky program ishte rrjedhojë e mbingarkesës me borxh të korporatave financiare dhe humbjeve në sektorin bankar në të kaluarën. Depozitat u karakterizuan me rritje prej 0.9 përqind, mirëpo me ritëm më të ngadalësuar krahasuar me vitin paraprak (rritje prej 8.3 përqind), vlera e të cilave në vitin 2015 arriti në 9.0 miliard euro (figura 14). Rënia e theksuar e kredive, krahas rritjes së lehtë të depozitave, ka ndikuar që raporti kredi/depozita të zvogëlohet në 92.5 përqind në vitin 2015 nga 101.2 sa ishte në vitin 2014.

Grupi NLB gjatë vitit 2015 ka shënuar përkeqësim të treguesve kyç të efikasitetit që shprehur përmes raportit të shpenzimeve ndaj të hyrave, ky tregues shënoi rritje vjetore për 2.2 pikë përqindje, duke arritur nivelin prej 61.6 përqind në vitin 2015 (figura 15). Ky rezultat i atribuohet rënies më të lartë të të hyrave operacionale prej 5.5 përqind, përderisa shpenzimet u zvogëluan për 1.9 përqind. Kontributin kryesor në rënie e gjithsej të hyrave operacionale e kishte rënia e të hyrave nga transaksionet financiare nga 38.3 milionë euro në vitin 2014 në 3.8 milionë euro në vitin 2015. Po ashtu, të hyrat nga tarifat dhe komisionet shënuan rënie vjetore prej 0.6 përqind në vitin 2015, ndërsa të hyrat nga in teresi shënuan rritje vjetore prej 3.1 përqind si rezultat i zvogëlimit të theksuar të shpenzimeve të interesit. Në kuadër të shpenzimeve operacionale, shpenzimet për personelin shënuan rritje vjetore prej 0.2 përqind në vitin 2015, përderisa shpenzimet e përgjithshme dhe administrative shënuan rënie vjetore prej 1.9 përqind. Grupi arriti që të mbyllë vitin 2015 me profit prej 91.9 milionë euro (62.3 milionë në vitin 2014), në të cilin profit kontribuan kryesisht njësitë e NLB në regjionet e tjera pasi që banka amë në Slloveni kishte rënie të profitit. Ky rezultat u reflektua edhe në normën e kthimit në kapital (KMK) e cila u përmirësua në 6.6 përqind nga 4.8 përqind sa ishte në vitin 2014.


Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit (TMK) në vitin 2015 qëndroi në 16.2 përqind, që ishte më i ulët krahasuar me normën prej 17.6 përqind sa ishte në vitin 2014, por që mbetet mjaft mbi nivelin minimal prej 8 përqind të përcaktuar me kërkesat rregullore të Basel III (figura 15). Niveli më i

Figura 13. Struktura e asetëve të NLB Group, në përqindje,




Burimi: Nova Ljubljanska Banka (2016)

Ecuria e kredive dhe depozitave të NLB Group, në përqindje



Burimi: Nova Ljubljanska Banka (2016)

Figura 15. Treguesit e efikasitetit të NLB Group, në përqindje



Burimi: Nova Ljubljanska Banka (2016)

ulët i kapitalizimit në vitin 2015 u ndikua kryesisht nga rritja asetëve të peshuara me rrezik për shkak të ndryshimeve rregullative për kalkulimin e peshave të investimeve në letra me vlerë të Evropës Juglindore. Ecuri pozitive u shënuar edhe në cilësinë e portofolit kreditor, ku raporti ndërmjet kredive joperformuese dhe gjithsej kredive u zvogëluar në 19.3 përqind në vitin 2015, krahasuar me 25.1 përqind sa ishte në vitin 2014. Ndërsa, mbulueshmëria e kredive joperformuese me provizione në vitin 2015 ishte 72.2 përqind krahasuar me 68.7 përqind në vitin 2014.

Zhvillimet ekonomike në vendet ku operon grupi NLB pritet të ndikojnë pozitivisht në performancën e grupit. Sllovenia pritet që gjatë vitit 2016 të ketë trend pozitiv të rritjes ekonomike por me shkallë më të moderuar për shkak se pritet të ketë më pak investime publike. Megjithatë, rritja e konsumit të brendshëm dhe investimeve private në vend do të jenë faktorët mbështetës në rritjen e BPV-së. Investimet private pritet që të financohen brenda vendit çka do të mund të ndikonte në rritjen e kreditimit nga sektori bankar në Slloveni.

4. Ekonomia e Kosovës


Bazuar në indikatorët makroekonomik, vlerësohet se ekonomia e Kosovës në vitin 2015 është karakterizuar me rritje të aktivitetit ekonomik. Vlerësimet e BQK-së sugjerojnë se vlera nominale e BPV-së në vitin 2015 ka qenë 5.73 miliardë euro, që paraqet një normë reale të rritjes prej 3.5 përqind (1.2 përqind në vitin 2014) (figura 16). Rritja ekonomike gjatë këtij viti ishte rezultat i rritjes së kërkesës së brendshme, gjegjësisht konsumit privat dhe investimeve. Në anën tjetër, neto eksportet rritën ndikimin e tyre negativ në normën e rritjes ekonomike. Sipas qasjes së prodhimit, rritja ekonomike në vitin 2015 ishte kryesisht rezultat i rritjes së vlerës së shtuar të aktivitetit në sektorin e ndërtimtarisë, furnizimit me energji elektrike dhe vlerës së shtuar të aktivitetit në sektorin e hoteleve dhe restoranteve.

Sipas statistikave preliminare të publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), në tremujorin e parë të vitit 2015, BPV shënoi rritje vjetore prej 1.7 përqind, kundrejt rritjes prej 0.3 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Në tremujorin e dytë 2015, ekonomia e Kosovës u karakterizua me një rritje më të shpejtë vjetore prej 4.7 përqind (rënie vjetore prej 1.7 përqind në periudhën e njëjtë të vitit 2014), përderisa në tremujorin e tretë 2015 rritja reale e BPV-së ishte 4.0 përqind (3.0 përqind në tremujorin e njëjtë të vitit 2014). Mbështetur kryesisht në vlerësimet për rritjen e konsumit privat si dhe përforcimin e pozicionit të investimeve, për tremujorin e katërt të vitit 2015, të dhënat preliminare të ASK-së sugjerojnë se rritja reale e BPV-së ishte 5.0 përqind.

Në vitin 2015, niveli i përgjithshëm i çmimeve në Kosovë, shprehur nëpërmjet indeksit të çmimeve të konsumit (angl: Consumer Price Index: CPI), është karakterizuar me deflacion prej 0.5 përqind, krahasuar me inflacionin prej 0.4 përqind në vitin 2014 (figura 17). Rënia më e lartë e çmimeve është shënuar te shërbimet arsimore (22.6 përqind), shërbimet e transportit (7.5 përqind), dhe te shërbimet e restoranteve dhe hoteleve (2.1 përqind). Në anën tjetër, çmimet e pijeve alkoolike dhe duhanit u rritën për 6.5 përqind, si dhe çmimet e strehimit, ujit, rrymës, gazit dhe lëndëve tjera djegëse shënuan rritje për 1.6 përqind. Me rritje u karakterizuan edhe çmimet e ushqimit dhe pijeve joalkoolike të cilat ishin për 0.4 përqind më të larta krahasuar me vitin paraprak.


Lëvizja e çmimeve në Kosovë është e ngjashme me lëvizjen e çmimeve në tregjet ndërkombëtare si pasojë e varësisë së lartë të ekonomisë së Kosovës në importe. Kjo tregohet edhe nga sjellja e

Figura 16. Norma reale e rritjes së BPV-së



* Vlerësim i BQK-së
Burimi: ASK (2016)

Figura 17. Lëvizja e çmimeve të komponentëve kryesorë, ndryshimi vjetor në përqindje



Burimi: ASK (2016)

ngjashme e indeksit të çmimeve të importit dhe indeksit të çmimeve të konsumit në Kosovë. Çmimet e importit në vitin 2015 shënuan rënie mesatare vjetore prej 1.0 përqind, përderisa çmimet e prodhimit shënuan rritje prej 2.7 përqind.


Gjatë vitit 2015, sektori fiskal regjistroi rritje të të hyrave dhe të shpenzimeve buxhetore. Të hyrat buxhetore⁵ arritën vlerën bruto prej 1.49 miliardë euro në vitin 2015. Nëse zbriten 35.7 milionë euro kthime të TVSH-së dhe tatimeve tjera nga Dogana e Kosovës dhe Administrata Tatimore e Kosovës, atëherë të hyrat buxhetore shënuan vlerën neto prej 1.46 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 9.3 përqind. Shpenzimet buxhetore⁶ në vitin 2015 arritën vlerën prej 1.55 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 5.1 përqind. Rrjedhimisht, gjatë kësaj periudhe, buxheti i Kosovës regjistroi deficit të përgjithshëm prej rreth 112 milionë euro, krahasuar me deficitin prej rreth 155 milionë euro të shënuar në vitin 2014. Borxhi publik, në fund të vitit 2015, ka arritur në 748.9 milionë euro që është për 28.5 përqind më i lartë krahasuar me vitin paraprak, ndërsa si përqindje e PBB-së ka arritur në 12.98 përqind (10.63 përqind në vitin 2014).

Sektori i jashtëm në Kosovë u karakterizua me përkeqësim të pozicionit të llogarisë rrjedhëse dhe kapitale në vitin 2015 kundrejt vitit paraprak, përderisa pozicioni i llogarisë financiare u përmirësua. Deficiti i llogarisë rrjedhëse dhe kapitale shënoi vlerën prej 501.8 milionë euro në vitin 2015, një rritje vjetore prej 20.7 përqind. Llogaria rrjedhëse dhe kapitale shënoi rritje të deficitit, kryesisht si pasojë e rritjes së deficitit tregtar të mallrave dhe rënies së shënuar në bilancin pozitiv të llogarive të të ardhurave parësore dhe dytësore. Në anën tjetër, bilanci i shërbimeve mbeti pozitiv dhe ishte më i lartë se sa në vitin e kaluar.

Në vitin 2015, deficitin tregtar të mallrave arriti vlerën prej 2.3 miliardë euro (rreth 40 përqind të BPV-së), që paraqet një rritje prej 4.3 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (figura 18). Gjithsej eksportet e mallrave në vitin 2015 arritën vlerën 325.3 milionë euro, që përkon me një rritje të dobët vjetore prej 0.2 përqind. Rritja e eksporteve gjatë kësaj periudhe kryesisht i atribuohet rritjes së vlerës së eksporteve të plastikës dhe gomës, si dhe eksporteve të pijeve dhe duhanit. Megjithatë, në vitin 2015, të gjitha kategoritë e mëdha të mallrave që eksporton Kosova u karakterizuan me rënie. Kategoria e metaleve bazë, që njëherësh ka pjesëmarrjen më të lartë në gjithsej mallrat që eksporton Kosova (49 përqind), shënoi një rënie vjetore prej 5.8 përqind. Gjithashtu, me rënie vjetore prej 6.9 përqind u karakterizua kategoria e produkteve minerale, që kanë një pjesëmarrje prej rreth 13 përqind në gjithsej eksportet e vendit. Përderisa rënia e vlerës së eksporteve të metaleve bazë kryesisht i atribuohet rënies së çmimeve të metaleve në tregjet ndërkombëtare, rënia e eksporteve të produkteve minerale gjatë kësaj periudhe i atribuohet rënies së eksportit të energjisë elektrike.

Vlera e gjithsej mallrave të importuara në vitin 2015 arriti në 2.6 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 3.8 përqind. Në kuadër të gjithsej importeve, me rritje u karakterizuan

Figura 18. Importet, eksportet dhe bilanci tregtar, jo kumulative në miliardë euro



Burimi: ASK (2016)

⁵ Në kuadër të të hyrave buxhetore nuk janë përfshirë të hyrat nga huamarrjet, pranimet nga privatizimi, të hyrat e dedikuara të AKP-së, pranimet nga grantet e përgjithshme të donatorëve, kthimi i kredive nga ndërmarrjet publike dhe pranimet nga depozitat në mirëbesim.

⁶ Në kuadër të shpenzimeve buxhetore nuk janë përfshirë pagesat e kryeqjësë së borxhit, pagesat nga grantet e përcaktuara të donatorëve dhe pagesat nga depozitat në mirëbesim.


kategoria e makinerive dhe pajisjeve elektrike, kategoria e metaleve bazë, kategoria e pijeve dhe duhanit, produkteve kimike si dhe kategoria e mallrave të plastikës dhe gomës. Në vitin 2015, me rënie të vlerës së importuar u karakterizuan produktet minerale. Përkundër rritjes së shënuar në sasinë e importuar të produkteve të naftës në vitin 2015, si nënkategori dominuese në kategorinë e produkteve minerale, rënia e vlerës së importuar në këtë kategori ishte kryesisht rrjedhojë e çmimeve të ulëta të naftës në tregjet ndërkombëtare. Si pasojë e rritjes më të shpejtë të vlerës së importeve në krahasim me vlerën e eksporteve, shkalla e mbulueshmërisë së importeve me eksporte u zvogëluar në 12.3 përqind, nga 12.8 përqind sa ishte në vitin 2014.

Tregtia në shërbime u karakterizua me rritje të bilancit pozitiv në vitin 2015. Bilanci i shërbimeve arriti vlerën prej 354.4 milionë euro, një rritje vjetore prej 5.5 përqind si rezultat i rritjes më të shpejtë të eksporteve të shërbimeve kundrejt shërbimeve të importuara. Eksporti i shërbimeve shënoi rritje vjetore prej 3.8 përqind, duke arritur vlerën prej 796.4 milionë euro. Në të njëjtën periudhë, vlera e importit të shërbimeve shënoi rritje prej 2.5 përqind dhe arriti vlerën prej 442.0 milionë euro. Në kuadër të shërbimeve të eksportuara, shërbimet e udhëtimit u karakterizuan me rritje vjetore prej 12.0 përqind në vitin 2015, përderisa kategoria e shërbimeve kompjuterike, informative dhe të telekomunikacionit, si dhe kategoria e shërbimeve të biznesit u karakterizuan me rënie prej 29.4 përkatësisht 18.8 përqind. Sa i përket importit të shërbimeve, dy kategoritë kryesore të shërbimeve, gjegjësisht shërbimet e transportit dhe të udhëtimit, shënuan rritje vjetore prej 47.3 përqind përkatësisht 12.2 përqind.

Llogaria e të ardhurave parësore në vitin 2015 kishte bilanc pozitiv prej 78.0 milionë euro, i cili është për 31.5 përqind më i ulët krahasuar me bilancin e vitit paraprak. Bilanci më i ulët i të ardhurave parësore i atribuohet nivelit më të lartë të pagesave që kanë bërë investitorët e huaj, kryesisht në formë të dividendës. Të ardhurat e realizuara nga investitorët e huaj, në vitin 2015, arritën në 119.2 milionë euro, një rritje krahasuar me vitin paraprak prej 60.3 përqind. Kategoria më e madhe në kuadër të të hyrave të llogarisë së të ardhurave parësore mbeten të ardhurat nga kompenzimi i punëtorëve. Të ardhurat nga kompenzimi i punëtorëve, që kryesisht përbëhen nga të ardhurat e punëtorëve sezonal jashtë vendit, arritën vlerën prej 210.3 milionë euro në vitin 2015, një rritje vjetore prej 1.8 përqind.

Në vitin 2015, llogaria e të ardhurave dytësore shënoi vlerën 1.1 miliard euro, që paraqet një rënie vjetore prej 1.9 përqind. Bilanci më i ulët i të ardhurave dytësore i atribuohet nivelit më të ulët të donacioneve dhe granteve të ndryshme, si dhe reduktimit të shpenzimeve nga institucionet e ndryshme ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë. Në anën tjetër, remitencat e pranuar në Kosovë, që njëherësh paraqesin edhe kategorinë më të madhe në kuadër të llogarisë së të ardhurave dytësore, arritën vlerën prej 752.4 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 8.5 përqind (figura 19). Remitencat që pranohen në Kosovë vijnë kryesisht nga Gjermania dhe Zvicra, vende këto nga të cilat dërgohen 37 përqind përkatësisht 22 përqind të gjithëj remitencave të pranuar në Kosovë. Një pjesë e konsiderueshme e remitencave në vitin 2015 është pranuar edhe nga SHBA-të, gjegjësisht 8 përqind e gjithëj remitencave të pranuar në Kosovë.

Figura 19. Pranimet e remitencave



Burimi: BQK (2016)


Komponentë tjetër e rëndësishme në kuadër të bilancit të pagesave është edhe kategoria e Investimeve të Huaja Direkte (IHD). IHD-të e pranuar në Kosovë gjatë vitit 2015 arritën vlerën prej 324.4 milionë euro (151.2 milionë euro në vitin 2014). Në kuadër të strukturës së IHD-ve, rritje shënuan të dy format e IHD-ve, përfshirë kapitalin dhe fondin e investimeve në aksione, si dhe investimet në instrumentet e borxhit. Kapitali dhe fondi i investimeve në aksione, që përbën rreth 71.0 përqind të gjithsej IHD-ve, shënoi vlerën prej 243.7 milionë euro apo 109.1 përqind më shumë se sa në vitin paraprak. Normë të lartë të rritjes (133.2 përqind) kanë shënuar edhe IHD-të në formë të instrumenteve të borxhit të cilat arritën në 80.7 milionë euro në vitin 2015 (figura 20).

Në vitin 2015, me rritje të IHD-ve të pranuar u karakterizuan të gjithë sektorët e ekonomisë. Vlera e investimeve në patundshmëri ishte më e lartë për 47.5 milionë euro krahasuar me vitin 2014 (gjithsej 189.6 milion euro në vitin 2015), përderisa investimet në sektorin financiar ishin më të larta për 22.4 milionë euro (gjithsej 64.3 milion euro në vitin 2015). Edhe investimet në ndërtimtari dhe industri, të cilat në vitin 2014 patën shënuar rënie, në vitin 2015 kanë shënuar rritje të konsiderueshme. Sa i përket origjinës së IHD-ve, Zvicra paraqet vendin prej nga kanë ardhur më së shumti IHD në vitin 2015 (72.9 milionë euro), pasuar nga Turqia me 57.8 milionë euro, Gjermania me 45.3 milionë euro, Shqipëria me 40.7 milionë euro, Austria me 33.5 milionë euro etj.

4.1 Tregu i Letrave me Vlerë


Tregu i letrave me vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës ka filluar me emetimin e parë të bono të thesarit në vitin 2012 dhe deri më tani ky treg ka treguar ritëm pozitiv të zhvillimit, ku nga 14 ankande të realizuara në vitin 2012 numri i tyre ka arritur në 21 në vitet pasuese. Gjithashtu, me rritjen e numrit të ankandëve është rritur edhe shuma e emetuar si dhe është rritur afati mesatar i maturimit. Në vitin 2015, gjithsej vlera e emetuar arriti në 398.5 milionë euro nga 164.0 milionë sa ishte në vitin 2012. Për më tepër, fillimi i emetimit të fletëobligacioneve qeveritare në fillim të vitit 2014 ka rritur afatin mesatar të maturimit të letrave me vlerë nga 13.5 muaj për vitin 2014 në 20 muaj⁷ për vitin 2015 (figura 21). Letrat me vlerë të Qeverisë mund të konsiderohen instrumente atraktive për investime duke marrë parasysh që në përgjithësi shuma e ofertuar e subjekteve pjesëmarrëse ka tejkaluar shumën e shpallur (kërkesën nga Qeveria). Në vitin 2015, shuma e shpallur në ankande nga

Figura 20. Struktura e investimeve të huaja direkte sipas komponenteve, në milionë euro



Burimi: BQK (2016)

Figura 21. Ecuria e tregut të letrave me vlerë



Burimi: BQK (2016)


⁷ Afati mesatar i maturimit është llogaritur si mesatare e thjeshtë e afateve të maturimit të letrave me vlerë që ende nuk kanë maturuar në fund të secilit vit.

Qeveria ishte për 6.3 përqind më e ulët krahasuar me vitin paraprak, përderisa ofertimi i subjekteve pjesëmarrësve ishte për 6.8 përqind më e lartë. Shuma e ofertuar për investime në letra me vlerë në vitin 2015 ishte 629.2 milionë euro, përderisa shuma e shpallur nga Qeveria ishte 405.0 milionë euro. Rrjedhimisht, raporti i shumës së ofertuar nga subjektet pjesëmarrëse ndaj shumës së shpallur të Qeverisë në vitin 2015 ishte 1.55 (1.36 në vitin 2014) (figura 22).

Interesimi i lartë për të investuar në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës mund të jetë reflektim i likuiditetit të lartë në sektorin bankar si dhe përgjithësisht nevojës për alternativa tjera investuese me kthime të favorshme. Struktura e letrave me vlerë sipas llojit të instrumentit të emtuar ka pësuar ndryshime në vitin 2015. Përderisa në vitin 2014 shuma e fletëobligacioneve të emtuara përbënte 13.1 përqind të gjithsej shumës së emtuar të letrave me vlerë, në vitin 2015 pjesëmarrja e fletëobligacioneve u rrit në 30.1 përqind. Në vitin 2015, janë emtuar 14 bono të thesarit në shumë prej 278.6 milionë euro krahasuar me 17 të tilla të emtuara në shumë prej 345.0 milionë euro në vitin 2014. Në anën tjetër, emetimi i fletëobligacioneve shënoi rritje në numër dhe në vlerë gjatë vitit 2015 krahasuar me vitin paraprak. Në vitin 2015, janë emtuar 7 fletëobligacione qeveritare në vlerë prej 119.9 milion euro krahasuar me 4 të tilla në vlerë prej 52.0 milionë euro në vitin 2014.


Në vitin 2015, për herë të parë, janë emtuar tri fletëobligacione qeveritare me afat maturimi 3 dhe 5 vite, gjë që ndikoi në rritjen e peshës së letrave me vlerë të maturimit afatgjatë në strukturën e përgjithshme të letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës. Kategoria kryesore e letrave me vlerë u përfaqësua nga bonot e thesarit me maturim 364 ditë, të cilat kishin pjesëmarrje prej 37.6 përqind. Kategoria e dytë me pjesëmarrje ishte ajo e bonove të thesarit me maturim 182 ditë, për dallim nga viti i kaluar që ishte kategoria kryesore (figura 23). Ndërsa, fletëobligacionet me afat maturimi prej dy vite në vitin 2015 rritën pjesëmarrjen në 18.8 përqind të strukturës së letrave me vlerë, duke u radhitur kështu në kategorinë e tretë për nga pesha. Fletëobligacionet qeveritare me afat maturimi 3 dhe 5 vite së

Figura 22. Shuma e shpallur dhe e ofertuar, në milionë euro.




Burimi: BQK (2016)

Figura 23. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë sipas afatit të maturimit, në përqindje



Burimi: BQK (2016)

Figura 24. Normat mesatare të interesit të letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës sipas maturimit



Burimi: BQK (2016)


bashku përbëjnë 11.3 përqind të gjithëj letrave me vlerë. Këto zhvillime reflektojnë orientimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës drejt emetimit të letrave me vlerë të afateve më të gjata të maturimit.

Norma e përgjithshme mesatare e interesit në letrat me vlerë gjatë vitit 2015 ishte më e lartë (1.94 përqind) krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (1.57 përqind). Në rritje të normës kontribuoi emetimi për herë të parë i fletëobligacioneve 3 dhe 5 vite, të cilat rrjedhimisht edhe bartin norma më të larta të interesit krahasuar me ato të bonove të thesarit. Gjatë vitit 2015, norma më e lartë e interesit prej 4.9 përqind u regjistrua në fletëobligacionet me afat maturimi 5 vite, ndërsa norma më e ulët prej 0.6 përqind u regjistrua në bonot e thesarit me afat maturimi 91 ditë. Gjatë vitit 2015, norma mesatare e interesit në bonot e thesarit me afat maturimi 182 ditë u karakterizua me rritje, përderisa, norma mesatare e interesit në bonot e thesarit me afat maturimi 364 ditë shënoi rënie të lehtë. Norma mesatare e interesit në bonot e thesarit me afat maturimi 91 ditë dhe atyre me afat maturimi prej 2 vite nuk kanë pësuar ndryshime të theksuara krahasuar me vitin paraprak (figura 24).

Tregu i letrave me vlerë në vend qëndron mjaft mirë edhe në krahasim me vendet e rajonit⁸ sa i përket normave të interesit si dhe raportit të ofertës nga subjektet pjesëmarrëse ndaj shumës së shpallur nga Qeveritë e vendeve përkatëse. Në vitin 2015, Kosova regjistroi raportin më të lartë të ofertës ndaj shumës së letrave me vlerë të shpallur nga Qeveria. Edhe pse mbrapa Kosovës, Shqipëria dhe Serbia gjithashtu regjistruan ofertë më të lartë ndaj shumës së shpallur nga Qeveria. Ndërsa, Maqedonia gjatë vitit 2015 regjistroi ofertim më të ulët nga subjektet pjesëmarrëse duke shënuar raport 0.96 ndaj shumës së shpallur për bono thesari dhe 0.97 ndaj shumës së shpallur për fletëobligacione qeveritare. Në Shqipëri ofertimi nga subjektet ishte për 1.12 herë më e lartë se shuma e shpallur e qeverisë për bono thesari dhe 1.10 herë më e lartë se shuma e shpallur për fletëobligacione qeveritare (figura 25).


Norma mesatare e interesit në Kosovë qëndron më e ulët në krahasim me vendet e rajonit. Norma mesatare e interesit në Maqedoni gjatë vitit 2015 ishte 1.72 përqind për bono thesari dhe rreth 3.61 përqind për fletëobligacione qeveritare. Ndërsa norma mesatare e interesit në letra me vlerë të Shqipërisë ishte 3.10 përqind për bono dhe 6.30 përqind për fletëobligacione (figura 26).

Figura 25. Raporti i mbulimit shumë e ofertuar/shumë e shpallur



Burimi: Bankat Qendrore të vendeve përkatëse (2016)

Figura 26. Norma mesatare e interesit në letrat me vlerë të qeverive në Ballkanin Perëndimor, në përqindje



Burimi: Bankat Qendrore të vendeve përkatëse (2016)

⁸ Në vende të rajonit janë përfshirë: Shqipëria, Maqedonia, Serbia dhe Mali i Zi ndërsa për vitin 2015 ky i fundit nuk ka realizuar ankande.

5. Sistemi Financiar i Kosovës


5.1. Karakteristikat e Përgjithshme

Sistemi financiar i Kosovës vazhdoi të rritet edhe gjatë vitit 2015. Vlera e gjithsej asetëve të sistemit në vitin 2015 arriti në 4.91 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 8.0 përqind (7.3 përqind në vitin 2014) (figura 27). Rritja e përshpejtuar krahasuar me vitin e kaluar i atribuohet kryesisht rritjes së aktivitetit kredidhënës të bankave komerciale dhe rritjes së asetëve të fondeve pensionale. Kontribut, por në shkallë më të ulët, në rritjen e gjithsej asetëve të sistemit financiar kishte edhe rritja e aktivitetit të sektorëve të tjerë, përfshirë sektorin e sigurimeve, sektorin mikrofinanciar dhe sektorin e ndihmësve financiar.

Struktura e sistemit financiar të Kosovës vazhdon të dominohet nga sektori bankar, i cili përfaqëson 69.0 përqind të gjithsej asetëve, pasuar nga sektori pensional me një pjesëmarrje prej 25.2 përqind (figura 28). Në vitin 2015, asetet e sektorit pensional shënuan një normë të rritjes vjetore prej 13.1 përqind, përderisa sektori bankar u karakterizua me rritje vjetore prej 6.2 përqind. Komponenti i tretë me radhë për nga madhësia e asetëve është sektori i sigurimeve i cili në vitin 2015 kishte një pjesëmarrje në gjithsej asetet e sistemit financiar prej 3.1 përqind dhe regjistroi rritje vjetore prej 9.1 përqind. Sektori mikrofinanciar, me pjesëmarrje prej 2.4 përqind në gjithsej asetet e sistemit financiar, gjatë kësaj periudhe shënoi rritje prej 6.0 përqind, e cila paraqet ritëm të përshpejtuar të rritjes së aktivitetit të këtij sektori. Pësia e ndihmësve financiar në gjithë sistemin vazhdon të jetë e ulët me një përfaqësim prej vetëm 0.2 përqind në gjithsej asetet e sistemit financiar, përkundër rritjes vjetore prej 22.3 përqind të shënuar në vitin 2015.


Shkalla e ndërmjetësimit financiar në Kosovë, llogaritur si raport i asetëve të sistemit financiar ndaj Bruto Produktit Vendor (BPV), është rritur gjatë kësaj periudhe. Në vitin 2015, norma e

Figura 27. Asetet e sistemit financiar dhe sektorëve përbërës, ndryshimi vjetor




Burimi: BQK (2016)

Figura 28. Struktura e asetëve të sistemit financiar



Burimi: BQK (2016)

Figura 29. Ndërmjetësimi financiar sipas sektorëve në Kosovë




Burimi: BQK (2016)

ndërmjetësimi financiar në vend është rritur në 85.5 përqind krahasuar me 81.6 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak (figura 29).

Përkundër rritjes që ka shënuar në periudhën e fundit, shkalla e ndërmjetësimi financiar e sektorit bankar në Kosovë vazhdon të jetë relativisht e ulët krahasuar me vendet e rajonit. Rrjedhimisht, në raport me madhësinë e ekonomisë, ekziston ende hapësirë për rritje të shkallës së ndërmjetësimi financiar. Zhvillime të ngjashme vërehen edhe nëse shikohet niveli i kreditimit të sektorit bankar ndaj BPV-së. Në Kosovë, ky nivel në vitin e fundit shënoi përmirësim të lehtë si rezultat i rritjes së përshejtuar të aktivitetit kreditues nga bankat (figura 30).

Figura 30. Ndërmjetësimi financiar i sektorit bankar në vendet e Ballkanit Perëndimor (raporti i kredive ndaj BPV-së)



Burimi: FMN, Bankat Qendrore të rajonit (2016)

Burimi: FMN, Bankat Qendrore të rajonit (2016)

Struktura e sistemit financiar është zgjeruar për sa i përket numrit të institucioneve financiare që operojnë në vend. Krahasuar me vitin e kaluar, në vitin 2015 tregut vendor i janë shtuar tri institucione të reja financiare, prej të cilave dy ndihmës financiare dhe një kompani e sigurimit. Si rrjedhojë, numri i gjithsej institucioneve financiare të licencuara për të operuar në vend arriti në 89. Numri i bankave komerciale, fondeve pensionale dhe institucioneve mikrofinanciare nuk ka ndryshuar në krahasim me vitin e kaluar (tabela 2).

Tabela 2. Numri i institucioneve financiare⁹

Përshkrimi	Dhjetor 2012	Dhjetor 2013	Dhjetor 2014	Dhjetor 2015
Bankat komerciale	9	9	10	10
Kompanitë e sigurimeve	13	13	14	15
Fondet pensionale	2	2	2	2
Ndihmësit financiar	38	39	42	44
Institucionet mikrofinanciare	17	17	18	18

Burimi: BQK (2016)

5.2 Ekspozimi ndaj sektorit të jashtëm¹⁰

Në vitin 2015, vlera e investimeve të sistemit financiar në sektorin e jashtëm arriti në 1.65 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 2.6 përqind (26.8 përqind në vitin 2014)¹¹. Rritja më e ngadalshme ishte kryesisht si rrjedhojë e ngadalësimit të rritjes së investimeve të fondeve pensionale në sektorin e jashtëm si dhe rënies së investimeve të bankave komerciale në sektorin e jashtëm. Ngadalësimi i investimeve i atribuohet performancës më të dobët të kthimit në investime.

⁹ Numri i institucioneve financiare paraqet numrin e institucioneve që janë të licencuara të operojnë në tregun e Kosovës. Në kuadër të kategorisë së institucioneve mikrofinanciare janë përfshirë edhe pesë institucioneve financiare jobankare të licencuara për aktivitet kredidhënës.

¹⁰ Në këtë kontekst, sistemi financiar nuk përfshinë Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

¹¹ Në kuadër të kërkesave të sistemit financiar të Kosovës ndaj sektorit të jashtëm nuk është përfshirë kategoria 'para e gatshme'. Në statistikat monetare dhe financiare, kategoria 'para e gatshme' që ndodhet në trezorët e bankave komerciale trajtohet si aset i jashtëm (kërkesa ndaj jorezidentëve) për faktin se valuta euro nuk është valutë kombëtare e Kosovës, mirëpo në këtë analizë këto mjete nuk janë trajtuar si të tilla për shkak se ato janë mjete që mbahen në bankat në Kosovë.

Kthimi më i ulët në investime gjatë vitit 2015 u ndikua nga zhvillimet ekonomike në BE dhe SHBA. Klima dekurajuese për investime për shkak të rrezikut të daljes së Greqisë nga eurozona, dobësimi i ekonomisë kineze si dhe vendimi i FED për të mos ndërprerë politikën e lehtësimeve sasiore, u reflektuan në luhatje të tregjeve financiare. Rrjedhimisht këto ngjarje ndikuan edhe në kthimet e investimeve të jashtme të fondeve pensionale.


Pjesa më e madhe e investimeve në sektorin e jashtëm përfaqësohet nga kapitali dhe ekuitetet tjera me pjesëmarrje prej 65.6 përqind, pasuar nga letrat me vlerë me pjesëmarrje prej 15.2 përqind dhe depozitat me pjesëmarrje prej 13.6 përqind. Pjesa e mbetur përbëhet nga kreditë me 5.4 përqind dhe asetet tjera me 0.2 përqind (figura 31).

Në kuadër të gjithsej asetëve të jashtëm, normën më të lartë të rritjes vjetore prej 44.3 përqind e shënuan kreditë, pasuar nga investimet në letra me vlerë të cilat shënuan rritje prej 28.7 përqind, ndërsa asetet dhe ekuitetet u karakterizuan me rritje prej 6.0 përqind që paraqet normë me ritëm dukshëm më të ngadalësuar të rritjes krahasuar me vitin e kaluar (57.3 përqind në vitin 2014).

Rritja e kreditimit ndaj sektorit të jashtëm, megjithëse në pjesëmarrje shumë të ulët në strukturën e asetëve të jashtëm, ishte si rezultat i huazimeve ndaj bankave amë (kryesisht të një banke) në formë të linjave kreditore. Rritja e investimeve në letra me vlerë jashtë vendit mund të jetë rezultat i nevojës së bankave për të plasuar mjetet në alternativa të tjera investuese në kushtet e një niveli të lartë të likuiditetit në sektorin bankar në vend. Ndërsa, rritja e ngadalësuar e asetëve dhe ekuiteteve tjera të investuara në sektorin e jashtëm, instrumente këto që përfaqësojnë pjesën më të madhe të asetëve të fondeve pensionale të investuara jashtë vendit, i atribuohet rritjes më të ngadalshme të arkëtimit të reja në vitin 2015 si dhe performancës më të dobët të kthimit në investime të dy fondeve pensionale që operojnë në Kosovë.


Në anën tjetër, depozitat e sistemit financiar të Kosovës të mbajtura jashtë vendit, në vitin 2015, shënuan rënie të theksuar vjetore prej 31.6 përqind krahasuar me rritjen prej 33.2 përqind të shënuar në vitin 2014. Rënia e kësaj kategorie mund të reflektojë normat e ulëta të interesit në depozita dhe shkallën e lartë të likuiditetit në bankat e eurozonës, gjë që ka shtyrë bankat të orientohen më tepër drejt investimeve në letra me vlerë në tregjet e jashtëm, instrumente këto që ofrojnë norma më të larta të kthimit në krahasim me interesin në depozita.

Figura 31. Struktura e asetëve në sektorin e jashtëm, në përqindje



Burimi: BQK (2016)

Figura 32. Struktura e detyrimeve të jashtëm, në përqindje



Burimi: BQK (2016)

Vlera e gjithsej detyrimeve ndaj sektorit të jashtëm në vitin 2015 arriti në 267.1 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 9.7 përqind (2.4 përqind në vitin 2014). Struktura e detyrimeve të jashtme vazhdon të dominohet nga kreditë me pjesëmarrje prej 55.7 përqind, pasuar nga depozitat me 43.4 përqind dhe detyrimet tjera me pjesëmarrje prej 0.9 përqind (figura 32). Kategoria me ndikimin kryesor në përsheptimin e rritjes së gjithsej detyrimeve ndaj sektorit të jashtëm ishin depozitat e jo-rezidentëve në bankat komerciale në Kosovë, të cilat shënuan rritje vjetore prej 28.0 përqind (rritje prej 0.2 përqind në vitin 2014). Përsheptimi i rritjes së depozitave të jo-rezidentëve, ndër tjerash, mund të jetë edhe rezultat i ndërprerjes së trendit rënës të normave të interesit në depozita në sektorin bankar të Kosovës që nga tremujori i dytë i vitit 2015. Ndërsa, kategoria e kredive të pranuar nga sektori i jashtëm në vitin 2015 shënoi rënie vjetore prej 0.7 përqind, krahasuar me rritjen prej 3.1 përqind në vitin 2014. Rënia mund të jetë rezultat i prezencës së mjaftueshme të likuiditetit në sektorin bankar të Kosovës.

Rrjedhimisht, vlera e aseteve të jashtme neto (AJN) të sistemit financiar të Kosovës në vitin 2015 arriti në 1.39 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 1.3 përqind (32.3 përqind në vitin 2014). Fondet pensionale vazhdojnë të përfaqësojnë pjesën më të madhe të AJN-ve (78.5 përqind). Bilancit pozitiv të gjithsej AJN-ve i kontribuojnë edhe AJN-të e sektorit bankar me pjesëmarrje prej 25.9 përqind, përderisa AJN-të e sektorit mikrofinanciar ishin i vetmi segment që shënoi bilanc negativ prej -4.5 përqind të gjithsej AJN-ve të sistemit financiar, gjë që është rezultat i mbështetjes së këtyre institucioneve në financimin e jashtëm përmes linjave kreditore (figura 33).

Ekspozimi i gjithsej sistemit financiar ndaj sektorit të jashtëm vazhdon të mbetet më i theksuar në kuadër të aseteve, krahas ekspozimit më të ulët në kuadër të detyrimeve. Më konkretisht, raporti i aseteve të jashtme ndaj gjithsej aseteve të sistemit financiar në vitin 2015 arriti në 33.7 përqind (35.5 përqind në vitin 2014). Në anën tjetër, raporti i detyrimeve të jashtme ndaj gjithsej detyrimeve të sistemit financiar qëndroi në 5.4 përqind, ngjashëm me vitin e kaluar (figura 34).

Për sa i përket ndarjes së AJN-ve sipas sektorëve, sektori bankar vazhdon të ketë neto ekspozimin më të ulët ndaj sektorit të jashtëm. Raporti i aseteve të jashtme ndaj gjithsej aseteve të sektorit bankar është 16.7 përqind, përderisa raporti i detyrimeve të jashtme ndaj gjithsej detyrimeve të sektorit bankar është 6.0 përqind, duke reflektuar kështu shkallën e ulët të mbështetjes së sektorit bankar në financimin e jashtëm. Në kuadër të sektorit bankar, bankat e mëdha vërehet të jenë më të ekspozuara ndaj sektorit të jashtëm në krahasim me bankat e

Figura 33. AJN-të sipas sektorëve financiarë





Figura 34. Ekspozimi i jashtëm sipas sektorëve financiar



vogla. Kjo reflekton faktin se bankat më të mëdha, të cilat kryesisht janë banka të huaja, kanë një shkallë më të lartë të ndërveprimit me sektorin e jashtëm, veçanërisht me bankat e tyre amë.

Sektori i fondeve pensionale vazhdon të jetë sektori më i ekspozuar ndaj sektorit të jashtëm në kuadër të asetëve. Në vitin 2015, asetet e investuara jashtë vendit përbënin 88.1 përqind të gjithëj asetëve të sektorit pensional (94.0 përqind në vitin 2014). Për dallim nga sektorët tjerë, sektori mikrofinanciar ka ndërveprim me sektorin e jashtëm vetëm në kuadër të detyrimeve dhe në vitin 2015 niveli i financimit ishte 52.4 përqind e gjithëj detyrimeve. Kjo për arsye se sektori mikrofinanciar shfrytëzon linjat kreditore të jashtme për të financuar aktivitetin kreditues, duke pasur parasysh se IMF-të nuk kanë të drejtë ligjore të pranojnë depozita.

6. Sektori Bankar i Kosovës

6.1 Struktura e Sektorit Bankar

Bankat me pronësi të huaj vazhdojnë të dominojnë sektorin bankar të Kosovës, ku nga gjithsej dhjetë banka të licencuara që operojnë në vend, tetë janë me pronësi të huaj. Bankat me pronësi të huaj, në vitin 2015, menaxhuan 90.1 përqind të gjithsej asetëve dhe zotëruan 92.5 përqind të gjithsej kapitalit të sektorit bankar. Nga bankat me pronësi të huaj, pesë prej tyre kanë vend të origjinës Austrinë, Gjermaninë, Slloveninë, Shqipërinë dhe Serbinë, përderisa tri të tjera kanë vend të

origjinës Turqinë¹² (figura 35). Në sektorin bankar të Kosovës operojnë edhe dy banka me pronësi vendore.

Sektori bankar vazhdoi të karakterizohet me rënie të shkallës së koncentrimit të tregut edhe gjatë vitit 2015, gjë e cila mund të konsiderohet si tregues i rritjes së konkurrencës në këtë sektor. Pjesëmarrja e tri bankave më të mëdha në gjithsej asetet e sektorit, në vitin 2015, ka zbritur në 64.3 përqind krahasuar me 66.9 përqind në vitin paraprak. Rënia e shkallës së koncentrimit të tregut vërehet edhe përmes Indeksit Herfindahl-Hirschman (IHH), i cili tregon për një rënie të vazhdueshme të koncentrimit për sa i përket asetëve, kredive dhe depozitave gjatë katër viteve të fundit (figura 36). Rënia e koncentrimit ishte më e theksuar në kredi dhe asete si rezultat i rritjes më të shpejtë të aktivitetit nga bankat e vogla krahasuar me rritjen më të ngadalshme nga tri bankat më të mëdha. Tri bankat më të mëdha, në vitin 2015, shënuan rritje vjetore të kredive prej 4.0 përqind dhe rritje të asetëve prej 2.2 përqind, krahasuar me rritjen vjetore prej 13.5 përqind në kredite dhe 14.8 përqind në asetet e bankave tjera. Rënia e shkallës së koncentrimit të tregut gjatë vitit 2015 ishte e evidente edhe në depozita, për dallim nga viti paraprak kur kishte shënuar rritje. Në vitin 2015, depozitat në tri bankat më të mëdha shënuan rritje vjetore prej 3.7 përqind, krahasuar me rritjen prej 12.2 përqind në bankat tjera më të vogla.

Figura 35. Struktura e asetëve të sektorit bankar, sipas pronësisë





Figura 36. Shkalla e koncentrimit në sektorin bankar



¹² Me banka nënkuptojmë filialet dhe degët e bankave të huaja që janë të licencuara për të operuar në Kosovë.


6.2. Aktiviteti i Sektorit Bankar

6.2.1. Asetet

Vlera e asetëve të sektorit bankar të Kosovës në vitin 2015 arriti në 3.38 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 6.2 përqind (4.1 përqind në vitin 2014) (figura 37). Kontributin më të lartë në rritjen e asetëve të sektorit e kishte rritja e portfolios së kredive, e cila vazhdon të jetë kategoria kryesore e aktivitetit bankar. Rritja e përshpejtuar e aktivitetit të sektorit bankar u financua nga rritja e depozitave, të cilat po ashtu shënuan përshpejtim të ritmit të rritjes gjatë kësaj periudhe.


Struktura e asetëve të sektorit bankar nuk shënoi ndryshime të theksuara në krahasim me periudhat paraprake, duke marrë parasysh që pjesa dërmuese e asetëve të sektorit bankar (prej 83.0 përqind) mbeten të investuara në instrumente që sjellin fitim, siç janë kreditë, letrat me vlerë dhe bilancet me bankat komerciale. Kategoria e letrave me vlerë u karakterizua me rritje më të theksuar të pjesëmarrjes në strukturën e gjithsej asetëve krahasuar me vitin e kaluar, përderisa kategoria e kredive si dhe kategoria e parasë së gatshme shënuan rritje të lehtë të pjesëmarrjes. Në anën tjetër, kategoria e bilancit me bankat komerciale zvogëloi lehtësisht pjesëmarrjen në gjithsej asetet e sektorit bankar (tabela 3).

Figura 37. Struktura e asetëve të sektorit bankar



Burimi: BQK (2016)

Figura 38. Asetet e sektorit bankar, ndryshimi vjetor



Burimi: BQK (2016)

Tabela 3. Struktura e asetëve të sektorit bankar

Përshkrimi	Dhjetor 2012		Dhjetor 2013		Dhjetor 2014		Dhjetor 2015	
	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	425.7	15.0%	463.3	15.1%	447.1	14.0%	491.0	14.5%
Bilanci me bankat komerciale	287.9	10.2%	339.9	11.1%	390.7	12.3%	316.0	9.3%
Letrat me vlerë	256.6	9.1%	354.5	11.6%	383.8	12.0%	473.3	14.0%
Kreditë bruto	1,763.4	62.3%	1,805.8	59.0%	1,882.4	59.1%	2,019.5	59.7%
Asetet Fikse	57.7	2.0%	55.5	1.8%	53.7	1.7%	57.0	1.7%
Asetet Tjera	38.1	1.3%	40.3	1.3%	27.9	0.9%	27.8	0.8%
Gjithsej	2,829.3	100%	3,059.3	100%	3,185.6	100%	3,384.7	100%

Burimi: BQK(2016)

Gjatë vitit 2015, bankat intensifikuan investimet në letra me vlerë. Shuma e investimeve të sektorit bankar në letra me vlerë arriti në 473.3 milionë euro në vitin 2015, duke shënuar një rritje vjetore prej 23.3 përqind (8.3 përqind në vitin 2014) (figura 38). Rritja e përshpejtuar e investimeve në letra me vlerë i atribuohet kryesisht rritjes së investimeve në letra me vlerë të qeverive të huaja, për dallim nga viti paraprak kur kontributin kryesor në rritjen e gjithsej

investimeve në letra me vlerë e kishin investimet në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës. Në vitin 2015, investimet në letra me vlerë në sektorin e jashtëm, që kryesisht përbëhen nga fletëobligacionet e qeverive të huaja, regjistruan rritje vjetore prej 29.4 përqind, duke rritur kështu pjesëmarrjen në 52.2 përqind të gjithsej letrave me vlerë (49.7 përqind në vitin 2014) (figura 39).


Në anën tjetër, investimet në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës, shënuan rritje vjetore prej 17.3 përqind, që paraqet rritje dukshëm më të ngadalësuar krahasuar me rritjen vjetore prej 92.6 përqind të shënuar në vitin 2014. Rrjedhimisht, pjesëmarrja e kësaj kategorie në gjithsej portfolion e investimeve në letra me vlerë u zvogëlua në 47.8 përqind (50.2 përqind në vitin 2014). Këto zhvillime mund të jenë pasojë e ofertës më të ulët të Qeverisë së Kosovës për emetimin e letrave me vlerë krahasuar me vitin paraprak (4.1 Letrat me Vlerë). Investimet në letrat me vlerë të korporatave tjera financiare dhe jo-financiare, që konsiderohen instrumente me shkallë më të lartë të rrezikut, kanë pjesëmarrjen më të ulët në portfolin e investimeve në letra me vlerë (0.05 përqind në vitin 2015), duke treguar se investimet e bankave që operojnë në Kosovë janë të koncentruara në instrumente me shkallë më të ulët të rrezikut.

Kategoria e parasë së gatshme dhe bilancit me BQK-në po ashtu u karakterizua me rritje të përshpejtuar vjetore prej 9.8 përqind në vitin 2015, krahasuar me rënien prej 3.5 përqind në vitin 2014 (figura 38). Rritja e kësaj kategorie ishte kryesisht rezultat i rritjes së gjithsej rezervave të bankave komerciale në BQK që reflekton rritjen e përshpejtuar vjetore të depozitave në sektorin bankar. Kategoria e bilancit me bankat komerciale ishte e vetmja kategori që regjistroi rënie vjetore prej 19.1 përqind në vitin 2015, krahasuar me rritjen prej 15.0 përqind të shënuar në vitin 2014. Kjo rënie mund të jetë si pasojë e normave të ulëta të interesit, madje edhe negative, në tregjet ndërkombëtare të cilat kanë kufizuar mundësitë e bankave komerciale për investime në këto tregje.

Kreditë


Kreditë mbeten kategoria kryesore e asetëve të sektorit bankar, me pjesëmarrje prej 59.7 përqind në gjithsej asetet e sektorit. Sektori bankar, për të dytin vit me radhë, vazhdoi të përshpejtojë ritmin e rritjes së kreditimit. Në vitin 2015, vlera e gjithsej kredive arriti në 2.02 miliardë euro, që paraqet rritje vjetore prej 7.3 përqind (4.2 përqind në vitin 2014) (figura 40). Përshpejtimi i rritjes së aktivitetit kredidhënës, ndër tjerash, reflekton përmirësimin e kushteve të kreditimit nga ana e bankave dhe rritjen e kërkesës për kredi nga ndërmarrjet dhe ekonomitë familjare (Anketa mbi Kreditimin Bankar).

Figura 39. Struktura e letrave me vlerë, në përqindje



Burimi: BQK (2016)

Figura 40. Kontributi i sektorëve në rritjen e gjithsej kredive, në pikë përqindje



Burimi: BQK (2016)

Struktura e gjithsej kredive vazhdon të dominohet nga kreditë e destinuar për ndërmarrje, të cilat në vitin 2015 përfaqësuan 65.3 përqind të gjithsej kredive, ndërsa kreditë për ekonomitë familjare janë të përfaqësuar me 34.4 përqind. Në kuadër të strukturës së gjithsej kredive rritjen më të lartë prej 11.7 përqind e shënuan kreditë për ekonomitë familjare (10.2 përqind në vitin 2014). Rritja e kreditimit të ekonomive familjare i atribuohet kryesisht rritjes prej 27.6 përqind të kredive të reja hipotekare dhe rritjes prej 55.7 përqind të kredive të reja me kushte favorizuese, krahas rënies prej 2.8 përqind të kredive të reja konsumuese. Rritja e kreditimit hipotekar ndër tjerash reflekton edhe rënien më të theksuar të normës së interesit për 0.9 pikë përqindje për këto kredi, përderisa norma e interesit në kreditë konsumuese shënoi rënie për 0.4 pikë përqindje.


Megjithatë, kontributin kryesor në rritjen e përsheptuar të gjithsej kreditimit të sektorit bankar e kanë dhënë kreditë ndaj ndërmarrjeve, të cilat kanë peshën më të madhe në kuadër të gjithsej kredive dhe shënuan rritje vjetore prej 5.2 përqind në vitin 2015 (3.2 përqind në vitin 2014). Kreditë tjera, që përfshijnë kreditë ndaj organizatave jo-qeveritare dhe kreditë në valutë jo-euro, të cilat përfaqësojnë 0.3 përqind të gjithsej kredive, shënuan rritje vjetore prej 0.1 përqind në vitin 2015. Ndërsa, kreditë ndaj jo-rezidentëve të cilat përfaqësojnë vetëm 0.02 përqind të gjithsej kredive, shënuan rënie vjetore prej 20.7 përqind në vitin 2015 (97.7 përqind në vitin 2014).

Përkundër përsheptimit të rritjes së gjithsej kredive, kreditë e reja të lëshuara nga sektori bankar deri në dhjetor 2015 u karakterizuan me rritje vjetore prej 10.9 përqind që ishte më e ngadalësuar krahasuar me rritjen vjetore prej 30.4 përqind të shënuar deri në dhjetor të vitit 2014 (Kreditë e Reja). Në rritjen e kredive të reja gjatë vitit 2015, kontributin kryesor e kishin kreditë ndaj ndërmarrjeve për qëllime investive. Rritja rekorde e kredive të reja e shënuar në vitin e kaluar, në njërin anë, ishte si rezultat i rritjes së kërkesës për kredi që ishte nxitur nga rritja e pagave në sektorin publik dhe, në anën tjetër, rritjes së ofertës kreditore përmes lehtësimit të standardeve dhe kushteve të kreditimit nga ana e bankave. Megjithatë, rritja e lartë e kreditimit në vitin 2014 kishte reflektuar edhe efektin e bazës, duke qenë se vitet paraprake ishin karakterizuar me aktivitet të ngadalësuar të kreditimit.

Struktura e kredive të ndërmarrjeve sipas veprimtarisë

Struktura e kredive të ndërmarrjeve sipas veprimtarisë ekonomike mbetet e ngjashme me vitet paraprake (figura 41). Kreditë e destinuar për sektorin e tregtisë paraqesin kategorinë më të madhe me pjesëmarrje prej 51.7 përqind në gjithsej kreditë për ndërmarrjet, pasuar nga kreditë e destinuar për sektorin e industrisë (miniera, prodhimtari, energjetikë, dhe ndërtimtari) me pjesëmarrje prej 22.8 përqind në vitin 2015, nga të cilat vetëm kreditë e destinuar për sektorin e prodhimtarisë përbëjnë 12.4 përqind të gjithsej kreditimit të ndërmarrjeve. Sektori i shërbimeve tjera (hoteleri dhe restorante, shërbimeve tjera financiare etj.) kishte një pjesëmarrje prej 21.4 përqind, përderisa sektori i bujqësisë vijon të ketë qasje më të ulët në kreditimin bankar me pjesëmarrje prej 4.2 përqind në gjithsej kreditë e ndërmarrjeve.

Figura 41. Struktura e kredive sipas veprimtarisë ekonomike, në përqindje




Burmi: BQK (2016)

Sektorët ekonomik të cilët përgjithësisht kanë pjesëmarrje më të ulët në kreditimin bankar, siç janë sektori i bujqësisë dhe i shërbimeve financiare, gjatë vitit 2015 shënuan rritje më të theksuar. Po ashtu, rritje të kreditimit shënuan edhe sektori i tregtisë dhe i prodhimit. Rritja e kreditimit kryesisht i atribuohet përmirësimit të ofertës kreditore përmes zvogëlimit të theksuar të normës së interesit në kredi, si dhe rritjes e kërkesës për kredi nga këta sektorë ekonomik (Anketa mbi Kreditimin Bankar). Poashtu nga gjithsej bizneset e reja të regjistruara gjatë vitit 2015, 29.5 përqind e tyre i përkasin sektorit të tregtisë, 10.6 përqind prodhimit dhe 9.6 përqind sektorit të bujqësisë.

Kreditë për sektorin e shërbimeve financiare dhe patundshmëri, të cilat përfaqësuan 7.1 përqind të gjithë kredive për ndërmarrjet në vitin 2015, paraqesin kategorinë që shënoi rritjen më të lartë vjetore prej 55.1 përqind, gjë që paraqet përmirësim të theksuar krahasuar me rënie prej 11.9 përqind të shënuar në vitin 2014. Kjo rimëkëmbje mund të jetë edhe si rezultat i rritjes së ndërmarrjeve të reja të regjistruara për të ushtruar aktivitetet financiar, sigurime dhe patundshmëri, ku viti 2015 reflekton numrin më të madh të regjistrimeve për këto veprimtari në krahasim me të gjitha periudhat paraprake. Më specifikisht, deri në dhjetor 2015, numri i ndërmarrjeve të reja arriti në 169 ndërmarrje krahasuar me 102 të tilla në vitin paraprak.


Sektori me rritjen e dytë më të lartë vjetore të kredive ishte sektori i bujqësisë, gjë që tregon për rritje të vëmendjes së bankave ndaj këtij sektori. Kreditë për bujqësi në vitin 2015 arritën vlerën 54.9 milionë euro, që paraqet rritje për 5.1 milionë euro (rritje për 4.0 milionë euro në vitin 2014). Trendi rritës i kredive për këtë sektor mund të jetë kryesisht rezultat i rritjes së kërkesës për kredi bujqësore duke pasur parasysh dyfishimin e buxhetit të qeverisë për programin e subvencioneve dhe granteve në këtë sektor për vitin 2015, gjë që u reflektua edhe në rritjen e numrit të bizneseve të reja të regjistruara për këtë sektor. Deri në dhjetor 2015, janë raportuar rreth 40 përqind më shumë biznese të reja në sektorin e bujqësisë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Po ashtu, rritja e kreditimit për këtë sektor është mbështetur edhe nga zhvillimet në anën e ofertës kreditore ku vihet re një rënie e theksuar e normës së interesit për kredi bujqësore lëshuar ndërmarrjeve në 7.1 përqind në fund të vitit 2015 nga 11.3 përqind sa ishte në vitin paraprak. Si rrjedhojë, kreditë bujqësore të ndërmarrjeve tani bartin normën më të ulët të interesit nga të gjithë sektorët e tjerë, për dallim nga vitet paraprake kur normat e interesit për ndërmarrjet bujqësore ishin ndër më të lartat për vite me radhë.

Figura 42. Kreditë për sektorin e industrisë, në përqindje



Burimi: BQK (2016)

Figura 43. Kreditë sipas veprimtarisë ekonomike, ndryshimi vjetor



Burimi: BQK (2016)

Kreditë e destinuar për sektorin e prodhimit, të cilat përbëjnë 54.6 përqind të kredive për sektorin e industrisë (figura 42), në vitin 2015 shënuan rritje vjetore prej 7.3 përqind (16.2 përqind në vitin 2014). Me gjithë ngadalësimin e ritmit të rritjes krahasuar me vitin paraprak, sektori i prodhimit ishte sektori i tretë me rritjen më të lartë të kreditimit gjatë vitit 2015 (figura 43).

Kreditë e destinuar për sektorin e tregtisë, të cilat vazhdojnë të jenë kategoria më e madhe në kuadër të kredive për ndërmarrjet, shënuan rritje vjetore prej 1.3 përqind që paraqet ngadalësim krahasuar me rritjen prej 5.3 përqind të shënuar në vitin 2014.

Kreditë e lëshuara për sektorin e energjetikës, që përfaqësojnë 5.9 përqind të kredive për sektorin e industrisë (figura 43), paraqesin sektorin që në vitin 2015 u karakterizua me rënie më të lartë prej 12.5 përqind (2.2 përqind në vitin 2014).

Gjithashtu, në vitin 2015, rënie shënuan edhe kreditë për sektorët e ndërtimit dhe minierave. Kreditimi i sektorit të ndërtimit (që përbën 33.1 përqind të kredive për sektorin e industrisë) vazhdon të shënojë rënie për të tretin vit me radhë. Në vitin 2015, kreditë e sektorit të ndërtimit ishin për 7.0 përqind më të ulëta se në vitin paraprak.


Kreditë për sektorin e minierave, që kanë pjesëmarrje prej 6.4 përqind në kreditë për sektorin e industrisë, shënuan rënie vjetore prej 2.2 përqind. Rënia e kreditimit për sektorin e minierave mund të jetë edhe pasojë e rënies së aktivitetit të këtij sektori, të paraqitur përmes indeksit të qarkullimit industrial.

Struktura e kredive sipas afatit të maturimit

Struktura e kredive sipas afatit të maturimit, ka pësuar ndryshime të lehta krahasuar me vitet e kaluara. Në vitin 2015, kreditë me afat maturimi 'mbi 2 vite' përfaqësuan pjesën më të madhe të gjithëj kredive me pjesëmarrje prej 72.2 përqind si rrjedhojë e rritjes së këtyre kredive krahasim me vitin paraprak (figura 44). Poashtu, bankat kanë deklaruar rritje të kërkesës për kredi afatgjatë si nga ndërmarrjet ashtu edhe nga ekonomitë familjare. Në të njëjtën kohë, kreditë afatgjatë u karakterizuan me norma më të ulëta të interesit krahasuar me normat në kreditë afatshkurtra ku kreditë me afat maturimi 'mbi 5 deri në 10 vite' përfaqësuan normën më të ulët të interesit prej 6.9 përqind ndërsa kreditë me afat maturimi 'deri 1 vit' regjistruan normën më të lartë prej 8.0 përqind.

Kreditë me afat të mesëm maturimi, '1 deri në 2 vite' rritën pjesëmarrjen në 9.6 përqind në vitin 2015 (7.3 përqind në vitin 2014) si rezultat i rritjes vjetore prej 42.0 përqind të kësaj kategorie krahasuar me rënie prej 2.0 përqind në vitin 2014 (figura 45). Ndërsa, kreditë me afat të shkurtër maturimi, 'deri në 1 vit', edhe pse zvogëluan pjesëmarrjen e tyre në 18.2 përqind (nga 23.5 përqind në vitin 2014), vazhduan të jenë kategoria e dytë për nga madhësia në gjithëj kredite. Zvogëlimi i pjesëmarrjes rezultoj nga rënia vjetore për 17.0 përqind e kësaj kategorie në vitin 2015 që mund të jetë si pasojë e rënies së kërkesës për kredi të afateve më të shkurtëra të maturimit.


Figura 44. Struktura e kredive sipas afatit të maturimit, në përqindje



Burmi: BQK (2016)

Rritja e kreditimit afatgjatë është shprehur si te kreditë ndaj ndërmarrjeve ashtu edhe te kreditë ndaj ekonomive familjare. Në kuadër të kreditimit të ndërmarrjeve, rritja është më e theksuar për sektorët e bujqësisë, prodhimtarisë dhe tregtisë. Këto zhvillime mund të reflektojnë orientimin e bankave në ofrimin e kushteve lehtësuese përmes normave më të favorshme të interesit në kreditë afatgjata si dhe rritjen e kërkesës për këto kredi. Për më tepër, zhvillimi më i hovshëm i kredive hipotekare gjatë kësaj periudhe mund të ketë kontribuar në rritjen e pjesëmarrjes së kredive me maturim afatgjatë, duke marrë parasysh se 67.0 përqind e kredive të reja hipotekare kanë afat maturimi 'mbi 5 vite'.

Figura 45. Kreditë sipas afatit të maturimit, ndryshimi vjetor




Burimi: BQK (2016)

Kreditë e reja


Vlera e gjithsej kredive të reja të lëshuara nga sektori bankar për herë të parë, brenda një viti, në vitin 2015 arriti shifrën një miliard euro. Më konkretisht, deri në vitin 2015, vlera e kredive të reja arriti në 1.1 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 10.9 përqind (figura 46).

Figura 46. Gjithsej kreditë dhe kreditë e reja, ndryshimi vjetor



Burimi: BQK (2016)

Figura 47. Kreditë e reja, në milionë euro




Burimi: BQK (2016)

Kreditë e reja vazhdojnë të dominohen nga kreditë ndaj ndërmarrjeve, të cilat në vitin 2015 përfaqësuan 63.4 përqind të gjithsej kredive të reja dhe shënuan rritje vjetore prej 13.6 përqind (figura 47). Ndërsa, kreditë e reja të destinuar për ekonomitë familjare përbëjnë 36.6 përqind të gjithsej kredive të reja dhe shënuan rritje vjetore prej 6.6 përqind (figura 48).


Struktura e kredive të reja ndaj ndërmarrjeve përbëhet nga kreditë investuese, kreditë jo-investuese dhe kreditë me kushte favorizuese. Kreditë investuese vazhdojnë të dominojnë me pjesëmarrje prej 63.6 përqind në gjithsej kreditë e reja të ndërmarrjeve (figura 49). Kreditë jo-investuese dhe ato me kushte favorizuese në vitin 2015 përfaqësuan 29.5 përqind përkatësisht 6.9 përqind të gjithsej kredive të reja të lëshuara për ndërmarrjet.

Figura 48. Kreditë e reja sipas sektorëve, ndryshimi vjetor



Burimi: BQK (2016)

Figura 49. Kreditë e reja sipas sektorëve dhe qëllimit të përdorimit




Burimi: BQK (2016)

Struktura e kredive të reja të lëshuara për ekonomitë familjare përbëhet kryesisht nga kreditë konsumuese, kreditë hipotekare dhe kreditë me kushte favorizuese. Kreditë konsumuese në vitin 2015 kishin një pjesëmarrje prej 67.8 përqind në gjithsej kreditë e reja ndaj ekonomive familjare (74.4 përqind në vitin 2014). Kreditë hipotekare dhe ato me kushte favorizuese gjatë kësaj periudhe rritën pjesëmarrjen në gjithsej kreditë e reja ndaj ekonomive familjare. Kreditë hipotekare kishin një pjesëmarrje prej 16.8 përqind në gjithsej kreditë e reja për ekonomitë familjare (14.0 përqind në vitin 2014), përderisa ato me kushte favorizuese kishin pjesëmarrje prej 12.3 përqind (8.5 përqind në vitin 2014).

Me qëllim që të identifikohen dhe krahasohen efektet e kredive të reja, kredive të kthyera, si dhe kredive të shlyera (angl. write-offs) në rritjen e stokut të gjithsej kredive aktive, në figurën 50 janë paraqitur trendet e zhvillimit të këtyre tri kategorive. Kreditë e reja ndikojnë pozitivisht në rritjen e kësaj vlere, ndërsa kthimi i kredive si dhe kreditë e shlyera kanë efekt zvogëlues në vlerën e gjithsej kredive aktive.

Figura 50. Gjithsej kreditë, kreditë e reja, kreditë e paguara dhe kreditë e pakthyer, në milionë euro



Burimi: BQK (2016)

Vlera e kredive të reja gjatë vitit 2015

shënoi rritje vjetore të ngadalësuar krahasuar me rritjen e theksuar gjatë vitit të kaluar. Kreditë e shlyera gjatë kësaj periudhe po ashtu shënuan rritje mjaft të ulët (4.4 përqind) krahasuar me rritjen e theksuar vjetore gjatë periudhës paraprake (28.9 përqind në vitin 2014). Kurse, kreditë e shlyera në vitin 2015 shënuan rritje vjetore prej 54.3 përqind (rënie prej 21.6 përqind në vitin 2014). Ngadalësimi i theksuar i kredive të kthyera krahasuar me vitin e kaluar reflekton lëvizjet në maturimin e gjithsej kredive aktive. Kreditë me afat më të gjatë maturimi rritën pjesëmarrjen e tyre, përderisa ato me afat më të shkurtër maturimi zvogëluan pjesëmarrjen në gjithsej kreditë aktive. Në vitin 2015, raporti i shumës së kredive të kthyera dhe atyre të shlyera ndaj kredive të reja është zvogëluar në 87.6 përqind krahasuar me 92.3 në vitin 2014. Zvogëlimi i pjesëmarrjes së kredive të kthyera dhe atyre të shlyera në raport me gjithsej kreditë e reja ka efekt pozitiv në rritjen e gjithsej stokut të kredive aktive. Kjo edhe u reflektua në rritjen vjetore prej 7.3 përqind të gjithsej stokut të kredive në vitin 2015 krahasuar me rritjen prej 4.2 përqind në vitin e kaluar.


Raporti i kredive të shlyera ndaj gjithsej kredive të reja u rrit në 2.2 përqind nga 1.6 përqind sa ishte në vitin 2014. Pavarësisht rritjes së lehtë të kredive të shlyera, si rezultat i vlerës mjaft të ulët në krahasim me kreditë e reja, efekti i tyre zvogëlues në gjithsej stokun e kredive aktive ishte mjaft i ulët. Kurse, raporti i kredive të kthyera ndaj gjithsej kredive të reja u zvogëluar në

85.4 përqind nga 90.7 përqind sa ishte në vitin 2014. Pra, ngadalësimi i theksuar i rritjes së gjithsej kredive të kthyera (si rezultat i zgjatjes së maturimit të kredive) ka ndikuar pozitivisht në rritjen e gjithsej stokut të kredive aktive gjatë kësaj periudhe.

Raporti i shumës së kredive të kthyera dhe atyre të shlyera ndaj kredive të reja të lëshuara te kreditë e ndërmarrjeve zbriti në 89.0 përqind nga 93.7 përqind sa ishte në vitin e kaluar. Kurse, te ekonomitë familjare ky raport shënoi rritje të lehtë në 85.0 përqind nga 84.7 përqind sa ishte në vitin paraprak.


Anketa e Kreditimit Bankar¹³

Figura 51. Ndryshimet e përgjithshme në ofertën kredituese dhe në kërkesën për kredi në gjashtë muajt e fundit



Burimi: BQK (2016)

Figura 52. Pritjet e bankave rreth standardeve kreditore dhe kërkesës për kredi në gjashtë muajt e ardhshëm



Burimi: BQK (2016)

Rezultatet e fundit të Anketës së Kreditimit Bankar pasqyrojnë zhvillimet në aktivitetin e kreditimit bankar gjatë periudhës shtator 2015 – shkurt 2016, si dhe pritjet për aktivitetin kreditues në periudhën mars – shtator 2016. Pyetësi mbulon ndryshimet në standardet kreditore si dhe rregullat dhe kushtet për kreditë (gjegjësisht ofertën e bankave) si dhe kërkesën për kredi¹⁴, të ndarë sipas qëllimit të përdorimit në kreditë për ndërmarrjet (NVM dhe ndërmarrje të mëdha) dhe ekonomitë familjare (kreditë konsumuese dhe kreditë për blerje të shtëpive).

Aktiviteti kreditues në gjysmën e dytë të vitit 2015 dhe në muajt e parë të vitit 2016 është karakterizuar me një rritëm të përshpejtuar të rritjes. Dinamika e aktivitetit kreditues vlerësohet të ketë qenë në nivelin më të lartë në tre vitet e fundit. Trendi i përshpejtuar i rritjes së kreditimit që karakterizoi vitin 2015 dhe muajt e parë të vitit 2016, sipas anketës së kreditimit bankar, i atribuohet përmirësimit të kushteve të kreditimit dhe rritjes së konsiderueshme të kërkesës për kredi (figura 51)¹⁵. Në gjashtë muajt e ardhshëm (mars-shtator 2016), oferta kredituese e bankave, shprehur përmes standardeve të aplikuarat kreditore dhe rregullave dhe kushteve të kreditimit, pritet të mbetet përgjithësisht e lehtësuar. Gjithashtu, kërkesa për kredi për gjashtë muajt e ardhshëm pritet të shënojë rritje (figura 52).

Bankat deklaruan të kenë aplikuar standarde më të lehtësuara kreditore për ekonomitë familjare, përderisa për ndërmarrjet, standardet kreditore mbetën përgjithësisht të

¹³ Anketa e Kreditimit Bankar realizohet nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës me bankat që operojnë në Kosovë. Anketa realizohet dy herë në vit, duke përfshirë periudhën mars – shtator dhe periudhën tetor – shkurt.

¹⁴ A) Standardet Kreditore: Standardet kreditore paraqesin kriteret e brendshme të bankave, të cilat e reflektojnë politikën kreditore të bankës. Këto kriteret mund të jenë të shkruara ose të pashkruara dhe definojnë llojet e kredive të cilat konsiderohen nga bankat si të dëshirueshme ose jo të dëshirueshme për tu kredituar.


B) Rregullat dhe kushtet: Rregullat dhe kushtet i referohen obligimeve specifike për të cilat kanë arritur pajtim kredidhënësi dhe kredimarrësi. Në këtë anketë, rregullat dhe kushtet kanë të bëjnë me normat e interesit, madhësinë e kredisë, ngarkesat tjera përveç normave të interesit, afati i maturimit të kredisë, kërkesat për kolateral, etj.

¹⁵ Përgjigjet e bankave individuale janë agreguar duke përdorur peshën përkatëse të çdo banke në gjithsej portfolion kreditore të sektorit bankar. Vlerat pozitive e indeksit të standardeve kreditore tregojnë lehtësim dhe vlerat negative tregojnë shtrëngim. Gjithashtu, vlerat pozitive e indeksit të kërkesës për kredi tregojnë rritje të kërkesës dhe vlerat negative tregojnë rënie.

pandryshuara. Në kuadër të kredive për ekonomitë familjare, bankat lehtësuan standardet kreditore për kreditë për blerje të shtëpive.


Lehtësimi i standardeve kreditore të aplikuara për ekonomitë familjare u shoqërua me përmirësim të kushteve të kreditimit për këtë kategori. Gjithashtu, përkundër standardeve të pandryshuara, bankat raportuan për përmirësim të kushteve të kreditimit edhe për ndërmarrjet, veçanërisht për NVM-të. Për gjashtë muajt e ardhshëm (mars-shtator 2016), bankat presin lehtësim të standardeve kreditore dhe përmirësim të mëtejme të kushteve të kreditimit si për ekonomitë familjare, ashtu edhe për ndërmarrjet (figurat 53 dhe 54).

Figura 53. Standardet e aplikuara kreditore për ndërmarrjet dhe pritjet e bankave për gjashtë muajt e ardhshëm



Burimi: BQK (2016)


Figura 54. Standardet e aplikuara kreditore për ekonomitë familjare dhe pritjet e bankave për gjashtë muajt e ardhshëm



Burimi: BQK (2016)


Përgjithësisht, përmirësimi i kushteve të kreditimit nga bankat është realizuar me uljen e normave mesatare të interesit për kreditë dhe uljen e shpenzimeve tjera të jo-interesit. Sa i përket ndërmarrjeve, bankat përmirësuan kushtet e kreditimit përmes uljes së shpenzimeve tjera të interesit përderisa për ekonomitë familjare, përmes zvogëlimit të normave mesatare të interesit, uljes së shpenzimeve tjera të jo-interesit, rritjes së madhësisë së kredisë dhe zvogëlimit të kërkesave për kolateral. Në gjashtë muajt e ardhshëm, instrumentet që bankat presin të përdorin për të lehtësuar ofertën e tyre kredituese janë norma mesatare e interesit, madhësia e kredisë dhe zgjatja e afatit të maturimit, me theks të veçantë për ndërmarrjet.

Figura 55. Kërkesa për kredi nga ndërmarrjet dhe pritjet për ndryshimet në gjashtë muajt e ardhshëm



Burimi: BQK (2016)

Figura 56. Kërkesa për kredi nga ekonomitë familjare dhe pritjet për ndryshimet në gjashtë muajt e ardhshëm



Burimi: BQK (2016)

Faktorët kryesorë që shpjegojnë politikat më të lehtësuara bankare të kreditimit gjatë periudhës raportuese, sipas bankave, ishin kryesisht faktor të brendshëm, gjegjësisht rritja e konkurrencës në sistemin financiar dhe përmirësimi i cilësisë së kredive (rënia e KJP-ve). Edhe në gjashtë muajt e ardhshëm (mars – shtator 2016), bankat presin që faktorët e njëjtë të ndikojnë në lehtësimin e ofertës kredituese, gjegjësisht standardeve dhe kushteve të kreditimit.

Institucionet kredituese bankare kanë raportuar për një rritje të konsiderueshme të kërkesës për kredi gjatë fundit të vitit 2015 dhe muajve të parë të vitit 2016. Të dy kategoritë, gjegjësisht

ekonomitë familjare dhe ndërmarrjet, rritën kërkesën për kredi në këtë periudhë (figurat 55 dhe 56). Kërkesa për kredi ka qenë më e lartë veçanërisht nga NVM-të, përderisa në kontekst të maturitetit, bankat kanë raportuar rritje të kërkesës për kreditë afatgjata. Sa i përket kërkesës për kredi nga ekonomitë familjare, bankat raportuan kërkesë më të lartë nga të dy kategoritë, kreditë konsumuese dhe kreditë për blerje të shtëpive.

Rritja e kërkesës për kredi nga ndërmarrjet, sipas anketës, është mbështetur kryesisht nga rritja e financimit të kapitalit punues dhe financimit të investimeve fikse të ndërmarrjeve, përderisa rritja e kërkesës për kredi nga ekonomitë familjare është mbështetur nga zhvillimet pozitive në tregun e pasurive të paluajtshme dhe rritja e besueshmërisë së konsumatorëve. Në gjashtë muajt e ardhshëm, kërkesa nga ndërmarrjet pritet të ndikohet pozitivisht nga rritja e financimit të investimeve fikse të ndërmarrjeve dhe ristrukturimi i borxhit. Në anën tjetër, kërkesa për kredi nga ekonomitë familjare pritet të ndikohet nga rritja e shpenzimeve tjera të konsumit.

Për gjashtë muajt e ardhshëm, kërkesa për kredi pritet të shënojë rritje të mëtejme, nxitur nga ekonomitë familjare dhe NVM-të. Gjithashtu, pritet e bankave sugjerojnë për një rritje të vazhdueshme të kërkesës për kredi afatgjata.

Për periudhën shtator 2015 – shkurt 2016, bankat raportuan rënie të nivelit të KJP-ve si tek ndërmarrjet, ashtu edhe tek ekonomitë familjare. Pritjet e bankave për periudhën mars - shtator 2016 sugjerojnë për një përmirësim të mëtejme të cilësisë së portfolios kreditore të të dy kategorive.

6.2.2. Detyrimet dhe burimet vetanake

Struktura e detyrimeve dhe burimeve vetanake të sektorit bankar të Kosovës vazhdon të dominohet nga depozitat që në vitin 2015 përbëjnë 79.9 përqind të gjithëj financimit, duke përfaqësuar burimin kryesor të financimit të aktivitetit të sektorit bankar. Mbështetja e lartë në depozita të mbledhura brenda vendit eviton ekspozimin ndaj lëvizjeve në tregjet e jashtme financiare.

Burimi i dytë më i rëndësishëm i financimit të sektorit bankar janë burimet vetanake (ekuiteti) (tabela 4). Kjo kategori shënoi rritje vjetore prej 21.6 përqind, kryesisht si rezultat i rritjes së lartë të profitit të realizuar nga sektori bankar gjatë vitit 2015.

Tabela 4. Struktura e detyrimeve dhe burimeve vetanake të sektorit bankar

Përshkrimi	Dhjetor 2012		Dhjetor 2013		Dhjetor 2014		Dhjetor 2015	
	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)
Bilanci nga bankat tjera	6.0	0.2%	16.5	0.5%	31.6	1.0%	43.4	1.3%
Depozitat	2,279.0	80.6%	2,449.0	80.1%	2,537.5	79.7%	2,702.9	79.9%
Huatë tjera	18.9	0.7%	13.4	0.4%	14.1	0.4%	17.6	0.5%
Detyrimet tjera	223.6	7.9%	246.2	8.0%	232.1	7.3%	191.2	5.6%
Borxhi i ndërvarur	31.0	1.1%	56.3	1.8%	47.3	1.5%	36.9	1.1%
Mjetet vetanake	270.8	9.6%	277.8	9.1%	323.0	10.1%	392.7	11.6%
Gjithëj detyrimet	2,829.3	100%	3,059.3	100%	3,185.7	100%	3,384.7	100%

Burimi: BQK (2016)

Në kuadër të detyrimeve dhe burimeve vetanake, rritjen më të lartë vjetore prej 37.2 përqind e ka shënuar kategoria e bilancit nga bankat komerciale. Kjo kategori ka peshë të vogël në financimin e aktivitetit të bankave që operojnë në Kosovë, duke përfaqësuar 1.3 përqind të gjithëj financimit të sektorit bankar në vitin 2015. Ndërsa, kategoria e borxhit të ndërvarur, e cila përfaqëson vetëm 1.1 përqind të gjithëj financimit, vazhdoi të zvogëlohet edhe gjatë vitit 2015, duke shënuar rënie prej 22.2 përqind (rënie prej 16.0 përqind në vitin 2014). Duke pasur

parasysh se financimi përmes borxhit të ndërruarur në periudhat e kaluara kryesisht është bërë për nevoja të plotësimit të kërkesave të kapitalit, sidomos pas ndryshimit të kërkesave rregullative në vitin 2013, rënia e shfrytëzimit të këtij instrumenti në dy vitet e fundit reflekton nivelin e kënaqshëm të kapitalizimit që kanë arritur të gjitha bankat që operojnë në Kosovë.


Depozitat

Gjithsej depozitat në sektorin bankar të Kosovës në vitin 2015 arritën vlerën prej 2.70 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 6.5 përqind. Krahasuar me vitet paraprake, kur ritmi i rritjes së depozitave ishte ngadalësuar, në këtë vit është regjistruar rimëkëmbje e ecurisë së depozitave. Ndër tjerash, përshpejtimit të rritjes së depozitave mund t'i ketë kontribuar edhe ndërprerja e trendit rënës së normave të interesit në depozita që nga tremujori i dytë i vitit 2015.

Depozitat e ekonomive familjare, të cilat konsiderohen si burim më i qëndrueshëm i financimit në raport me kanalet tjera të financimit, vazhdojnë ta dominojnë strukturën e depozitave të sektorit bankar duke përfaqësuar 72.7 përqind të gjithsej depozitave (figura 57). Vlera e depozitave të ekonomive familjare, në vitin 2015, shënoi rritje vjetore prej 6.4 përqind (rritje prej 4.1 përqind në vitin 2014). Me rritje u karakterizuan edhe depozitat e ndërrmarjeve të cilat në vitin 2015 përbëjnë 21.6 përqind të gjithsej depozitave dhe shënuan rritje vjetore prej 4.2 përqind (rritje prej 0.7 përqind në vitin 2014).


Në strukturën e depozitave të ndërrmarjeve vërehet një rritje e peshës së depozitave të korporatave jofinanciare (ndërrmarjet private), pjesëmarrja e të cilave në vitin 2015 arriti 82.6 përqind nga 70.8 përqind në vitin 2014 (figura 58). Depozitat e korporatave jofinanciare shënuan rritje vjetore prej 21.6 përqind, që paraqet përmirësim të theksuar në krahasim me rënie prej 0.3 përqind të shënuar në vitin 2014. Rritja e shënuar në këtë vit gjithashtu paraqet rritjen më të lartë në gjashtë vitet e fundit duke u bërë kështu edhe kontribuesi kryesor në përshpejtimit të rritjes së depozitave të ndërrmarjeve. Ndërsa,

Figura 57. Depozitat e sektorit bankar




Burimi: BQK (2016)

Figura 58. Depozitat e ndërrmarjeve, në përqindje



Burimi: BQK (2016)

Figura 59. Depozitat e jo-rezidentëve



Burimi: BQK (2016)

kategoria e dytë për nga pesha në gjithsej depozitat e ndërmarrjeve, depozitat e korporatave tjera financiare, në vitin 2015 zvogëluan pjesëmarrjen në 12.0 përqind nga 18.2 përqind. Zvogëlimi ishte si pasojë e rënies së theksuar prej 31.2 përqind krahasuar me rritjen prej 18.1 përqind të shënuar në vitin 2014. Kategoria e depozitave të ndërmarrjeve publike gjithashtu u karakterizua me rënie të theksuar prej 49.0 përqind (rënie vjetore prej 14.3 përqind në vitin 2014).


Në pjesën e mbetur të gjithsej depozitave përfshihen depozitat e jorezidentëve me pjesëmarrje prej 4.2 përqind dhe depozitat tjera (qeveria dhe organizatat tjera jo-qeveritare) me pjesëmarrje prej 1.5 përqind. Depozitat e jorezidentëve në vitin 2015 arritën vlerën prej 113.5 milionë euro nga 88.9 milionë euro në vitin 2014 duke shënuar rritje vjetore prej 27.6 përqind (rënie 0.2 përqind në vitin 2014) (figura 59). Ndërsa, depozitat tjera u karakterizuan me rënie vjetore prej 0.3 përqind kryesisht si rezultat i rënies së depozitave të qeverisë qendrore dhe organizatave joqeveritare në bankat komerciale.

Struktura e depozitave sipas afatit të maturimit

Struktura e depozitave sipas afatit të maturimit ka pësuar ndryshime të theksuara në dy vitet e fundit. Përderisa para dy viteve depozitat e afatizuara dominonin strukturën e depozitave, në vitin 2015 kategoria kryesore e depozitave u përfaqësua nga depozitat e transferueshme me pjesëmarrje prej 54.7 përqind në gjithsej depozitat, që paraqet rritje të pjesëmarrjes prej 7.4 pikë përqindje krahasuar me vitin paraprak. Depozitat e afatizuara kishin një pjesëmarrje prej 24.8 përqind në gjithsej depozitat, që përkon me zvogëlim të pjesëmarrjes prej 6.9 pikë përqindje. Ndërsa, depozitat e kursimit mbeten kategoria e tretë për nga madhësia me pjesëmarrje prej 20.6 përqind (zvogëlim të pjesëmarrjes prej 0.5 përqind) (figura 60).


Depozitat e transferueshme në vitin 2015 shënuan rritjen më të lartë vjetore prej 23.3 përqind. Në kuadër të depozitave të transferueshme, depozitat e ekonomive familjare regjistruan rritje vjetore prej 23.6 përqind. Depozitat e transferueshme të ndërmarrjeve janë karakterizuar me rritje vjetore prej 19.0 përqind, përderisa depozitat tjera të transferueshme (depozitat e qeverisë dhe organizatave tjera joqeveritare) dhe depozitat e jorezidentëve shënuan rritje vjetore prej 13.2 përqind përkatësisht 56.9 përqind në vitin 2015.

Figura 60. Struktura e depozitave sipas afatit të maturimit



Burimi: BQK (2016)

Figura 61. Depozitat e afatizuara




Burimi: BQK (2016)

Depozitat e afatizuara vazhduan trendin e rënies edhe gjatë vitit 2015, kur shënuan rënie vjetore prej 16.7 përqind (rënie vjetore prej 29.7 përqind në vitin 2014). Depozitat e afatizuara të ekonomive familjare shënuan rënie prej 14.8 përqind (rënie prej 31.6 në vitin 2014), përderisa depozitat e afatizuara të ndërmarrjeve shënuan rënie vjetore prej 19.7 përqind për dallim nga rënia prej 20.5 përqind që kishin shënuar në vitin 2014. Rënia ishte më e theksuar te depozitat tjera të afatizuara (depozitat e qeverisë dhe organizatave tjera joqeveritare) dhe depozitat ndaj jorezidentëve, të cilat shënuan rënie vjetore prej 87.7 përqind përkatësisht 34.2 përqind në vitin 2015. Rënia e vazhdueshme e depozitave të afatizuara reflekton nivelin e ulët të normave të interesit në depozita që ka mbizotëruar në sektorin bankar të Kosovës në dy vitet e fundit.

Përderisa vlera e përgjithshme e depozitave të afatizuara ka shënuar rënie, përbrenda strukturës së kësaj kategorie të depozitave vërehet rritje e depozitave të afatizuara me afat më të gjatë maturimi. Në vitin 2015, krahasuar me vitin e kaluar, është regjistruar rritje e depozitave me afat të mesëm dhe me afat të gjatë maturimi, kurse depozitat me afat të shkurtër maturimi kanë shënuar rënie (figura 61). Në vitin 2015, depozitat me afat maturimi ‘deri në 1 vit’ kishin pjesëmarrje prej 26.0 përqind në gjithsej depozitat e afatizuara, që paraqet një rënie prej 24.5 pikë përqindje krahasuar me vitin paraprak. Depozitat me afat maturimi ‘nga 1 deri në 2 vite’ rritën pjesëmarrjen në 35.2 përqind nga 22.7 në vitin 2014, përderisa depozitat me afat maturimi ‘mbi 2 vite’ rritën pjesëmarrjen në 38.7 përqind nga 26.8 përqind në vitin 2014. Kjo zhvendosje e depozitave drejt atyre me afat më të gjatë maturimi mund të jetë ndikuar nga normat më të favorshme të interesit në depozitat afatgjata kundrejt normave tejet të ulëta në depozitat e afatizuara me maturim afatshkurtër.


Depozitat në formë të kursimeve kanë vazhduar trendin pozitiv të rritjes megjithëse me ritëm më të ngadalësuar, ku në vitin 2015 shënuan rritje vjetore prej 3.8 përqind (32.4 përqind në vitin 2014). Ngadalësimi mund të jetë ndikuar nga aplikimi i tarifave të mirëmbajtjes për llogari të

Figura 62. Norma mesatare e interesit




Burimi: BQK (2016)

Figura 63. Normat e interesit në Kosovë dhe vendet e Ballkanit Perëndimor, 2015



Burimi: FMN, Bankat Qendrore të vendeve përkatëse (2016)

Figura 64. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare



Burimi: BQK (2016)

kursimeve prej disa bankave në vitin 2015 për dallim nga viti i kaluar kur nuk kishte tarifa të mirëmbajtjes për këto llogari. Depozitat e ekonomive familjare, që përfaqësojnë 94.4 përqind të gjithsej depozitave të kursimit, shënuan rritje vjetore prej 6.7 përqind (32.2 përqind në vitin 2014). Depozitat e jorezidentëve kanë shënuar rritje vjetore prej 7.8 përqind në vitin 2015 (40.3 përqind në vitin 2014).

6.2.3. Normat e Interesit


Për dallim nga vitet e kaluara, kur normat e interesit në kredi dhe depozita patën ndjekur trend të ngjashëm, gjatë vitit 2015 u karakterizuan me prirje të kundërta. Norma mesatare e interesit në kredi shënoi rënien më të theksuar të viteve të fundit, duke zbritur në 7.7 përqind në dhjetor 2015 (9.3 përqind në dhjetor 2014). Në anën tjetër, norma mesatare e interesit në depozita që nga tremujori i dytë i vitit 2015 ndërpreu trendin rënës dhe shënoi rritje të lehtë gjatë pjesës më të madhe të vitit duke arritur në 1.2 përqind në dhjetor 2015 (1.1 përqind në dhjetor 2014). Rrjedhimisht edhe dallimi në mes të normës së interesit në kredi dhe normës së interesit në depozitau zvogëluar në 6.5 përqind nga 8.2 përqind sa ishte në dhjetor 2014 (figura 62). Normat e interesit në kredi dhe depozita të sektorit bankar në Kosovë qëndrojnë në nivele të përafërta me ato të vendeve të rajonit (figura 63).

Normat e interesit në kredi

Trendi rënës i normës së interesit në kredi gjatë vitit 2015 vërehet si te kreditë ndaj ndërmarrjeve ashtu dhe te kreditë ndaj ekonomive familjare (figura 64). Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve në dhjetor 2015 zbriti në 7.4 përqind nga 9.6 përqind sa ishte në dhjetor 2014. Në kuadër të kredive ndaj ndërmarrjeve, kreditë investuese vazhdojnë të mbesin kategoria me normat më të ulëta të interesit (7.2 përqind në dhjetor 2015), megjithatë në fund të vitit 2015 edhe kreditë jo-investuese regjistruan vlera njëshifrore të normave të interesit (7.8 përqind në dhjetor 2015) (figura 65). Zvogëlimi i normave të interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve u reflektua më shumë në ecurinë e kredive të reja investuese (rritje vjetore prej 20.8 përqind në vitin 2015) krahasuar me kreditë e reja jo-investuese (rritje vjetore prej 7.1 përqind në vitin 2015). Me rënie të normave të interesit u karakterizuan edhe kategoritë tjera si mbitërheqjet dhe linjat e ndryshme kreditore ndaj ndërmarrjeve.


Sipas afatit të maturimit, me rënie të normës së interesit u karakterizuan të gjitha kategoritë e kredive të ndërmarrjeve, por rënia ishte më e theksuar te kreditë afatmesme, norma mesatare e të cilave u zvogëluar për 2.8 pikë përqindje.

Figura 65. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve, sipas qëllimit



Burimi: BQK (2016)

Figura 66. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve, sipas maturimit




Burimi: BQK (2016)

Norma më e ulët e interesit prej 6.9 përqind u regjistrua te kreditë afatgjata me afat maturimi 'mbi 5 deri në 10 vite' gjë që u reflektua në rritjen e lartë vjetore prej 62.6 përqind të kredive të reja në këtë kategori. Ndërsa, norma më e lartë e interesit prej 8.0 përqind u regjistrua te kreditë afatshkurta me afat maturimi 'deri 1 vit' (figura 66). Norma e interesit në kreditë afatmesme me afat maturimi 'mbi 2 deri 5 vite' që përfaqësojnë pjesën më të madhe të gjithëj stokut të kredive dhe kredive të reja, shënuan rënie vjetore për 2.6 pikë përqindje, duke arritur në 7.4 përqind në dhjetor 2015.

Kreditë ndaj ndërmarrjeve u karakterizuan me rënie të normave të interesit në kredi edhe në të gjitha kategoritë e veprimtarive ekonomike. Rënia ishte më e evidente në kreditë ndaj sektorit të bujqësisë të cilat në dhjetor 2015 ishin kategoria me normën më të ulët të interesit krahasuar me periudhën paraprake kur paraqisnin kategorinë me normën më të lartë të interesit. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj sektorit të bujqësisë në dhjetor 2015, u zvogëlua në 7.1 përqind nga 11.3 përqind sa ishte në dhjetor 2014 (figura 67). Zvogëlimi i theksuar, ndër tjerash ka ndikuar në rritjen e theksuar të gjithëj stokut të kredive për këtë sektor dhe gjithëj kredive të reja në vitin 2015. Norma e interesit në kreditë ndaj sektorit të shërbimeve (përfshirë edhe tregtinë që përfaqëson 70.7 përqind të gjithëj stokut të kredive të shërbimeve) u zvogëlua në 7.4 përqind në dhjetor 2015 (10.0 përqind në dhjetor 2014) duke u reflektuar në rritje të përsheptuar të kreditimit të këtij sektori. Normat e interesit në kreditë ndaj sektorit të industrisë u zvogëluan në 7.4 përqind në dhjetor 2015 (8.9 përqind në dhjetor 2014) megjithatë, përkundër rënies së normave të interesit, kreditë e reja ndaj sektorit të industrisë shënuan ngadalësim të rritjes.


Në kreditë ndaj ekonomive familjare në dhjetor 2015, norma mesatare e interesit u zvogëlua në 8.4 përqind nga 8.9 përqind sa ishte në dhjetor 2014. Rënia më e theksuar në 7.0 përqind nga 7.9 përqind në dhjetor 2014 u regjistrua te kreditë hipotekare. Ndërsa në kreditë konsumuese norma e interesit u zvogëlua në 8.7 përqind nga 9.1 përqind në dhjetor 2014 (figura 68). Në kuadër të kredive hipotekare, kreditë me maturim më afatgjatë kishin norma më të favorshme të interesit krahasuar me ato afatshkurta. Norma më e ulët e interesit prej 5.9 përqind u regjistrua në kreditë hipotekare me afat maturimi 'mbi 10 vite', ndërsa më e larta prej 7.4 përqind u regjistrua në ato me afat maturimi 'mbi 2 vite deri në 5 vite'. Kreditë me afat maturimi 'mbi 10 vite' gjithashtu shënuan rënie më të theksuar vjetore të normave të interesit prej 1.9 pikë përqindje në kuadër të kredive hipotekare.

Figura 67. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve, sipas veprimtarisë ekonomike



Burimi: BQK (2016)

Figura 68. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare, sipas qëllimit



Burimi: BQK (2016)

Normat e interesit në depozita

Norma mesatare e interesit në depozita u rrit në 1.2 përqind në dhjetor 2015 nga 1.1 përqind sa ishte në dhjetor 2014. Trendi rritës i normës së interesit në gjithsej depozitat kryesisht reflekton lëvizjen e normës së interesit në depozitat e ekonomive familjare të cilat edhe dominojnë strukturën e depozitave të sektorit bankar (figura 69). Norma e interesit në depozitat e ndërmarrjeve ndërpreu trendin rënës vetëm në tremujorin e katërt të vitit 2015, megjithatë gjatë pjesës më të madhe të vitit norma e interesit në depozitat e ndërmarrjeve ishte më e lartë krahasuar me atë në depozitat e ekonomive familjare.


Norma mesatare e interesit në depozitat e ndërmarrjeve u zvogëlua në 1.5 përqind në dhjetor 2015 nga 1.6 përqind sa ishte në dhjetor 2014. Në kuadër të depozitave të ndërmarrjeve, norma e interesit për depozitat e afatizuara u zvogëlua në 1.5 përqind në dhjetor 2015 (1.6 në dhjetor 2014), përderisa për depozitat e kursimeve zbriti në 0.1 përqind (0.7 përqind në dhjetor 2014) (figura 70). Në kuadër të ndërmarrjeve, në dhjetor 2015, norma më e ulët e interesit prej 0.7 përqind ishte e pranishme në depozitat me afat maturimi 'mbi 1 muaj deri në 3 muaj', përderisa norma më e lartë prej 3.2 përqind u has në depozitat me afat maturimi 'mbi 2 vite'.

Norma e interesit në depozitat e ekonomive familjare në dhjetor 2015 arriti në 1.1 përqind nga 0.9 përqind sa ishte në dhjetor 2014 (figura 69). Trendi pozitiv i normës mesatare të interesit në depozita kryesisht reflekton rritjen e

lehtë të normës së interesit në depozitat e afatizuara, krahas rënies së normës së interesit në depozitat e kursimeve. Në dhjetor 2015, norma e interesit në depozitat e afatizuara të ekonomive familjare arriti në 1.1 përqind nga 0.9 përqind sa ishte në dhjetor 2014 (figura 71).


Në kuadër të depozitave të afatizuara, norma më e ulët e interesit prej 0.2 përqind u regjistrua në depozitat me afat maturimi 'deri në 1 muaj', përderisa ajo më e larta prej 2.2 përqind u

Figura 69. Norma mesatare e interesit në depozita




Burimi: BQK (2016)

Figura 70. Norma mesatare e interesit në depozitat e ndërmarrjeve, sipas kategorive



Burimi: BQK (2016)

Figura 71. Norma mesatare e interesit në depozitat e ekonomive familjare, sipas kategorive



Burimi: BQK (2016)

regjistrua në depozitat me afat maturimi ‘mbi 2 vite’. Ndërsa, rritjen më të theksuar vjetore prej 0.6 pikë përqindje e shënoi norma e interesit në depozitat me afat maturimi ‘mbi 1 vit deri në 2 vite’. Në anën tjetër, norma e interesit në depozitat e kursimeve të ekonomive familjare në dhjetor 2015 u zvogëluar në 0.3 përqind nga 0.6 përqind sa ishte në dhjetor 2014.

6.3. Performanca e Sektorit Bankar

Sektori bankar edhe gjatë vitit 2015 shënoi përmirësim të treguesve kyç të performancës dhe profitabilitetit ku profiti i realizuar arriti vlerën prej 94.3 milionë euro në vitin 2015 (60.5 milionë në vitin 2014) (figura 72). Përmirësimi i performancës financiare, ishte kryesisht si rezultat i reduktimit të theksuar të shpenzimeve krahas rënies së lehtë të të hyrave të sektorit bankar.


Të hyrat

Sektori bankar gjatë katër viteve të fundit u karakterizua me përqendrim të ecurisë së gjenerimit të të hyrave. Të hyrat e sektorit bankar në vitin 2015 arritën vlerën prej 238.3 milionë euro, që paraqet një rënie vjetore prej 2.8 përqind krahas rënies prej 1.5 përqind të shënuar në vitin 2014.

Struktura e të hyrave të sektorit mbetet e ngjashme me periudhat paraprake duke u përbërë kryesisht prej të hyrave nga interesi (78.0 përqind), të pasuara nga të hyrat nga jointerësi (21.7 përqind), dhe të hyrat nga rivlerësimi (0.3 përqind) (figura 73). Sa i përket ecurisë së kategorive të të hyrave gjatë vitit 2015 sektori bankar shënoi rënie të të hyrave nga interesi krahas rritjes së të hyrave nga jointerësi dhe rivlerësimi.


Kategoria e të hyrave nga interesi, e cila përfshinë të hyrat nga interesi në kredi, letra me vlerë, plasmane me bankat tjera dhe të hyrat tjera, shënoi rënie vjetore prej 5.7 përqind në vitin 2015, duke dhënë kontributin kryesor në rënien e gjithsej të hyrave të sektorit bankar. Rënia e gjithsej të hyrave nga interesi ishte kryesisht rezultat i rënies prej 5.4 përqind të të hyrave nga interesi në kredi, të cilat edhe janë përcaktuesi kryesor i trendit të gjithsej të hyrave nga interesi duke marrë parasysh që përbëjnë 97.0 përqind të kësaj kategorie të hyrave (figura 74). Rënia e të hyrave nga interesi në kredi në masë të madhe i atribuohet rënies së normave të interesit, pavarësisht përsheptimit të aktivitetit kreditor. Në kuadër të të hyrave nga interesi, të hyrat nga interesi në letrat me vlerë ishin kategoria e vetme e cila u karakterizua me rritje prej 53.1 përqind në vitin 2015 (figura 75). Përmirësimi ishte si rezultat i përsheptimit të rritjes së investimeve në letrat me vlerë si dhe normave më të favorshme të kthimit nga investimet gjatë kësaj periudhe.

Figura 72. Performanca financiare e sektorit bankar



Burimi: BQK (2016)

Figura 73. Të hyrat e sektorit bankar, në përqindje



Burimi: BQK (2016)

Kategoria e dytë për nga pesha në strukturën e gjithsej hyrave janë të hyrat nga jointerеси të cilat shënuan rritje vjetore prej 8.3 përqind në vitin 2015. Rritja ishte kryesisht si rezultat i rritjes së të hyrave nga tarifat dhe komisionet që, ndër tjerash, reflekton shtrenjtimin e shërbimeve të ofruara në degët bankare. Të hyrat nga tarifat dhe komisionet përfaqësuan rreth 91.3 përqind të gjithsej të hyrave nga jointerеси dhe shënuan rritje vjetore prej 5.8 përqind në vitin 2015. Po ashtu, edhe të hyrat tjera operative në kuadër të të hyrave nga jointerеси në vitin 2015 u karakterizuan me rritje të theksuar vjetore prej 44.2 përqind si rezultat i rritjes së fitimit nga këmbimet valutore.


Të hyrat nga rivlerësimi arritën vlerën në 0.7 milionë euro në vitin 2015 krahasuar me 0.5 milionë euro sa ishin në vitin paraprak. Rritja e kësaj kategorie në përgjithësi ishte si rezultat i realizimit të të hyrave nga shitja e mjeteve të tregtueshme (instrumenteve financiare) me çmim më të volitshëm të rivlerësuar.

Shpenzimet

Ngjashëm me tri vitet paraprake, edhe në vitin 2015, sektori bankar shënoi rënie të shpenzimeve. Vlera e gjithsej shpenzimeve të sektorit në vitin 2015 ishte 144.0 milionë euro, e cila është për 22.1 përqind më e ulët krahasuar me vitin 2014. Rënia e gjithsej shpenzimeve të sektorit bankar i atribuohet përmirësimit të cilësisë së portofolit kreditor, që çoi në rënie të shpenzimeve për mbulimin e humbjeve të mundshme nga kreditë, si dhe rënies së shpenzimeve të interesit në depozita.


Struktura e shpenzimeve të sektorit bankar dominohet nga kategoria e shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative, e cila në vitin 2015 ka rritur pjesëmarrjen në 75.0 përqind (55.3 përqind në vitin 2014). Shpenzimet e interesit përfaqësojnë kategorinë e dytë për nga madhësia me pjesëmarrje prej 15.7 përqind në gjithsej shpenzimet, pasuar nga kategoria e shpenzimeve të jointerесit me pjesëmarrje prej 2.5 përqind (figura 76).

Figura 74. Të hyrat e interesit të sektorit bankar, në përqindje




Burimi: BQK (2016)

Figura 75. Të hyrat e sektorit bankar, ndryshimi vjetor



Burimi: BQK (2016)

Figura 76. Shpenzimet e sektorit bankar, në përqindje



Burimi: BQK (2016)


Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative shënuan rritje vjetore prej 5.6 përqind në vitin 2015 (1.7 përqind në vitin 2014) (figura 77). Kontributin kryesor në këtë rritje e kishin shpenzimet tjera nga jointerеси të cilat shënuan rritje vjetore prej 14.0 përqind kryesisht si rezultat i rritjes së shpenzimeve për provizionet ligjore dhe shpenzimeve tjera të pashpalosura.

Po ashtu, rritje shënuan edhe shpenzimet e personelit të cilat ishin për 3.1 përqind më të larta se sa në vitin paraprak, përderisa kategoria e shpenzimeve të përgjithshme regjistroi rritje vjetore prej 2.9 përqind.

Kategoria e shpenzimeve të interesit, në vitin 2015 shënoi rënie vjetore prej 48.6 përqind që paraqet thellim të mëtutjeshëm të rënies prej 30.9 përqind të shënuar në vitin 2014, duke dhënë kështu kontribut të lartë në zvogëlimin e gjithsej shpenzimeve të sektorit bankar. Thellimi i rënies i atribuohet kryesisht zvogëlimit të shpenzimeve të interesit në depozita si komponent kryesor i kësaj kategorie (me pjesëmarrje prej 73.9 përqind). Shpenzimet e interesit në depozita shënuan rënie vjetore prej 53.9 përqind në vitin 2015 (figura 78).


Kategoria e shpenzimeve të jointerесit u karakterizua me rënie vjetore prej 88.7 përqind në 2015 dhe kishte kontributin kryesor në zvogëlimin e gjithsej shpenzimeve të sektorit bankar. Zvogëlimi kryesisht i atribuohet rënies vjetore prej 141.1 përqind të shpenzimeve të provizioneve për humbje të mundshme nga kreditë, kryesisht si rezultat i përmirësimit të cilësisë së kredive (figura 79). Me gjithë zvogëlimin e shpenzimeve për provizione, shkalla e mbulueshmërisë së kredive joperformuese me provizione vazhdon të jetë në nivel të kënaqshëm duke qëndruar në 115.1 përqind në vitin 2015 (114.4 përqind në vitin 2014).

Figura 77. Shpenzimet e sektorit bankar, ndryshimi vjetor




Burimi: BQK (2016)

Figura 78. Shpenzimet e interesit dhe jointerесit sipas kategorie, ndryshimi vjetor



Burimi: BQK (2016)

Figura 79. Kreditë joperformuese dhe provizionet për humbjet e kredive, ndryshimi vjetor




Burimi: BQK (2016)

Profitabiliteti dhe efikasiteti

Profiti i realizuar në vitin 2015 ndikoi në përmirësimin e mëtutjeshëm të treguesve të profitabilitetit të sektorit bankar krahasuar me vitin paraprak. Kthimi në Mesataren e Aseteve (KMA) arriti në 3.2 përqind nga 2.2 përqind sa ishte në vitin 2014. Kthimi në Mesataren e Kapitalit (KMK) gjithashtu shënoi rritje duke arritur në 29.0 përqind nga 22.6 përqind sa ishte në vitin 2014¹⁶ (figura 80).


Zvogëlimi i theksuar i shpenzimeve, përkundër rënies së lehtë të të hyrave, ka ndikuar në përmirësimin e treguesit të përgjithshëm të efikasitetit, i cili shprehet përmes raportit të shpenzimeve ndaj të hyrave të përgjithshme. Ky raport në vitin 2015 u zvogëlua në 60.4 përqind nga 75.3 përqind sa ishte në vitin paraprak (figura 81). Në tabelën 4 janë të paraqitur treguesit kyç të cilët masin efikasitetin e sektorit bankar në krijimin e të hyrave prej asetëve (nga kreditë, letrat me vlerë dhe huazimeve ndaj bankave tjera), dhe menaxhimin e shpenzimeve (të depozitave, borxhit të ndërvarur dhe huazimeve tjera). Të hyrat e krijuara nga asetet të cilat sjellin përfitime për bankat kanë shënuar rënie (në 6.7 përqind në vitin 2015 nga 7.8 në vitin 2014) kryesisht si rezultat i rënies së normave të interesit në kredi që u reflektuan edhe në të hyrat e bankave. Në anën tjetër, shpenzimet e krijuara nga shfrytëzimi i mjeteve të klientëve ka shënuar rënie (në 0.8 përqind në vitin 2015 nga 1.7 përqind në vitin 2014) kryesisht si rezultat i rënies së shpenzimeve të interesit në depozita. Lëvizjet në normat e interesit në kredi dhe depozita ndikuan që margjina neto e interesit (neto të hyrat nga interesi / mesataren e asetëve që sjellin interes) të zvogëlohet në 5.9 përqind nga 6.1 përqind në vitin 2014. Përderisa raporti i shpenzimeve operacionale ndaj gjithsej asetëve mbeti i njëjtë me vitin e kaluar, në 3.2 përqind (tabela 5).

Figura 80. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar



Burimi: BQK (2016)

Figura 81. Raporti shpenzime/të hyra, në përqindje



Burimi: BQK (2016)

Tabela 5. Treguesit kyç të efikasitetit të sektorit bankar, në përqindje

Përshkrimi	Dhjetor 2012	Dhjetor 2013	Dhjetor 2014	Dhjetor 2015
Të hyrat nga interesi / mesatarja e asetëve që sjellin të hyra	9.0%	8.9%	7.8%	6.7%
Shpenzimet për interesa / mesatarja e detyrimeve që shkaktajnë shpenzime	2.8%	2.7%	1.7%	0.8%
Margjina neto e interesit	6.2%	6.1%	6.1%	5.9%
Shpenzimet operacionale / gjithsej asetet	3.6%	3.3%	3.2%	3.2%

Burimi: BQK (2016)

¹⁶ Në kalkulimin e KMA dhe KMK, është konsideruar profiti para taksave.

Në tabelën 6 janë paraqitur disa tregues të kapacitetit të sektorit bankar, zhvillimi i të cilëve gjatë viteve të fundit tregojnë rritje të shfrytëzimit të kapaciteteve të sektorit. Kjo shprehet përmes indikatorëve që paraqesin raportin e vlerës mesatare të aseteve të menaxhuara nga një punëtor si dhe raportit të numrit mesatar të kredive të lëshuara nga një punëtor. Të dhënat për të dy indikatorët në vitin 2015 sugjerojnë rritje të shfrytëzimit të kapaciteteve nga sektori bankar i Kosovës. Përmirësimi i këtyre dy indikatorëve u ndikua nga rritja më e lartë e aktivitetit të sektorit bankar në vitin 2015 krahas rënies së numrit të të punësuarve në sektorin bankar. Në vitin 2015, numri i të punësuarëve në sektorin bankar zbriti në 3,375 nga 3,507 sa ishte në vitin 2014. Një tregues tjetër i kapacitetit të sektorit bankar, shprehur si raport i profitit të realizuar për një punëtor, ka shënuar përmirësim të theksuar. Kjo erdhi si rezultat i profitit të lartë të realizuar gjatë vitit 2015 dhe zvogëlimit të numrit të punëtorëve në krahasim me vitin 2014. Kurse, me gjithë zvogëlimin e numrit të punëtorëve gjatë vitit 2015, raporti ndërmjet gjithësej shpenzimeve të personelit dhe numrit të punëtorëve në sektorin bankar shënoi rritje.

Tabela 6. Tregues të kapacitetit të sektorit bankar


Përshkrimi	Dhjetor 2012	Dhjetor 2013	Dhjetor 2014	Dhjetor 2015
Asetet/nr i punëtorve (në mijëra euro)	759.1	862.0	908.4	1002.9
Numri i kredive/nr i punëtorve	119.7	121.5	135.4	147.0
Profiti/nr i punëtorve (në mijëra euro)	5.0	7.3	17.3	27.9
Shpenzime e personelit/nr i punëtorëve (në mijëra euro)	11.4	11.9	12.2	13.0

Burimi: BQK (2016)

6.4 Rreziqet e Sektorit Bankar

Indikatorët kryesor të rreziqeve bankare dhe performancës së sektorit bankar kanë shënuar përmirësim të mëtajmë gjatë vitit 2015 (figurën 82). Ekspozimi ndaj rrezikut kreditor dhe solvences ka shënuar rënie si rrjedhojë e rënies së kredive joperformuese dhe rritjes së nivelit të kapitalizimit të sektorit bankar. Treguesit e likuiditetit vazhdojnë të qëndrojnë në nivele të kënaqshme përkundër rritjes së përshpejtuar të kreditimit. Në vitin 2015 Eurozona u karakterizua me normë të rritjes prej 1.7 përqind për dallim nga rritja prej 0.9 përqind në vitin 2014. Bankat më të mëdha në vend i takojnë vendeve të Eurozonës, andaj zhvillimet në sektorin bankar mund të reflektohen në tregun tonë. Po ashtu, remitencat të cilat paraqesin një burim mjaft të rëndësishëm të konsumit të brendshëm kanë ndikim pozitiv në ecurinë dhe cilësinë e portofolit kreditor. Ekonomia e Kosovës poashtu në vitin 2015 u karakterizua me rritje më të lartë vjetore prej 3.5 përqind krahasuar me rritjen prej 1.2 përqind në vitin 2014.¹⁷ Rritja e përshpejtuar ekonomike gjatë vitit 2015 krahasuar me vitin e

Figura 82. Harta e rreziqeve të sektorit bankar, në përqindje



Burimi: BQK (2016)

¹⁷ Norma e rritjes vjetore së BPV-së së Kosovës për vitin 2015 është parashikim i BQK-së, ndërsa norma e rritjes vjetore të BPV-së së Eurozonës ka për burim statistikën e FMN-së.

kaluar ishte si rezultat i rritjes së kërkesës së brendshme (konsumit dhe investimeve) dhe ka ndikuar në rritjen e kërkesës për financim prej sektorit bankar.

Kapitali i sektorit bankar shënoi rritje gjatë vitit 2015 si rrjedhojë e rritjes së fitimit neto, duke rezultuar në ngritje të cilësisë së kapitalit si dhe treguesve të kapitalizimit të sektorit. Pozita e përforcuar e kapitalit sugjeron qëndrueshmëri më të lartë të sektorit bankar dhe aftësi më të lartë për të përballuar humbjet potenciale. Rreziku kreditor ka shënuar rënie gjatë vitit 2015, duke u pasqyruar me normë më të ulët të kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive. Po ashtu, mbulueshmëria e kredive joperformuese me provizione për humbje nga kreditë është rritur, që tregon për mbrojtje të mirë të sektorit nga humbjet e mundshme. Sektori bankar vazhdoi të shënoj rënie të koncentrimin të rrezikut kreditor gjatë vitit 2015. Pozita e likuiditetit të sistemit bankar mbetet në nivel të kënaqshëm si rezultat i rritjes së përshpejtuar të depozitave. Rritja e përshpejtuar e depozitave ka ndikuar në rritjen e lehtë të treguesit të aseteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtëra, që vazhdon të mbetet dukshëm mbi nivelin minimal prej 25 përqind të përcaktuar me kërkesat rregullore. Sektori bankar i Kosovës vazhdon të ketë ekspozim të ulët ndaj rrezikut të tregut, marrë parasysh faktin se pothuajse të gjitha kreditë dhe depozitat vazhdojnë të bartin norma fikse të interesit si dhe për faktin se bilanci i gjendjes së sektorit bankar pothuajse në tërësi është i denominuar në valutë euro dhe rrjedhimisht ka ekspozim të ulët ndaj rrezikut të kursit të këmbimit.


6.4.1 Rreziku i likuiditetit

Në vitin 2015, raporti i kredive ndaj depozitave shënoi rritje të lehtë në 74.7 përqind nga 74.2 përqind në vitin 2014 si rezultat i rritjes më të shpejtë të kredive kundrejt depozitave (figura 83). Ky nivel i raportit të kredive ndaj depozitave sugjeron që sektori bankar ka ende potencial që të rris kreditimin, si rezultat i likuiditetit të mjaftueshëm.

Depozitat që përbëjnë burimin kryesor të financimit të aktivitetit bankar kanë shënuar rritje të përshpejtuar krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, duke përforcuar kështu pozicionin e likuiditetit të sektorit bankar. Megjithatë, depozitat kanë treguar orientim drejt maturimit më të shkurtër (1-7 ditë), duke reflektuar pjesërisht ndjeshmërinë e rritjes së depozitave ndaj normës së interesit.

Në vitin 2015, asetet likuide afatshkurtra shënuan rritje vjetore prej 9.1 përqind, krahasuar me rënie vjetore prej 2.9 përqind në vitin 2014. Në anën tjetër, detyrimet afatshkurtra shënuan rritje më të ngadalësuar vjetore (në 5.9 përqind nga 6.8 përqind në vitin 2014). Rrjedhimisht, raporti i aseteve likuide gjithëpërfshirëse ndaj detyrimeve afatshkurtra u rrit në 44.9 përqind në vitin 2015 krahasuar me 43.6 përqind në vitin 2014, dhe vazhdon të mbetet dukshëm mbi nivelin minimal prej 25 përqind të kërkuar nga Banka Qendrore (figura 84).

Figura 83. Kreditë dhe depozitat e sektorit bankar, në milionë euro




Në kuadër të aseteve likuide, rritjen më të madhe e shënuan letrat me vlerë të tregtueshme të emetuara nga qeveritë e huaja, obligacionet e emetuara të thesarit të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe paraja e gatshme e mbajtur nga bankat. Ndërsa, rënien më të madhe e shënuan depozitat me bankat dhe institucionet tjera financiare me maturim të mbetur ‘deri në 30 ditë’. Në kuadër të detyrimeve afatshkurtëra, rritjen më të madhe e shënuan depozitat pa interes (të transferueshme) pasuar nga detyrimet ndaj bankave amë. Ndërsa, rënien më të madhe e shënuan depozitat me interes dhe huamarrjet afatshkurtëra.

Rezervat e detyrueshme të sektorit bankar qëndruan në nivel më të lartë se sa kërkesat rregullatore. Në vitin 2015, niveli i kërkuar i rezervës së detyrueshme kishte vlerën 235.6 milionë euro, ndërsa vlera e gjithsej rezervave të mbajtura nga bankat tejkaloi rezervën e detyrueshme për 68.7 përqind (figura 85). Mbajtja e rezervave në nivel të lartë mund të konsiderohet si pozitive për qëndrueshmërinë e sektorit ngase zvogëlon ekspozimin e sektorit ndaj zhvillimeve me rrezik potencial për gjendjen e likuiditetit. Megjithatë, kjo paraqet kosto oportune për bankat të cilat nuk arkëtojnë interes për tepricën e rezervës, gjë e cila mund të transmetohet në rritje të kostos së shërbimeve bankare.


Sektori bankar i Kosovës në vitin 2015 është karakterizuar me rritje të ‘rrezikut strukturor të likuiditetit’, që pasqyrohet përmes rritjes së mospërputhjes së afatit të maturimit të aseteve dhe detyrimeve të intervalit të njëjtë të maturimit (figura 86).¹⁸ Hendeku i likuiditetit është rritur për pothuajse të gjitha kategoritë. Rritja më e theksuar është shënuar në kategorinë ‘1-7 ditë’, ku hendeku ka arritur vlerën në -1,163.7 milionë euro nga -878.1 në vitin 2014. Kjo ndikoi që hendeku negativ për periudhën kumulative ‘deri në 3 muaj’ të rritet në -953.0 milionë euro nga -669.3 milionë euro në vitin 2014. Rritja e konsiderueshme e hendekut negativ për periudhën ‘1-7 ditë’ gjithashtu ndikoi që hendeku negativ për periudhën kumulative ‘deri në 1 vit’ të rritet në -541.7 milionë euro nga -407.1 milionë euro në dhjetor 2014. Rritja e theksuar e

Figura 84. Raporti asete likuide 'gjithëpërfshirëse'/ detyrime afatshkurtëra




Burimi: BQK (2016)

Figura 85. Rezervat e sektorit bankar, në milionë euro



Burimi: BQK (2016)

Figura 86. Hendeku i likuiditetit, në milionë euro



Burimi: BQK (2016)

¹⁸ Hendeku negativ nënkupton që detyrimet për intervalin e caktuar të maturimit tejkalojnë asetet dhe anasjelltas.

hendekut pozitiv për periudhën '181-365' dhe deri në një masë për periudhën '91-180 ditë' ndikoi që hendeku negativ kumulativ për periudhën 'deri në 1 vit' të mos ishte më i theksuar.


Në vitin 2015, asetet e pothuajse të gjitha kategorive sipas maturimit kanë shënuar rritje përveç aseteve me maturim '8-30 ditë' dhe '31-90 ditë' që shënuan rënie prej 44.8 milionë euro përkatësisht 33.0 milionë euro. Në kuadër të kategorisë '8-30 ditë', rënia më e lartë u shënuar në letrat me vlerë dhe kreditë. Ndërsa, në kategorinë '31-90 ditë', përveç kredive, rënie shënuar edhe plasmanet në bankat tjera. Kategoria e aseteve me maturim prej 'më shumë se 1 vit' shënoi rritjen më të lartë prej 230.5 milionë euro që është rezultat i rritjes së kredive me maturim 'mbi 1 deri në 5 vite' dhe 'mbi 5 vite'. Po ashtu, kontribut të lartë në rritjen e aseteve me maturim 'më shumë se 1 vit' kishte edhe zhvendosja e investimeve në letra me vlerë drejt maturimeve më të gjata. Në anën e detyrimeve, rritja më e lartë vjetore u shënuar për kategorinë me afat maturimi prej '1-7 ditë', të cilat rritën vlerën për 311.3 milionë euro, kryesisht si rezultat i rritjes së depozitave të transferueshme. Ndërsa, detyrimet me afat maturimi 'më shumë se 1 vit' shënuar rritje prej 95.9 milionë euro, që rezultoi kryesisht nga rritja e ekuitetit, depozitave me interes dhe borxheve afatgjata.

Rritja e kreditimit është reflektuar në zvogëlimin e aseteve me maturim të shkurtër si dhe rritjen e atyre me maturim më të gjatë se një vit. Në anën e detyrimeve, rritja e depozitave të transferueshme ndikoi në rritjen detyrimeve për kategorinë e maturimit '1-7 ditë'. Rritja e depozitave të transferueshme u ndikua nga rënia e të gjitha kategorive të depozitave me interes (përfshirë kategorinë 'mbi 1 deri në 5 vite'). Rënia e depozitave me interes përkon me rënien e normave të interesit në depozita gjatë dy viteve paraprake, të cilat janë reflektuar edhe në vitin 2015, pavarësisht rritjes së lehtë të normave të interesit në depozita gjatë këtij viti.

Zhvillimet në kuadër të depozitave (pjesëmarrje prej 79.9 përqind të gjithëj detyrimeve), të cilat kanë shfaqur tendencë të zhvendosjes drejt afateve më të shkurtëra të maturimit mund të paraqesin probleme në menaxhimin e likuiditetit. Andaj, sektori bankar ka nevojë të rritjes së depozitave me afat më të gjatë maturimi, ngase një zhvillim i tillë do të zvogëlonte rrezikun e likuiditetit dhe njëkohësisht do të krijonte mundësi më të mëdha për rritjen e kreditimit afatgjatë, zhvillim ky mjaft i nevojshëm për përmirësimin e kushteve të financimit të investimeve.

6.4.2. Rreziku kreditor

Një ndër rreziqet kryesore ndaj të cilit ekspozohet sektori bankar në Kosovë është rreziku kreditor. Megjithatë, ekspozimi ndaj këtij rreziku shënoi rënie gjatë vitit 2015 duke marrë parasysh që portfolio kreditore shënoi përmirësim të cilësisë për të dytin vit me radhë. Raporti i Kredive Joperformuese (KJP) ndaj gjithëj kredive në vitin 2015 zbriti në 6.2 përqind nga 8.3 përqind sa ishte në vitin 2014 (figura 87). Rënia e normës së KJP-ve është rezultat i rënies së vlerës së kredive joperformuese dhe, në të njëjtën kohë, rritja e stokut të gjithëj kredive gjatë vitit 2015 (figura 89). Vlera e kredive joperformuese në vitin 2015 shënoi rënie prej 20.5 përqind që paraqet përmirësim të theksuar krahasuar me rënien vjetore prej 0.2 përqind në vitin 2014 si dhe me




Burimi: BQK (2016)

rritjen vjetore prej 18.6 përqind në vitin 2013. Ndërsa, stoku i gjithsej kredive shënoi rritje më të lartë vjetore prej 7.3 përqind në vitin 2015 krahasuar me rritjen prej 4.2 përqind në vitin 2014. Në përmirësimin e cilësisë së portfolios kreditor mund të ketë kontribuar licencimi i përmbaruesve privat duke marrë parasysh ndikimin e tyre në lehtësimin e zbatimit të kontratave kreditorë. Trendi i rënies së normës së KJP-ve filloi në muajin nëntor të vitit 2014 dhe vazhdoi përgjatë tërë vitit 2015, kur rënia më e theksuar ishte gjatë tremujorit të fundit të vitit 2015. Vlen të theksohet që raporti i kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive në vitin 2015 paraqet raportin më të ulët të sektorit bankar që nga muaji prill i vitit 2012.

Sektori bankar në Kosovë ka nivelin më të ulët të kredive joperformuese krahasuar me mesataren prej 15.9 përqind të vendeve të rajonit dhe është e vetmja që mban vlerë njëshifrore (figura 88).


Sektori bankar ka ekspozim më të lartë ndaj rrezikut kreditor të kredive ndaj ndërmarrjeve duke marrë parasysh që raporti i KJP-ve në këto kredi qëndron në 7.9 përqind krahasuar me raportin e KJP-ve prej 2.6 përqind në kredite ndaj ekonomive familjare. Në kuadër të kredive për ndërmarrje, kredite për energji dhe prodhimtari kanë normat më të larta të KJP-ve (figura 90). Në vitin 2015, portofoli i kredive për sektorin e energjisë shënoi rritje të normës së KJP-ve duke arritur në 19.6 përqind në vitin 2015 (17.4 përqind në vitin 2014). Ndërsa, portofoli i kredive për sektorin e prodhimtarisë u karakterizua me përmirësim të cilësisë, ku norma e KJP-ve zbriti në 11.4 përqind (12.0 përqind në vitin 2014). Sektori që shënoi rënie më të lartë të kredive joperformuese krahasuar me vitin paraprak ishte sektori i pasurive të patundshme për të cilën norma e KJP-ve zbriti në 6.6 përqind nga 13.7 përqind sa ishte në vitin 2014. Sektori i tregtisë, i cili dominon strukturën e kredive për ndërmarrje, është i dyti për nga përmirësimi i cilësisë duke marrë parasysh që raporti i kredive joperformuese në vitin 2015 zbriti në 8.2 përqind krahasuar me 11.5 përqind në vitin 2014. Përmirësim të cilësisë së portofolit kreditor shënuan edhe kredite për

Figura 88. Raporti KJP/gjithsej kredite në Kosovë dhe në disa vende të Ballkanit Perëndimor, 2015




Burimi: FMN, Bankat Qendrore të vendeve përkatëse (2016)

Figura 89. Gjithsej kredite dhe KJP-të, ndryshimi vjetor



Burimi: BQK (2016)

Figura 90. KJP-të sipas veprimtarive ekonomike



Burimi: BQK (2016)

sektorin e bujqësisë, komunikimit si dhe për sektorët e turizmit dhe shërbimeve hoteliere. Norma e KJP-ve për sektorin e bujqësisë zbriti në 6.3 përqind (7.9 përqind në vitin 2014), për sektorin e komunikimit në 1.3 përqind (3.3 përqind në vitin 2014) ndërsa për sektorin e turizmit dhe shërbimeve hoteliere norma e KJP-ve u zvogëlua në 6.9 përqind (8.7 përqind në vitin 2014).

Zvogëlimi i ekspozimit ndaj rrezikut kreditor krahasuar me periudhën paraprake është shfaqur edhe përmes migrimit të kredive nga kategoritë me cilësi më të dobët drejt kategorisë së kredive pa vonesa (figura 91). Kreditë 'standard' rritën pjesëmarrjen për 3.7 pikë përqindje, përderisa, kreditë 'vrojtuese' kishin të njëjtën pjesëmarrje si në vitin e kaluar. Në anën tjetër, kategoria e kredive 'nënstandarde' zvogëloi pjesëmarrjen për 1.6 pikë përqindje. Ngjashëm, edhe dy kategoritë përbërëse të kredive joperformuese zvogëluan pjesëmarrjen për 0.3 pikë përqindje (kategoria 'të dyshimta') përkatësisht 1.9 pikë përqindje (kategoria 'të humbura').

Zvogëlimi i ekspozimit ndaj rrezikut kreditor mund të vërehet edhe në figurën 92¹⁹ që reflekton ndryshimet në tri kategoritë kryesore të kredive me probleme. Krahasuar me periudhën paraprake, raporti i kredive me vonesa ndaj gjithsej kredive u zvogëlua në 10.1 përqind (13.8 përqind në vitin 2014). Ndërsa, raporti i kredive të klasifikuara (që paraqet kreditë me vonesa mbi 61 ditë ndaj gjithsej kredive) në vitin 2015 u zvogëlua në 7.9 përqind nga 11.6 përqind në vitin paraprak.

Krahas përmirësimit të përgjithshëm të cilësisë së portofolit kreditor, përmirësim ka shënuar edhe niveli i mbulimit të kredive joperformuese nga provizionet për mbulimin e humbjeve të mundshme nga kreditë. Raporti i mbulimit të kredive joperformuese me provizione në vitin 2015 është rritur në 115.1 përqind nga 114.4 përqind në vitin 2014 (figura 93). Gjithashtu, rënia më e theksuar e kredive të kategorive

Figura 91. Struktura e kredive sipas klasifikimit




Figura 92. Ecuria e kredive sipas klasifikimeve kreditore, në përqindje





Figura 93. KJP-të dhe provizionet



¹⁹ Sipas rregullores së BQK-së për menaxhimin e rrezikut kreditor, klasifikimet kreditore të mësipërme grupohen në tri kategoritë të ekspozimit të rrezikut kreditor: Kreditë me vonesa, të cilat përfshijnë kategoritë vrojtuese, nën-standarde, të dyshimta dhe të humbura; Kreditë e klasifikuara që përfshijnë kategoritë nën standarde, të dyshimta dhe të humbura, dhe Kreditë jo-performuese që përfshijnë kreditë e dyshimta dhe të humbura.

‘nën standard’ ka ndikuar që raporti i mbulimit me provizione të kredive të klasifikuara (kreditë ‘nën standarde’, ‘me vonesa’ dhe ‘të humbura’) të rritet në 89.7 përqind në vitin 2015 nga 82.0 përqind sa ishte në vitin 2014.


Rritja e kreditimit mund të ketë ndikim pozitiv në rritjen e aktivitetit të ndërmarrjeve dhe të reflektohet në përmirësimin e kapacitetit të tyre për kthim të kredive ekzistuese dhe atyre të reja. Megjithatë, duhet pasur parasysh se lehtësimi i standardeve kredituese nga bankat, kryesisht gjatë gjysmës së parë të vitit si dhe ofrimi i kushteve më të favorshme të kreditimit, si normat më të ulëta të interesit, mund të tërheqin aplikacione për kredi edhe nga klientët me ‘gradim’ më të ulët kreditor. Prandaj, kërkohet që rritja e mëtejme e kreditimit të bëhet në përputhje me parimet e kreditimit të shëndoshë, me qëllimi të evitimit të përkeqësimit të mundshëm të cilësisë së kredive gjatë periudhave të ardhëshme.

Koncentrimi i rrezikut kreditor

Diversifikimi i ekspozimeve kreditore është një aspekt mjaft i rëndësishëm i rrezikut kreditor. Kjo duke marrë parasysh se në rast të përqendrimit të lartë të rrezikut kreditor ndaj huamarrësve individual apo një grupi të ndërlidhur huamarrësish, dështimi i papritur i këtyre palëve mund të rrezikojë qëndrueshmërinë e bankës. Shkalla e koncentrimit kreditor në sektorin bankar të Kosovës, që matet si raport i vlerës së gjithsej ekspozimeve të mëdha ndaj kapitalit të klasit të parë, në vitin 2015 ka shënuar rënie. Koncentrimi i rrezikut kreditor, në vitin 2015, u zvogëluar në 65.7 përqind nga 97.1 përqind në vitin paraprak (figura 94). Rënia e shkallës së koncentrimit i atribuohet rritjes prej 23.3 përqind të kapitalit të klasit të parë dhe, në anën tjetër, rënies prej 16.6 përqind të vlerës së ekspozimeve të mëdha. Në vitin 2015, vlera e ekspozimeve të mëdha zbriti në 244.0 milionë euro krahasuar me 292.5 milionë euro sa ishte në vitin 2014.


Përveç vlerës së përgjithshme të ekspozimeve të mëdha, rënie kishte edhe në numrin e ekspozimeve të mëdha kreditore. Në vitin 2015, numri i ekspozimeve të mëdha (çdo ekspozim që tejkalon 10 përqind të kapitalit të klasit të parë), u zvogëluar në 36 nga 55 sa ishte në vitin 2014.

Figura 94. Koncentrimi i rrezikut kreditor



Burimi: BQK (2016)

Figura 95. Kapitalizimi i sektorit bankar




Burimi: BQK (2016)

Mirëpo, si rezultat i zvogëlimit më të shpejtë të numrit të ekspozimeve të mëdha në krahasim me zvogëlimin e gjithsej vlerës së ekspozimeve të mëdha, vlera mesatare e ekspozimeve të mëdha në vitin 2015 u rrit në 6.8 milion euro (5.3 milion në vitin 2014), duke ndjekur kështu trend rritës për të tretin vit me radhë. Kjo tendencë vërehet edhe nga raporti i tri ekspozimeve më të mëdha ndaj gjithsej ekspozimeve kreditore, i cili në vitin 2015 qëndroi në 60.2 përqind (55.9 përqind në vitin 2014). Rritja e këtij raporti ishte kryesisht si rezultat i rënies më të lartë vjetore prej 16.6 përqind të vlerës së gjithsej ekspozimeve të mëdha, përderisa vlera e tri ekspozimeve më të mëdha shënoi rënie vjetore prej 10.1 përqind. Rrjedhimisht, pavarësisht rënies së vlerës së gjithsej ekspozimeve të mëdha, bankat duhet të vazhdojnë të jenë të kujdesshme sa i përket shkallës së koncentrimin të ekspozimeve kreditore.

6.4.3. Rreziku i solvencës


Sektori bankar i Kosovës vazhdon të përforcojë edhe më tutje nivelin e kapitalizimit. Në vitin 2015, Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit (TMK), që paraqet raportin ndërmjet gjithsej kapitalit rregullator dhe asetëve të peshuara ndaj rrezikut, arriti në 19.0 përqind krahasuar me 17.8 përqind sa ishte një vit më parë (figura 95).²⁰ Rritja ishte rezultat i normës më të lartë të rritjes vjetore të kapitalit rregullator prej 15.6 përqind, në krahasim me rritjen vjetore prej 8.2 përqind të Aseteve të Peshuara ndaj Rrezikut (APR) (figura 96). Gjithashtu, norma e kapitalit të klasit të parë ndaj asetëve të peshuara ndaj rrezikut arriti në 16.7 përqind nga 14.6 përqind sa ishte në vitin 2014. Niveli i kapitalizimit të sektorit bankar në Kosovë është i lartë dhe mbetet mbi nivelin mesatar prej 16.8 përqind të vendeve të rajonit (figura 97).

Figura 96. Kapitali rregullator dhe APR




Burimi: BQK (2016)

Figura 97. TMK në sektorin bankar në Kosovë dhe disa vende të Ballkanit Perëndimor, 2015



Burimi: FMN, Bankat Qendrore të vendeve përkatëse (2016)

Figura 98. Leva financiare në sektorin bankar në Kosovë dhe disa vende të Ballkanit Perëndimor, 2015




Burimi: FMN, Bankat Qendrore të vendeve përkatëse (2016)

²⁰ Sipas rregullores së BQK-së për Adekuatshmërinë e Kapitalit, bankat janë të obliguara të kenë një normë prej së paku 12 përqind të gjithsej kapitalit rregullator në raport me APR dhe normë prej së paku 8 përqind të kapitalit të klasit të parë në raport me APR.

Indikator tjetër për vlerësimin e nivelit të kapitalizimit është raporti i levës, i cili në vitin 2015 arriti në 12.2 përqind, që tejkalon kërkesën rregullore për shkallë minimale prej 7 përqind.²¹

Raporti i levës shënoi rritje nga 10.8 përqind sa ishte në vitin paraprak kryesisht si rezultat i rritjes më të lartë të gjithsej ekuitetit (rritje vjetore prej 21.6 përqind në vitin 2015), e mbështetur nga rritja e konsideruar e profitit të realizuar nga sektori bankar, në krahasim me rritjen e gjithsej asetëve (rritje vjetore prej 7.9 përqind). Sidoqoftë, niveli aktual është nën nivelin mesatar të vendeve të rajonit, që në vitin 2015, në mesatare, kishin raport të levës prej afër 13.7 përqind (figura 98).²²

Figura 99. Struktura e kapitalit rregullator, në përqindje




Burimi: BQK (2016)

Kapitali rregullator

Kapitali rregullator i sektorit bankar, në vitin 2015, arriti vlerën 423.9 milionë euro, duke tejkaluar kërkesën minimale për kapital rregullator për 156.5 milionë euro. Cilësia e kapitalit, e shprehur nga pjesëmarrja e kapitalit të klasit të parë në gjithsej kapitalin, ka shënuar rritje për të dytin vit me rradhë pas rënies së shënuar në vitin 2013 që ishte rezultat i rritjes së financimit të kapitalit rregullator nga burime të kapitalit të klasit të dytë. Vlera e kapitalit të klasit të parë arriti në 371.7 milionë euro në vitin 2015, që paraqet një rritje vjetore prej 23.5 përqind. Rrjedhimisht, pjesëmarrja e kapitalit të klasit të parë në gjithsej kapitalin rregullator arriti në 87.7 përqind në vitin 2015 nga 82.1 përqind sa ishte në vitin 2014 (figura 99). Rritja e kapitalit të klasit të parë gjatë vitit 2015 kryesisht është mundur nga rritja e konsiderueshme e profitit të sektorit bankar gjatë kësaj periudhe.

Struktura e kapitalit të klasit të parë mbetet e ngjashme me periudhat paraprake. Kapitali aksionar vazhdon të jetë kategoria dominuese e kapitalit të klasit të parë, me gjithë rënien e lehtë të pjesëmarrjes që shënoi gjatë kësaj periudhe (73.7 përqind në 2015 krahasuar me 76.8 përqind sa ishte në vitin 2014) si pasojë e rritjes së pjesëmarrjes së kategorisë së dytë që përbëhet nga profiti i mbajtur i vitit paraprak dhe profiti i vitit aktual (figura 100).

Figura 100. Struktura e kapitalit të klasit të parë, në milionë euro



Burimi: BQK (2016)

²¹ Rregullorja e BQK-së për Adekuatshmërinë e Kapitalit të bankave, Neni 9.

²² Mesatarja e raportit të levës për rajonin (vendet e Ballkanit Perëndimor, si: Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia, Shqipëria dhe Serbia) të kalkuluara nga BQK nga raportet e bilanceve të gjendjes të vendeve përkatëse, të raportuara në Bankat Qendrore përkatëse.

Kapitali i klasit të dytë, shënoi rënie vjetore prej 20.4 përqind, duke shënuar vlerën prej 52.2 milionë euro në vitin 2015. Kjo rënie ishte kryesisht si rezultat i zvogëlimit të borxhit të ndërvarur për 27.4 përqind, gjë që tregon tendencën e bankave që të shfrytëzojnë më pak instrumente që bartin kosto më të lartë, për plotësimin e kërkesave rregullatore për kapital. Performanca e mirë financiare në vitet e fundit mund të ketë zvogëluar nevojën e bankave për shtimin e nivelit të kapitalit përmes borxhit të ndërvarur. Në vitin 2015, vlera e borxhit të ndërvarur ishte 33.2 milionë euro dhe përbënte 63.6 përqind të kapitalit të klasit të dytë (figura 101). Pjesa e mbetur prej 36.4 përqind e kapitalit të klasit të dytë përbëhej nga provizionet e përgjithshme për kreditë.²³ Për dallim nga vitet e mëhershme kur, megjithëse në përqindje shumë të vogël, bankat shfrytëzonin instrumentet e borxhit detyrimisht të konvertueshëm në aksione për plotësim të kapitalit, në katër vitet e fundit këto instrumente nuk kanë gjetur aplikim.

Asetet e peshuara ndaj rrezikut

Vlera e aseteve të peshuara ndaj rrezikut (APR, angl. Risk-Weighted Assets) shënoi rritje prej 8.2 përqind në vitin 2015 krahasuar me 7.3 përqind sa ishte një vit më parë. Ky rezultat ndikoj që pjesëmarrja e aseteve që bartin rrezik në gjithsej asetet e sektorit bankar të arrij në 61.5 përqind në vitin 2015, nga 60.8 përqind sa ishte në vitin 2014 (figura 103). Rritja e APR-ve ishte kryesisht rezultat i rritjes së aseteve me peshë rreziku 100 përqind, të cilat përfshijnë kreditë dhe zërat jashtëbilancor dhe përbëjnë kategorinë kryesore të aseteve me peshë rreziku. Vlera e aseteve me peshë rreziku 100 përqind në vitin 2015 arriti në 1.8 miliardë euro (1.6 miliardë euro në vitin 2014) duke rritur pjesëmarrjen e tyre në 80.5 përqind të gjithsej APR-ve (78.1 përqind në vitin 2014) (figura 102). Rritja u ndikua nga përshpejtimi i rritjes së aktivitetit kreditues, kategori që pjesën më të madhe të aseteve i ka në kuadër të peshës së rrezikut prej 100 përqind.

Figura 101. Struktura e kapitalit të klasit të dytë, në milionë euro




Figura 102. Struktura e APR sipas peshës së rrezikut





Figura 103. Raporti i APR-ve ndaj gjithsej aseteve të sektorit



²³ Vlera e provizioneve të ndara nga bankat për kreditë me klasifikim standard dhe vrojtuese llogaritet si pjesë e kapitalit të klasit të dytë, limituar deri në 1.25 përqind të aseteve të peshuara ndaj rrezikut.

Kategoria e kredive të mbuluara me kolateral të rendit të parë²⁴, që paraqesin asete me peshe rreziku prej 75 përqind dhe përfaqësojnë kategorinë e dytë për nga pjesëmarrja në asetet e peshuara ndaj rrezikut, zbriti në 174.8 milionë euro nga 187.1 milionë euro dhe rrjedhimisht pjesëmarrja e saj në gjithsej APR-të zbriti në 7.8 përqind nga 9.1 përqind sa ishte në vitin paraprak. Në anën tjetër, asetet me peshë të rrezikut prej 50 përqind, të cilat përbëhen nga kërkesat me maturim prej '1 viti apo më pak' apo kërkesat e pakushtëzuara të garantuara nga bankat si subjekt i aprovimit paraprak nga BQK-ja, kanë shënuar rënie të konsiderueshme duke zbritur në 5.1 milionë euro nga 24.9 milionë në vitin 2014, ndërsa pjesëmarrja e tyre në gjithsej APR-të zbriti në 0.2 përqind nga 1.2 përqind sa ishte në vitin paraprak. Rënia e të dy kategorive të fundit ka ndikuar që të zvogëlohet efekti i rritjes së gjithsej APR-ve nga rritja e theksuar e aseteve me peshë rreziku prej 100 përqind.

Kategoria e aseteve me peshën më të lartë të rrezikut (150 përqind), e cila përfshinë kërkesat direkte me maturim prej '1 viti apo më pak' dhe të cilat kërkojnë aprovim paraprak nga BQK-ja, por që kanë klasifikim kreditor me rrezik të lartë të mospagesës (nën B- sipas vlerësimeve të Fitch), në vitin 2015 shënoi rënie në 0.6 milionë euro nga 1.1 milionë euro në vitin paraprak. Megjithatë, pjesëmarrje e kësaj kategorie në gjithsej APR-të mbetet në nivel të ulët (0.03 përqind në vitin 2015). Kategoria tjetër e APR-ve, që përbëhet nga asetet me peshë rreziku 20 përqind, në vitin 2015, zvogëloi pjesëmarrjen në 2.0 përqind të gjithsej APR-ve, nga 2.5 përqind në vitin 2014. Ndërsa, nga gjithsej asetet e sektorit²⁵, vlera e aseteve të cilat nuk bartin rrezik, apo që peshohen me rrezik 0 përqind, shënoi rritje në 37.7 përqind të vlerës së gjithsej aseteve nga 36.2 përqind në vitin 2014.

6.4.4 Rreziku i tregut

Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut të tregut, që nënkupton rrezikun nga lëvizjet e kursit të këmbimit valutor si dhe ndryshimet nga lëvizjet në normat e interesit, vazhdon të mbetet në nivel të ulët. Pozicioni i agreguar neto i hapur në valutë të huaj ndaj kapitalit të klasit të parë ka mbetur në nivel të pandryshuar nga viti i kaluar. Kreditë në valutë të huaj të cilat përbëjnë vetëm 0.3 përqind të gjithsej portofolit kreditor kanë shënuar rënie vjetore prej 1.1 përqind në vitin 2015, duke zbritur më tutje ekspozimin ndaj rrezikut të tregut.

Ekspozimi ndaj rrezikut të normave të interesit vazhdon të mbetet i ulët. Zërat kryesor të bilancit të gjendjes së sektorit bankar, gjegjësisht kreditë dhe depozitat, bartin kryesisht norma fikse të interesit dhe nuk ndikohen nga lëvizjet në norma të interesit në afat të shkurtër. Megjithatë, ekziston rreziku i normës së interesit në kuptimin e rifinancimit dhe riinvestimit të mjeteve, ku ndryshimet e mundshme në norma të interesit reflektohen më shpejtë në anën e detyrimeve të sektorit për shkak të maturimit më të shkurtër të detyrimeve që bartin interes në raport me asetet. Me qenë se hendeku i aseteve dhe detyrimeve me ndjeshmëri ndaj normave të interesit nuk ka pjesëmarrje shumë të lartë në gjithsej asetet, atëherë ndryshimet në norma të interesit mund të kenë ndikim të vogël në qëndrueshmërinë e sektorit.

Rreziku i këmbimit valutor

Pozicioni i hapur neto në valutë të huaj është rritur në vitin 2015 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Kjo si rezultat i rritjes së aseteve në valutë të huaj për 7.9 përqind në 132.9 milionë euro në vitin 2015 (vlerë ekuivalente). Një ecuri e ngjashme rezultoi edhe në anën e detyrimeve në valutë të huaj të cilat shënuan rritje vjetore prej 8.9 përqind në 138.2 milionë

²⁴ Specifikisht asetet e peshuara me 75 përqind shkallë rreziku përfshijnë kreditë apo pjesë të tyre të mbuluara me kolateral të rendit të parë në formë të hipotekave të banimit si dhe kreditë për ndërtuesit për të financuar ndërtimin e pasurive të patundshme ku prona e financiar ka qenë shitur apo e lëshuar me qira.

²⁵ Në këtë kalkulim janë përfshirë edhe asetet jashtë-bilancore për shkak të përfshirjes së tyre në llogaritjen e gjithsej APR-ve.

euro në vitin 2015 (vlerë ekuivalente), duke bërë që pozicioni i hapur neto të arrij në -5.3 milionë euro vlerë ekuivalente (-3.7 milionë euro vlerë ekuivalente në vitin 2014).

Në anën tjetër, pozicioni i agreguar neto i hapur për të gjitha valutat²⁶ shënoi rritje në 7.2 milionë euro vlerë ekuivalente në vitin 2015 nga 5.7 milionë euro vlerë në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Kjo rritje, së bashku me rritjen e nivelit të kapitalit të klasit të parë të sektorit bankar gjatë kësaj periudhe, bëri që raporti i pozicionit të agreguar neto të hapur në valutë të huaj ndaj kapitalit të klasit të parë të rritet lehtë në 1.93 përqind nga 1.89 përqind në periudhën paraprake, që tregon për ndjeshmëri mjaft të ulët të sektorit ndaj ndryshimeve në kurset e këmbimit (figura 104).

Shikuar sipas valutave të veçanta, pozicionin më të lartë neto të hapur ndaj kapitalit të klasit të parë e arriti funta britanike, për dallim nga periudha e njëjtë e vitit të kaluar kur pozicionin më të lartë e kishte dollari amerikan. Në vitin 2015, ky raport për funtën britanike arriti në -0.9 përqind (nga -0.04 përqind në vitin 2014), ndërsa për dollarin amerikan raporti zbriti në -0.2 përqind (nga -0.8 përqind në vitin 2014). Raporti i pozicioneve neto të hapura për valuta individuale ndaj kapitalit të klasit të parë vazhdon të mbetet mjaft nën maksimumin prej 15 përqind të lejuar nga BQK-ja. Bazuar në këto të dhëna, mund të sugjerohet që sektori bankar vazhdon të mbetet mjaft mirë i mbrojtur nga lëvizjet në kurset e këmbimit.

Kreditimi në valutë të huaj vazhdon të jetë në nivel mjaft të ulët. Në vitin 2015, vlera e gjithsej kredive në valutë jo-euro arriti në 5.9 milionë euro nga 6.0 milionë euro vlerë ekuivalente në vitin 2014, që paraqet një rënie vjetore prej 1.1 përqind. Raporti i kredive në valutë jo-euro ndaj gjithsej portofolit kreditor u zvogëlua në 0.29 përqind nga 0.32 përqind në vitin 2014. Kjo rënie ishte rezultat i përshpejtitimit të rritjes së kredive në valutë euro për dallim nga kreditë në valutë jo-euro që shënuan rënie.

Në anën tjetër, vlera e depozitave në valutë të huaj arriti në 124.5 milionë euro nga 113.1 milionë euro (vlerë ekuivalente) në vitin 2014. Kjo ndikoi në rritjen e lehtë të pjesëmarrjes së depozitave jo-euro ndaj gjithsej depozitave në 4.6 përqind nga 4.5 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Rënia e kredive në valutë jo-euro kundrejt rritjes së depozitave në valutë jo-euro ndikoi që raporti i kredive në valutë të huaj ndaj depozitave në valutë të huaj të zvogëlohet në 4.7 përqind nga 5.3 përqind në vitin 2014 (figura 105).

Figura 104. Pozicionet e hapura në valutë të huaj ndaj Kapitalit të Klasit të Parë





Figura 105. Kreditë dhe depozitat në valutë të huaj



²⁶ Pozicioni i agreguar neto i hapur nënkupton shumën e pozicioneve të gjata dhe të shkurta në të gjitha valutat. Për shembull, një pozicion neto i shkurtër (-) në dollar prej 1 milionë vlerë ekuivalente të euros dhe një pozicion neto i gjatë (+) në franga zvicerane prej një milionë vlerë ekuivalente të euros rezultojnë në neto pozicion të agreguar prej 2 milionë euro, përderisa pozicioni neto i hapur do të ishte 0.


Rreziku i normave të interesit

Sektori bankar i Kosovës vazhdon të jetë i mbrojtur relativisht mirë ndaj ndryshimeve në normat e interesit, duke marrë parasysh që kreditë dhe depozitat kanë kryesisht normë fikse të interesit dhe të hyrat dhe shpenzimet e interesit nga këta zëra nuk ndikohen nga lëvizjet në norma të interesit deri në maturim. Në vitin 2015, rreth 91.5 përqind e gjithsej kredive kishin normë fikse të interesit, ndërsa të gjitha depozitat vazhdojnë të bartin normë fikse të interesit (figura 106).

Megjithatë, lëvizjet në normat e interesit mund të kenë ndikim në qëndrueshmërinë e sektorit bankar kur merret parasysh rreziku i refinancimit dhe i riinvestimit të aseteve, varësisht nga kompozicioni i afatit të maturimit të aseteve dhe detyrimeve që bartin interes (figura 107), si dhe kahut të lëvizjes së normës së interesit. Dallimi në mes të aseteve dhe detyrimeve që bartin interes është pothuajse më i larti për kategorinë e maturimit ‘deri në 30 ditë’, ku detyrimet që bartin interes tejkalojnë asetet për 378 milionë euro. Në vitin 2015, ky hendek ka shënuar rënie në -378.2 milionë euro nga -416.7 milionë euro në vitin 2014. Marrë parasysh që hendeku është negativ për këtë afat maturimi (detyrimet që bartin interes janë më të mëdha se sa asetet që bartin interes), ndryshimet e mundshme në norma të interesit në afat të shkurtër reflektohen më shumë në shpenzime se sa në të hyrat e sektorit. Rrjedhimisht, sektori bankar është i ekspozuar ndaj rritjes së mundshme të normave të interesit në afat të shkurtër pasi që kostoja e refinancimit të depozitave do të rritej më shpejtë se që mund të rriten të hyrat nga interesi marrë parasysh maturimin më të gjatë të aseteve.


Sidoqoftë, hendeku kumulativ është rritur dhe ka mbetur pozitiv kryesisht për shkak të rënies së detyrimeve që bartin interes. Në vitin 2015, hendeku i aseteve dhe detyrimeve që bartin interes për periudhën e maturimit ‘deri në 1 vit’ arriti në 337.5 milionë euro për dallim nga hendeku prej 151.2 milionë euro në vitin 2014. Në këtë situatë të hendekut pozitiv, ndryshimi i normave të interesit në periudhën një vjeçare ndikon më shumë në të hyrat se në shpenzimet e sektorit, andaj ekspozimi i përgjithshëm i sektorit ndaj rritjes së normave të interesit pothuajse neutralizohet.

Figura 106. Kreditë dhe depozitat e ndjeshme ndaj normave të interesit



Burimi: BQK (2016)

Figura 107. Hendeku i aseteve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normave të interesit, në milionë euro



Burimi: BQK (2016)

Kutia 2. Indeksi i stabilitetit të sektorit bankar²⁷


Vlerësimi i qëndrueshmërisë së sektorit bankar paraqet një proces kompleks, duke pasur parasysh llojet e ndryshme të rreziqeve ndaj të cilave ekspozohet veprimtaria bankare. Prandaj, parashtrohet nevoja që të kemi një matës më të agreguar që mund të shërbejë si një tregues më i përafërt i ecuresisë së shkallës së përgjithshme të qëndrueshmërisë së sektorit bankar. Në tabelën 7 janë paraqitur pesë kritere përmes të cilave bëhet një vlerësim më i përgjithshëm i shëndetit të sektorit bankar, gjegjësisht ndërtohet krijimi i një indeksi të përgjithshëm të stabilitetit. Kriteret e përdorura për përpilimin e këtij indeksi përfshijnë rrezikun e solvencës, rrezikun kreditor, profitabilitetin dhe efikasitetin, rrezikun e likuiditetit dhe rrezikun e tregut.²⁸

Tabela 7. Indeksi i përgjithshëm i stabilitetit të sektorit bankar

Kriteri	Indikatorët	Pesha	Ndikimi i indikatorëve në stabilitetin e sektorit bankar	Transformimi i indikatorëve
Solvenca	Kapitali rregullator ndaj asetëve të peshuara me rrezik (TMK) Kapitali i klasit të parë ndaj asetëve të peshuara me rrezik	25%	Pozitiv Pozitiv	Pa transformim
Rreziku kreditor	Kreditë jo performuese ndaj gjithsej kredive bruto Rritja vjetore e gjithsej kredive jo performuese Ekspozimet kreditore ndaj kapitalit të klasit të parë	25%	Negativ Negativ Negativ	1/X Ndryshim të shenjë 1/X
Profitabiliteti dhe efikasiteti	Kthimi mesatar në kapital (KMK) Gjithsej shpenzimet ndaj gjithsej të hyrave	20%	Pozitiv Negativ	Pa transformim 1/X
Rreziku i likuiditetit	Asetet likuide ndaj gjithsej asetëve Asetet likuide ndaj gjithsej detyrimeve afatshkurtra	25%	Pozitiv Pozitiv	Pa transformim Pa transformim
Rreziku i tregut	Pozicioni neto i hapur në valutë të huaj ndaj kapitalit të klasit të parë	5%	Negativ	1/X

Burimi: BQK (2016)

Kritereve përbërëse i'u janë dhënë pesha të caktuara bazuar në nivelin e ndikimit të tyre në stabilitetin e sektorit bankar. Disa prej indikatorëve të paraqitur në tabelë janë transformuar për kalkulimin e indeksit. Me që rritja e nivelit të kredive joperformuese (KJP-ve) ndaj gjithsej kredive, rritja e ekspozimeve kreditore, rritja e shpenzimeve operative ndaj gjithsej të hyrave bruto, si dhe rritja e pozicionit neto të hapur në valutë të huaj ndaj kapitalit të klasit të parë ndikojnë negativisht në stabilitetin e sektorit bankar, atëherë vlerat reciproke të këtyre indikatorëve janë përdorur me qëllim të barazpeshimit dhe krahasueshmërisë së indikatorëve në kalkulimin e indeksit përfundimtar. Ndërsa, tek indikator i rritjes vjetore të vlerës së KJP-ve, normës së rritjes vjetore i është ndryshuar kahja (shumëzuar me -1). Ky ndryshim është bërë për të pasqyruar ndikimin e KJP-ve në indeksin e stabilitetit. Rënia e këtij indikator ka ndikim pozitiv në shëndetin e sektorit bankar, prandaj norma rënëse është shumëzuar me -1 dhe anasjelltas. Pastaj, të dhënat janë normalizuar²⁹ dhe limituar në vlerat nga 0 në 1 për secilin indikator. Normalizimi i të dhënave ka eliminuar luhatjet brenda indikatorit dhe kritereve përbërëse të indeksit. Indeksi i përgjithshëm është kalkuluar ashtu që çdo indikator në kuadër të kritereve përkatëse është normalizuar dhe pastaj vlerat e normalizuara janë peshuar dhe agreguar në indeksin përfundimtar.

Figura 108. Indeksi i përgjithshëm i stabilitetit të sektorit bankar

Burimi: BQK (2016)

²⁷ Banking Stability Index: A Cross-Country Study, Kristina Kocisova, Technical University of Kosice, Slovakia.

²⁸ Pozicioni i agreguar neto i hapur nënkupton shumën e pozicioneve të gjata dhe të shkurtra në të gjitha valutat. Për shembull, një pozicion neto i shkurtër (-) në dollar prej 1 milionë vlerë ekuivalente të euros dhe një pozicion neto i gjatë (+) në franga zvicerane prej një milionë vlerë ekuivalente të euros rezultojnë në neto pozicion të agreguar prej 2 milionë euro, përderisa pozicioni neto i hapur do të ishte 0.

²⁹ Formula e përdorur në normalizimin e të dhënave: $X_{i,0} \text{ në } 1 = (X_i - X_{\text{MIN}}) / (X_{\text{MAX}} - X_{\text{MIN}})$.

Indeksi i përgjithshëm i stabilitetit të sektorit bankar, që përfshinë periudhën 2008-2015 në baza tremujore, është prezantuar në figurën 108. Lëvizjet drejt vlerës 1 (maksimumi) paraqesin rrezik më të ulët, përdërisa lëvizjet drejt vlerës (0) paraqesin rrezik më të lartë. Indeksi arriti pikën më të lartë në TM4 2015, që tregon periudhën në të cilën sektori bankar kishte nivelin më të ulët të rrezikut. Kjo erdhi si rezultat i nivelit të lartë të Treguesit të Mjaftueshmërisë së Kapitalit prej 19.0 përqind³⁰, nivelit të ulët të KJP-ve (6.2 përqind), si dhe nivelit të kënaqshëm të likuiditetit³¹ (44.9 përqind). Po ashtu, në vitin 2015, sektori bankar arriti vlerë rekorde të profitit, gjë e cila ndikoi në përmirësimin e kthimit mesatar në kapital (KMK) që u përmirësua në 29.0 përqind (22.6 në vitin 2014).


Në anën tjetër, indeksi kishte pikën më të ulët në TM4 2012, periudhë në të cilën TMK-ja ishte në nivelin më të ulët prej 14.2 përqind për periudhën 2008-2015, pavarësisht që përmbushte nivelin minimal të kërkuar nga BQK-ja prej 12.0 përqind. Po ashtu, në këtë periudhë, KJP-të kishin arritur në 7.5 përqind, që paraqet nivelin më të lartë në kuadër të periudhës vrojtuese. Megjithatë, sektori bankar vazhdoi të kishte nivel të kënaqshëm të likuiditetit dhe kthim pozitiv në kapital, faktorë këta që deri në një masë mënjanuan efektet më të pafavorshme në kuadër të nivelit të kapitalizimit dhe rrezikut kreditor. Niveli i ulët i indeksit të stabilitetit financiar në vitin 2012, deri në një masë, mund

të ketë reflektuar edhe zhvillimet më pak të favorshme makroekonomike gjatë kësaj periudhe, të cilat u karakterizuar me ngadalësim të rritjes ekonomike. Norma reale e rritjes ekonomike në vitin 2012 ishte 2.8 përqind, krahasuar me rritjen vjetore prej 4.4 në vitin 2011. Ndikim të rëndësishëm në ngadalësimin e rritjes ekonomike kishte rënia e investimeve të huaja direkte, ngadalësimi i rritjes së eksporteve, shtrëngimi i kreditimit bankar. Sidoqoftë, kontribut të rëndësishëm në rënien e vlerës së indeksit në vitin 2012 mund të ketë pasur edhe ndryshimi i kërkesave rregullatore për kapitalin e bankave, gjë e cila çoi në zvogëlimin e treguesit të mjaftueshmërisë së sektorit bankar në këtë periudhë.

Që nga TM2 2013 (përfshijtur TM4 2014), indeksi i stabilitetit të sektorit bankar shënoi rritje të vazhdueshme si rezultat i rritjes së nivelit të kapitalizimit, rënies së normës së kredive joperformuese, pranisë së mjaftueshme të likuiditetit, profitit të lartë (posaqërisht në dy vitet e fundit), si dhe nivelit mjaftë të ulët të asetëve të mbajtura në valutë të huaj. Që nga TM2 2014, vlera e indeksit në çdo periudhë ka tejkalluar vlerën mesatare të indeksit për periudhën 2008-2015.

Në figurën 109 janë paraqitur komponentët kryesor të indeksit të përgjithshëm të stabilitetit të sektorit bankar, përmes të cilëve mund të shihet se cilët kishin peshën kryesore në rritjen apo uljen e indeksit të përgjithshëm. Rënia e theksuar e indeksit në TM4 2012 shte si rezultat i zvogëlimit të theksuar të kriterit të solvencës³² dhe profitabilitetit. Ndërsa, në TM4 2015, kur indeksi ka arritur nivelin më të lartë, kishte përmirësim në të gjithë kriteret përbërës të indeksit. Më konkretisht, përmirësim më të theksuar kishte në kriterin e rrezikut kreditor, pasuar nga ai i profitabilitetit, solvencës dhe likuiditetit. Në përgjithësi, që nga TM2 2014, indeksi i stabilitetit të sektorit bankar ka tejkalluar mesataren e indeksit prej 0.48 për periudhën 2008-2015, gjë që tregon se sektori bankar i Kosovës ka rritur shkallën e qëndrueshmërisë kundrejt rreziqeve të mundshme.

Figura 109. Kriteret përbërës të indeksit të stabilitetit të sektorit bankar



Burimi: BQK (2016)

³⁰ Sipas rregullores së BQK-së për Adekuatshmërinë e Kapitalit, bankat janë të obliguara të kenë një normë prej së paku 12 përqind të gjithsej kapitalit rregullator në raport me APR dhe normë prej së paku 8 përqind të kapitalit të klasit të parë në raport me APR.

³¹ Sipas Rregullores për Menaxhimin e Likuiditetit, bankat që operojnë në Kosovë duhet të sigurojnë nivel minimal të asetve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra prej 25 përqind.

³² Rënia e kriterit të solvencës rezultoi në masë të madhe nga ndryshimet në Rregullorën mbi Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave në vitin 2012, për përllogaritjen e Kapitalit rregullator dhe Aseteve të Peshuara me Rrezik (APR).

Kutia 3. Identifikimi i bankave me rëndësi sistemike në Kosovë

Modeli për identifikimin e bankave me rëndësi sistemike paraqet një vegël të rëndësishme për vlerësimin e vazhdueshëm të shkallës së rëndësisë sistemike të bankave komerciale në vend. Në përgjithësi, një bankë konsiderohet të ketë rëndësi sistemike nëse pritet që dështimi i mundshëm i saj të manifestohet me pasoja të rëndësishme negative për funksionimin dhe stabilitetin e tërë sektorit dhe për ekonominë në tërësi. Andaj, monitorimi i vazhdueshëm i shkallës së rëndësisë sistemike konsiderohet të jetë i rëndësishëm së veçantë për stabilitetin financiar për shkak se mundëson identifikimin e bankave dështimi i mundshëm i të cilave do të mund të kishte ndikim më të madh për sektorin financiar dhe ekonominë në përgjithësi. Gjithashtu, ky model mundëson hartimin e rekomandimeve për politikën dhe masat e nevojshme për sigurimin adekuat të kapaciteteve absorbuese të humbjeve të mundshme të bankave konform shkallës së rëndësisë së tyre sistemike.

Ky artikull paraqet vlerësimin e shkallës së rëndësisë sistemike për të gjitha bankat dhe degët e bankave të huaja që operojnë në tregun e Kosovës duke u bazuar në të dhënat e muajit dhjetor 2015 të bilanceve të gjendjes së bankave përkatëse. Për vlerësimin e rëndësisë sistemike të bankave, modeli bazohet në pesë kritere bazë: kriterin e madhësisë, zëvendësueshmërisë, ndërlidhjes, aktivitetit ndërshtetëror dhe kompleksitetit. Dy kriteret e para (madhësia dhe zëvendësueshmëria) janë konsideruar si kritere themelore për përcaktimin e rëndësisë sistemike në rastin e Kosovës, andaj dhe pesha e tyre në model është dominuese me nga 40 përqind secila.

Tabela 8. Indikatorët e përdorur për vlerësimin e rëndësisë sistemike të bankave në Kosovë

Kriteri	Indikatorët
Madhësia (pesha 40%)	Asetet (pa provizione) dhe zërat jashtë bilancor
Zëvendësueshmëria (pesha 40%)	Numri i transaksioneve në raport me gjithsej transaksionet përmes sistemit të pagesave Pjesëmarrja në gjithsej kreditë ndaj ekonomive familjare Pjesëmarrja në gjithsej kreditë ndaj korporatave jo-financiare Pjesëmarrja në gjithsej depozitat e ekonomive familjare
Ndërlidhshmëria (pesha 10%)	Pjesëmarrja në gjithsej kreditë ndaj korporatave tjera financiare dhe plasmaneve në bankat tjera (duke mos përfshirë bankat amë) Pjesëmarrja në gjithsej depozitat e korporatave tjera financiare dhe huazimeve tjera (duke përfshirë edhe depozitat e bankave tjera) Pjesëmarrja në letrat me vlerë
Aktiviteti ndërshtetëror (pesha 5%)	Kërkesat ndaj sektorit të jashtëm Detyrimet ndaj sektorit të jashtëm
Kompleksiteti (pesha 5%)	Pjesëmarrja e zërave jashtë-bilancor

Burimi: BQK (2016)

Kriteri i ndërlidhjes në këtë model ka peshë 10 përqind për faktin që sektori bankar i Kosovës ka shkallë të ulët të ndërlidhshmërisë së institucioneve në kuptimin e kreditimit dhe huazimeve të ndërsjellta. Ndërsa dy kriteret tjera (aktiviteti ndërshtetëror dhe kompleksiteti) janë peshuar me nga 5 përqind duke u bazuar në faktin që sektori bankar i Kosovës ka shkallë të ulët të ndërveprimit të sektorit financiar të Kosovës me vendet tjera, si dhe është i bazuar në aktivitete tradicionale të bankingut ku shkalla e kompleksitetit është e ulët ngase financimi bazohet kryesisht në depozita dhe produktet kryesore janë kreditë. Për secilin nga kriteret janë përcaktuar indikatorët përmes të cilëve synohet matja e shkallës së rëndësisë sistemike të bankave individuale. Indikatorët e përdorur janë paraqitur në tabelën 8, dhe secilit prej indikatorëve brenda kriterit të caktuar i është dhënë peshë e barabartë.

Përzgjedhja e indikatorëve është bërë konform teorisë përkatëse dhe sugjerimeve të kornizës mbi të cilin është zhvilluar ky model.

Supozimi i përgjithshëm në raport me kriterin e madhësisë, i konsideruar si kriteri kryesor për matjen e rëndësisë sistemike të një institucioni, është që sa më e madhe të jetë pjesëmarrja e një banke në gjithsej sektorin, aq më e madhe është rëndësia e saj sistemike me që palët e ndikuara në rast të tronditjeve në këtë bankë janë më të shumta dhe kostot për tërë sektorin dhe ekonominë janë më të mëdha. Madhësia e institucioneve është synuar të matet në aspektin e përgjithshëm të pjesëmarrjes së aseteve në gjithsej asetet e sektorit (duke përfshirë zërat jashtë-bilancor).

Kriteri i zëvendësueshmërisë synon që të masë shkallën e zëvendësueshmërisë së ofrimit të produkteve dhe shërbimeve të bankës përkatëse nga bankat tjera në treg, në rast të dështimit të saj. Supozimi kryesor për kriterin e zëvendësueshmërisë është që sa më e madhe pjesëmarrja e një banke në një segment të caktuar të tregut apo në ofrimin e një lloji të caktuar të shërbimit, aq më të larta janë kapacitetet teknike dhe

njohuritë për funksionim në sektorin përkatës (p.sh. të sistemit të pagesave), gjë që e bëjnë më të vështirë zëvendësimin e rolit të saj në ofrimin e shërbimeve të caktuara bankare (pagesa që janë unike vetëm për një bankë). Andaj, edhe rëndësia sistematike e një institucioni rritet kur vështirësitë për zëvendësimin e ofrimit të shërbimeve dhe produkteve të saj janë më të mëdha.

Kriteri i ndërlidhshmërisë ka për qëllim që të masë shkallën e ndërlidhshmërisë së institucioneve bankare ndërmjet vete si dhe me institucionet tjera financiare në vend në mënyrë që të identifikojë rrezikun e efektit shpërndarës së krizës së një institucioni tek institucionet tjera financiare dhe sektori real. Ky kriter është i një rëndësie të veçantë për matjen e rrezikut sistematik në vendet me sektorë të zhvilluar financiar ku ndërlidhjet mes institucioneve janë të shumta dhe komplekse. Në Kosovë, tregu ndër-bankar është pothuajse joekzistent dhe ndërlidhjet mes institucioneve financiare kryesisht kufizohen në depozitat dhe kreditë që institucionet tjera financiare si kompanitë e sigurimeve, institucionet mikrofinanciare dhe ndihmësit tjerë financiar kanë në bankat komerciale në vend. Rrjedhimisht, ndërlidhja mes institucioneve financiare tentohet të matet përmes pjesëmarrjes së plasmanëve në bankat tjera dhe ekspozimit kreditor për korporatat tjera financiare, si dhe pjesëmarrjes së depozitave dhe huamarrjeve nga korporatat tjera financiare. Në këtë kriter janë përfshirë edhe investimet në letra me vlerë të bankave (kryesisht përbëhen nga investimet në letra me vlerë të qeverisë së Kosovës dhe të qeverive tjera jashtë vendit).

Kriteri i aktivitetit ndërshtetëror ka synim të matë shkallën e ndërveprimit të një banke me sektorin e jashtëm si në kuadër të aseteve ashtu dhe në kuadër të detyrimeve. Ky kriter ka për qëllim të paraqes nivelin e rrezikut të një banke ndaj ekspozimeve të saj në sektorin e jashtëm. Sa më i lartë të jetë niveli i ekspozimit të një banke në sektorin e jashtëm aq më shumë do të kishte rrezik që të ketë ndikim negativ në sektorin e brendshëm bankar. Kosova vazhdon të ketë nivel mjaft të ulët të ndërveprimit bankar me vendet tjera, andaj është immune ndaj rreziqeve të mundshme të cilat vijnë nga sektori i jashtëm.

Sa i përket kriterit të kompleksitetit, synimi i tij është që të masë shkallën e kompleksitetit të modelit të biznesit dhe operacioneve të një banke nën supozimin se sa më kompleks aktiviteti i një banke, aq më të shumta janë ndërlidhjet dhe marrëveshjet me palë të treta, të cilat i rrisin kostot dhe kohën e adresimit të problemeve në rast të falimentimit. Në rastin e Kosovës, si indikator i përafërt për matjen e kompleksitetit të një banke është marrë pjesëmarrja e zërave jashtë-bilancorë në gjithsej portfolion e aseteve të asaj banke.

Për të identifikuar rëndësinë sistematike të një banke është krahasuar pesha e secilit indikator ndaj mesatares së indikatorit përkatës për tërë sektorin. Në rast se pesha e indikatorit të një institucioni ka tejkaluar mesataren e sektorit (11.1 përqind) atëherë ai institucion është konsideruar të ketë rëndësi sistematike për indikatorin përkatës. Për të konstatuar nëse një bankë është sistematike në një kriter të caktuar, atëherë secilit indikator i është dhënë vlerë e barabartë (nëse një kriter kishte dy indikator; secili do të kishte vlerë prej 0.5) që pastaj është shumëzuar me peshën e tij në atë kriter të caktuar. Nëse kjo mesatare e peshuar ka tejkaluar mesataren e sektorit (11.1 përqind) atëherë banka ka rezultuar të jetë sistematike në atë kriter të caktuar. Kurse, për të konstatuar nëse një bankë është e rëndësishme së përgjithshme sistematike, mesatarja e peshuar e secilit kriter është shumëzuar me peshën përkatëse të kriterit (tabela 8) për çdo bankë. Pastaj këto rezultat janë mbledhur dhe nëse vlera ka tejkaluar mesataren e sektorit (11.1 përqind) atëherë ajo bankë është konsideruar me rëndësi të përgjithshme sistematike.

Rezultatet

Rezultatet e përgjithshme të modelit me të dhëna të muajit dhjetor 2015 janë paraqitur në tabelën 9. Rezultatet mbesin të ngjashme me ato të periudhës së njëjtë të vitit paraprak. Katër banka vazhdojnë të konsiderohen me rëndësi të përgjithshme sistematike. Sidoqoftë, intervali i shkallës së rëndësisë sistematike ka shënuar rënie të lehtë me një shtrirje nga 13.1 përqind, për shkallën më të ulët të rëndësisë sistematike, deri në 24.6 përqind për shkallën më të lartë, për dallim nga viti paraprak kur ky interval ishte nga 12.9 përqind –24.5 përqind. Krahasuar me vitin paraprak, një bankë e rëndësishme së përgjithshme josistemike rezultoi të ishte sistematike në kriterin e zëvendësueshmërisë dhe ndërlidhshmërisë, për dallim nga periudha paraprake kur ishte sistematike në kriterin e ndërlidhshmërisë dhe të kompleksitetit. Duke marrë parasysh që kriteri i zëvendësueshmërisë ka peshë mjaft të madhe (40 përqind) për dallim nga kriteri i kompleksitetit (5 përqind), kjo ka ndikuar që të kemi rënie të shkallës së rëndësisë së përgjithshme sistematike në 75.9 përqind (77.5 përqind në vitin 2014).

Tabela 9. Rezultatet e rëndësisë sistemike të bankave në Kosovë, sipas kriterëve

Bankat/Kriteri	Madhësia	Zëvendësueshmëria	Ndërlidhshmëria	Aktiviteti ndërshtetëror	Kompleksiteti	TOTAL
Banka 1						
Banka 2						
Banka 3	√	√	√		√	√
Banka 4	√	√	√	√	√	√
Banka 5						
Banka 6		√	√			
Banka 7	√	√	√	√	√	√
Banka 8	√	√		√	√	√
Banka 9						

Burimi: BQK (2016)

Kriteri i madhësisë - Katër bankat me rëndësi të përgjithshme sistemike rezultojnë të tilla edhe në kriterin e madhësisë në vitin 2015, ngjashëm me tri vitet paraprake. Shkalla e rëndësisë sistemike për këto banka në kriterin e madhësisë në vitin 2015 shtrihet nga 13.4 përqind në 25.7 përqind. Bankat e rëndësisë sistemike krahasuar me vitin e kaluar zvogëluar shkallën e tyre sistemike. Rritja e lehtë e koncentrimin të bankave me rëndësi josistemike ishte si rezultat i rritjes së përsheptuar të aktivitetit të tyre, krahasuar me rritjen më të ngadalësuar të bankave të rëndësisë sistemike.

Kriteri i zëvendësueshmërisë - Katër bankat e rëndësisë së përgjithshme sistemike rezultojnë të jenë sistemike edhe në kriterin e zëvendësueshmërisë. Mirëpo, për dallim nga viti paraprak, është shtuar një bankë e rëndësisë së përgjithshme josistemike në këtë kriter, duke ngritur numrin e bankave që kanë rëndësi sistemike në kriterin e zëvendësueshmërisë në pesë. Shkalla e rëndësisë sistemike në këtë kriter në vitin 2015 shtrihet nga 11.5 përqind në 21.0 përqind. Bankat e rëndësisë sistemike krahasuar me vitin të kaluar zvogëluar shkallën e tyre sistemike. Rënia ishte si rezultat i rritjes më të ngadalësuar të kreditimit të bizneseve dhe ekonomive familjare nga bankat e rëndësisë së përgjithshme sistemike krahasuar me rritjen e theksuar të kreditimit në këto dy kategori te bankat josistemike. Ngjashëm, edhe në depozita, bankat josistemike u karakterizuan me rritje të theksuar të depozitave të ekonomive familjare krahasuar me rritjen mjaft të ulët të tyre në bankat e rëndësisë së përgjithshme sistemike. Po ashtu, një tjetër faktor tjetër kontribues ishte edhe pjesëmarrja në numrin e gjithsej transaksioneve të sistemit të pagesave prej bankave, që rezultoi në jetë një shpërndarje më e balancuar në mes të bankave. Andaj, dështimi i pjesës më të madhe të bankave do të kishte efekte serioze në sistemin elektronik ndërbankar të pagesave të Kosovës.

Kriteri i ndërlidhjes - Katër banka kanë rezultuar të jenë sistemike në kriterin e ndërlidhjes, prej të cilave tri janë bankat me rëndësi të përgjithshme sistemike dhe një është josistemike. Shkalla e rëndësisë sistemike për bankat në kriterin e ndërlidhjes në vitin 2015 shtrihet nga 16.4 përqind në 28.0 përqind. Bankat e rëndësisë sistemike në këtë kriter krahasuar me vitin e kaluar zvogëluar shkallën e tyre sistemike. Kjo rënie te bankat e rëndësisë sistemike ishte si rezultat i zvogëlimit të aktivitetit (si në kuadër të aseteve – kreditimit; dhe të detyrimeve-mbajtjes së depozitave) me institucionet tjera financiare. E vetmja kategori që shëno rritje ishte ajo e investimeve në letra me vlerë por që nuk kishte efekt në zbutjen e rënies së shkallës sistemike. Në anën tjetër te bankat josistemike, pavarësisht rënies së depozitave të mbajtura nga institucionet tjera financiare dhe investimeve në letrat me vlerë, rritja e mbështetjes ndaj institucioneve financiare (përmes kreditimit) rezultoi në rritjen e lehtë të shkallës së rëndësisë sistemike të tyre.

Kriteri i aktivitetit ndërshtetëror – Për dallim nga viti i kaluar, edhe një bankë tjetër e rëndësisë së përgjithshme sistemike ka rezultuar të jetë sistemike në kriterin e aktivitetit ndërshtetëror, duke ngritur numrin e tyre në tri të tilla. Shkalla e rëndësisë sistemike në këtë kriter shtrihet nga 12.6 përqind në 35.3 përqind. Bankat me rëndësi sistemike në aktivitetin ndërshtetëror krahasuar me vitin e kaluar zvogëluar shkallën e tyre sistemike. Kjo erdhi si rezultat i rritjes së theksuar të aktivitetit me sektorin e jashtëm nga bankat josistemike si në kuadër të aseteve dhe detyrimeve. Ndërsa, në bankat sistemike, pavarësisht rritjes së detyrimeve ndaj sektorit të jashtëm, rënia investimeve në sektorin e jashtëm kishte efekt në zvogëlimin e rëndësisë sistemike të tyre.

Kriteri i kompleksitetit - Katër bankat e rëndësishme të përgjithshme sistemike kanë rezultuar të jenë sistemike në kriterin e kompleksitetit. Shkalla e rëndësishme të përgjithshme të kompleksitetit në vitin 2015 shtrihet nga 16.5 përqind në 29.4 përqind. Bankat e rëndësishme të përgjithshme sistemike krahasuar me vitin e kaluar rritën shkallën e tyre sistemike Rritja erdhi si rezultat i rritjes së lehtë të aseteve jashtë bilancore të tyre, krahasuar me rënien e theksuar të aseteve jashtë bilancore të bankave josistemike.

Përmbledhje - Krahasuar me vitin e kaluar, në 2015 është rritur pesha e bankave me rëndësi të përgjithshme josistemike, përderisa ato me rëndësi të përgjithshme sistemike shënuan rënie të lehtë. Rritja u vërejt në kriterin e aktivitetit ndërshtetëror dhe atë të zëvendësueshmërisë, si rezultat i investimeve në sektorin jashtëm dhe rritjes së nivelit të depozitave nga ekonomitë familjare, e cila u reflektua edhe në rritjen e aktivitetit kreditues ndaj ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare prej bankave josistemike. Bankat e rëndësishme josistemike vazhdojnë të kontribuojnë në funksionimin e aspekteve të caktuara në kuadër të sektorit bankar. Këto banka (të rëndësishme josistemike) kanë rol të rëndësishëm në funksionimin efikas të sistemit të pagesave sepse së bashku përfaqësojnë 49.6 përqind të gjithëj numrit të transaksioneve të sistemit të pagesave. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe një bankë josistemike ka rezultuar të jetë e rëndësishme sistemike në kriterin e zëvendësueshmërisë, njërin prej kritereve kryesore për nga rëndësia dhe pesha në identifikimin e bankave të rëndësishme sistemike. Andaj, pavarësisht shkallës së rëndësishme të përgjithshme të gjitha bankat kanë rol të rëndësishëm në funksionimin e sektorit bankar sepse dështimi i mundshëm i cilës do nga ato do të mund të kishte efekt të rëndësishëm negativ në funksionimin e sistemit financiar dhe ekonomisë së vendit në përgjithësi.

6.5. Analiza Stres-Test

Analiza stres-test paraqet një vegël të rëndësishme të vlerësimit të qëndrueshmërisë së sektorit bankar ndaj tronditjeve të mundshme në portofolin kreditor si dhe në pozitën e likuiditetit, të cilat mund të pasojnë nga zhvillimet e pafavorshme makroekonomike dhe ndryshimet në kushtet e tregut. Përmes kësaj analize vlerësohet ndikimi i këtyre tronditjeve në kualitetin e portofolit kreditor, në nivelin e kapitalizimit si dhe në pozitën e likuiditetit.

Analiza e prezantuar më poshtë ka për bazë të dhënat e sektorit bankar të Kosovës për muajin dhjetor 2015, të cilat janë shfrytëzuar për vlerësimin e qëndrueshmërisë së sektorit ndaj rrezikut kreditor, të kombinuar me rrezikun nga norma e interesit dhe nga norma e këmbimit valutor (rreziku i tregut). Në analizë është testuar gjithashtu aftësia e sektorit që të ruaj gjendjen e likuiditetit nën supozime hipotetike për tërheqje të konsiderueshme të depozitave (rreziku i likuiditetit).

Rezultatet e analizës stres-test në vazhdimësi sugjerojnë aftësi të kënaqshme të sektorit për të përballuar 'situatat ekstreme' të ekspozimit ndaj këtyre rreziqeve.

6.5.1 Rreziku kreditor

Metodologjia

Skenari bazë: Analiza mbështetet në skenarin hipotetik se gjendja ekonomike në eurozonë dhe në rajon do të përkeqësohet, dhe kjo do të reflektohet në ekonominë e Kosovës kryesisht përmes zvogëlimit të dërgesave të emigrantëve dhe eksporteve, duke dekurajuar kështu kërkesën e përgjithshme në vend. Si rezultat, supozohet të ketë rënie ekonomike, gjë e cila e rrit hendekun negativ të prodhimit dhe ndikon në rritjen e kredive joperformuese. Në këtë skenar është marrë parasysh norma mesatare e rritjes ekonomike në Kosovë prej rreth 3.1 përqind në gjashtë vitet e fundit si dhe është supozuar rënie ekonomike prej 2.6 përqind për vitin 2015. Në këtë situatë, hendeku i prodhimit do të ishte 5.7 përqind, ndërsa ndikimi në cilësinë e portofolit kreditor, gjegjësisht në kreditë joperformuese (KJP), është vlerësuar duke konsideruar një koeficient të

elasticitetit të KJP-ve ndaj hendekut të prodhimit prej 0.8,³³ që nënkupton rritje prej 4.6pp të pjesëmarrjes së KJP-ve në gjithsej kreditë e sektorit bankar. Si pasojë e tronditjeve në sektorin real, është supozuar që kreditimi nuk do të shënojë rritje në vitin vijues.

Në një skenar shtesë ndaj skenarit bazë, krahas rrezikut kreditor, janë konsideruar edhe efektet e rrezikut të tregut në të hyrat e sektorit. Pra, rreziku kreditor është kombinuar me rrezikun nga norma e interesit dhe nga norma e këmbimit. Normat e interesit për pjesën e aseteve janë supozuar të bien për 2.0pp, ndërsa për pjesën e detyrimeve të ngriten për 1.5pp kryesisht si rezultat i konkurrencës ndërbankare. Zhvlerësimi i valutës euro ndaj valutave të tjera është supozuar të jetë 20 përqind.

Efektet e supozimeve të mësipërme në sektorin bankar reflektohen si në vijim: rritja e pjesëmarrjes së KJP-ve në gjithsej kreditë ndikon në rritjen e provizioneve; zhvlerësimi i euros ndikon në rivlerësimin e humbjes/fitimit nga pozicionet e hapura neto, si dhe zvogëlimi i normave të interesit ndikon në humbjet/fitimet e të hyrave neto nga interesi duke marrë parasysh afatin e maturimit të aseteve dhe detyrimeve dhe riinvestimin/rifinancimin e tyre.

Krahas këtyre supozimeve, është marrë parasysh profiti i pritur si një absorbues i humbjeve nga këto tronditje. Në këtë kontekst, është supozuar se profiti gjithashtu do të ndikohet nga tronditjet e lartpërmendura, kryesisht përmes rënies së aftësisë së gjenerimit të të hyrave nga interesi si rezultat i mos rritjes së kreditimit si dhe dështimit të kredive (rritjes së KJP-ve). Andaj, profiti i pritshëm i bankave është llogaritur duke marrë për bazë profitin neto pas tatimit të vitit 2015, ndaj të cilit fillimisht është aplikuar tronditje prej 40 përqind për të reflektuar efektin e mos rritjes së kreditimit, dhe pastaj janë zbritur edhe të hyrat që do të realizoheshin po qe se KJP nuk do të rritej.³⁴

Rritja e supozuar e KJP-ve është shprehur përmes migrimit të kredive nga kategoritë performuese (standarde, në vëzhgim, nënstandarde) drejtë kategorive jo-performuese (të dyshimta dhe të humbura). Kjo rritje është shpërndarë proporcionalisht në kuadër të kategorisë së kredive të dyshimta dhe të kredive të humbura, duke marrë për bazë pjesëmarrjen fillestare të këtyre kategorive në gjithsej KJP-të. Rritja e KJP-ve reflektohet në nivelin e provizioneve bazuar në rregulloren e BQK-së për provizionimin e kredive sipas klasifikimit. Supozimi për rritjen e KJP-ve aplikohet edhe te zërat jashtë-bilancor që përfshijnë zotimet e pashfrytëzuara, garancionet, letër kreditë në dispozicion, dhe letër kreditë komerciale.

Me gjithë faktin se në skenarin shtesë është konsideruar zhvlerësimi i euros ndaj valutave të huaja për të vlerësuar rrezikun e normës së këmbimit valutor, është me rëndësi të potencohet se ndikimi i këtij rreziku në bilancin e gjendjes së sektorit bankar vazhdon të jetë minor për shkak të vlerës së ulët të pozicioneve të hapura neto në valutë të huaj.

Skenari mbi rrezikun nga norma e interesit nënkupton zvogëlimin e normave të interesit për 2pp për asetet dhe rritjen për 1.5pp për detyrimet në bilancin e gjendjes. Zvogëlimi i normave të interesit mund të ndikojë në margjinën neto të interesit (angl. Net Interest Margin: NIM), kryesisht duke marrë parasysh afatin e maturimit të kredive dhe depozitave ngase pjesa dërmuese e kredive dhe depozitave në sektorin bankar të Kosovës kanë normë fikse të interesit dhe ndryshimet në norma të interesit nuk reflektohen deri në maturim. Efekti negativ në të hyra nga rënia e normës së interesit në anën e aseteve theksohet edhe më tutje nga efekti negativ që ka rritja e normës së interesit për detyrimet.

Skenarë tjerë shtesë: Krahas skenarëve bazë të lartpërmendur, skenarë shtesë në analizën mbi rrezikun kreditor janë konsideruar edhe dështimi i kredimarrësve më të mëdhenjë në secilën

³³ Material kërkimor i FMN-së, i papublikuar, 'CESE Bank Loss Projection and Stress Testing Exercise', Korrik 2009.

³⁴ Vlerësimi i të hyrave të 'humbura' si pasojë e rritjes së KJP-ve është bërë fillimisht duke llogaritur ex-post normën e përgjithshme të interesit në kredi për secilën bankë, e cila më pastaj është shumëzuar me vlerën e shtuar të KJP-ve.

prej bankave, si dhe niveli përballues i KJP-ve për secilën bankë para se të shfaqen problemet me kapitalizim.

Përfundimisht, qëndrueshmëria e sektorit bankar në këtë analizë është vlerësuar në kuptim të ndikimit të skenarëve hipotetik në nivelin e kapitalit rregullator të sektorit bankar, mjeteve të peshuara me rrezik dhe rrjedhimisht, treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit (TMK, angl. Capital Adequacy Ratio: CAR).

Rezultatet

Gjendja e sektorit bankar të Kosovës për sa i përket kapitalizimit në vitin 2015 ishte mjaft e favorshme, me treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit prej 18.7 përqind (tabela 10). Sektori bankar në vitin 2015 vazhdoi të qëndrojë mirë edhe për sa i përket nivelit të kredive joperformuese në raport me gjithsej kreditë, të cilat qëndruan në 6.2 përqind, si dhe mbulimit të kredive joperformuese me provizionet e ndara për humbjet e mundshme nga kreditë në nivelin prej 115.1 përqind.

Nën supozimet e skenarit bazë për vlerësimin e rrezikut kreditor (bilancor dhe jashtë bilancor), në të cilin pjesëmarrja e KJP-ve në portfolion kreditor do të rritej për 4.6pp, ndërsa profiti që do të mbetej pas rënies së supozuar prej 40 përqind do të shfrytëzohej për absorbimin e humbjeve – atëherë TMK i sektorit bankar do të qëndronte në normën prej 17.9 përqind,³⁵ që është mbi minimumin prej 12 përqind të kërkuar nga BQK-ja. Po ashtu, në nivel të bankave individuale, TMK do të tejkalonte normën prej 12.0 përqind për secilën bankë. TMK për bankën me nivelin më të ulët të kapitalizimit do të qëndronte në 12.04 përqind, kurse për bankën me nivelin më të lartë të kapitalizimit do të qëndronte në 23.4 përqind. Pra, nën supozimin e skenarit bazë për vlerësimin e rrezikut kreditor, ku kreditë joperformuese do të rriteshin për 4.6pp, sektori bankar do të mund të përballonte ngritjen e nivelit të KJP-ve pa rrezikuar aftësinë e përmbushjes së kërkesave të mjaftueshmërisë së kapitalit të përcaktuara nga BQK-ja. Në këto rrethana, pjesëmarrja e KJP-ve në gjithsej kreditë e sektorit bankar do të arrinte në 10.7 përqind, ndërsa në nivel të bankave individuale, niveli më i lartë i normës së KJP-ve do të ishte 13.1 përqind.

Duke u bazuar në supozimet e lartpërmendura të tronditjeve, gjithsej humbja e sektorit bankar do të arrinte vlerën prej 65.6 milionë euro (1.14 përqind të vlerës reale të BPV-së për vitin 2015). Megjithatë, kjo vlerë nuk mund të konsiderohet në tërësi si humbje eventuale e sektorit me që duhet të merret parasysh fakti se një pjesë e madhe e kësaj humbje do të absorbohej nga profiti i realizuar gjatë këtij viti. Gjithashtu, një pjesë e humbjeve supozohet se mund të kompensohet nga realizimi i kolateralit apo nga riprogramimi, por që ky aspekt nuk është konsideruar për qëllim të kësaj analize.

Rezultatet e skenarit shtesë, në të cilin rreziku kreditor kombinohet me rrezikun e tregut, ku krahas rritjes së normës së KJP-ve për 4.6pp, përfshihet edhe zhvlerësimi i euros dhe lëvizja e normave të interesit në nivelet e supozuara më lartë, TMK e sektorit bankar do të zbriste në 16.5 përqind. Në këtë rast, dy banka do të zbrisnin nën minimumin rregullator të TMK prej 12 përqind, dhe nevojat për rikapitalizim do ishin 1.92 milionë euro (0.03 përqind të vlerës reale të BPV-së për vitin 2015). Në këtë skenar, efekti i zhvlerësimit të euros paraqitet në nivel të ulët si rezultat i vlerës së ulët të pozicionit të hapur neto në krahasim me efektin nga rënia e normave të interesit i cili ishte më i theksuar. Po ashtu, edhe ndryshimet në normat e interesit që do të shkaktonin humbje shtesë, nuk do të ishin problem për sektorin bankar, i cili do të kishte nivel të kapitalizimit mbi 12 përqind.

³⁵ Vlen të theksohet se në këtë edicion, ashtu si në Raportin e Stabilitetit nr.8, ka ndryshim metodik në vlerësimin e rrezikut kreditor, ku humbjet e vlerësuarat vjetore tash e tutje nuk zbriten nga mjetet e peshuara me rrezik për qëllim të kalkulimit të normës së kapitalizimit (TMK) pas tronditjeve. Ky ndryshim është konform praktikës që kreditë e klasifikuara si të humbura nuk ndodhë të shlyhen nga bilanci i gjendjes para se të kalojë një vit, dhe me që horizonti kohor i analizës stres-test është një vit, sugjerohet që humbjet e tilla të mbeten në kuadër të mjeteve të peshuara me rrezik me faktor (peshë) të njëjta të rrezikut. Ky ndryshim metodik paraqet qasje më konservative të vlerësimit të rrezikut kreditor në krahasim me edicionet paraprake.

Një skenar tjetër shtesë supozon dështimin e ekspozimeve të mëdha kreditore. Rezultatet e skenarit në të cilin supozohet dështimi i tre kredimarrësve më të mëdhenj në secilën nga bankat, sugjeron që TMK i sektorit do të zbriste në 16.1 përqind. Në këto rrethana, në dy banka TMK do të zbriste nën nivelin minimal të kërkuar prej 12 përqind dhe mjetet shtesë të nevojshme për ngritjen e kapitalit në nivelin minimal të kërkuar do të ishin 24.12 milionë euro (vlerë ekuivalente me 0.42 përqind të vlerës reale të BPV-së). Nën supozimin e dështimit të pesë kredimarrësve më të mëdhenj në secilën bankë, TMK i sektorit do të zbriste në 14.2 përqind, ndërsa tri banka do të paraqiteshin të nënkapitalizuara. Vlera e nevojshme për rikapitalizimin e sektorit bankar do të arrinte në 50.51 milionë euro (vlerë ekuivalente me 0.88 përqind të vlerës reale të BPV-së për vitin 2015).

Sektori bankar në tërësi është në gjendje të përballojë një raport të KJP-ve ndaj gjithsej kredive deri në 18.2 përqind pa u paraqitur nevoja për injektim të kapitalit shtesë për mbajtjen e TMK-së të sektorit në nivelin e kërkuar rregullator prej 12 përqind. Poashtu, nivelet përballuese të KJP-ve të secilës bankë para se të shfaqen probleme me kapitalizim (para se TMK të zbres nën nivelin 12 përqind) duken të jenë të larta për shumicën e bankave. Në një prej bankave, KJP do të mund të rritej deri në 24.0 përqind të gjithsej portofolit të kredive të asaj banke para se të paraqitet nevoja për kapital shtesë. Në disa banka, nivelet përballuese të normës së KJP-ve paraqiten më të ulëta, ku niveli më i ulët në njërin nga bankat është 10.8 përqind.

Tabela 10. Përmbledhje e rezultateve të stres-testit: rreziku kreditor

Përshkrimi	Numri i bankave 1/			TMK			KJP			Rikapitalizimi 2/		
	TMK <0	TMK 0-8%	TMK 8-12%	Niveli më i ulët	Niveli më i lartë	Niveli i sektorit	Niveli më i ulët	Niveli më i lartë	Niveli i sektorit	Në milionë	Si % e BPV-së	
Nivelet aktuale (para goditjeve)	0	0	0	13.5%	21.6%	18.7%	3.8%	8.5%	6.2%			
Rezultatet e makroskenarëve:												
Skenari bazë	0	0	0	12.0%	20.6%	17.9%	4.6%	13.1%	10.7%	€	-	0.00%
Kombinimi me rrezik të tregut	0	0	2	11.1%	19.1%	16.5%	4.6%	13.1%	10.7%	€	1.92	0.03%
Dështimi i tre kredimarrësve	1	1	0	6.6%	20.5%	16.1%	7.1%	21.8%	13.5%	€	24.12	0.42%
Dështimi i pesë kredimarrësve	1	1	1	0.9%	20.5%	14.2%	7.1%	27.7%	15.6%	€	50.51	0.88%

Shënim:1/ Nga nëntë bankat e konsideruara në analizën stress-test, numri i bankave të cilat bien nën nivelin e nevojshëm rregullator, i ndarë sipas kategorive.

Shënim: 2/ Në raportim të vlerave minimale dhe maksimale të indikatorëve në nivel të bankave, në disa raste janë përjashtuar vlerat e larta të TMK si dhe norma e KJP prej 0 përqind, të cilat karakterizojnë bankat në fillim të veprimtarisë.

Burimi: BQK (2016)

6.5.2. Rreziku i likuiditetit

Metodologjia³⁶

Skenari bazë: Analiza e rrezikut të likuiditetit mbështetet në skenarin bazë të tërheqjes së një vlere të theksuar të depozitave nga sektori bankar, duke vlerësuar kështu aftësinë e sektorit që të përballojë një tronditje të tillë. Më specifikisht, është konsideruar tërheqja e 8 përqind të depozitave në baza ditore, përgjatë pesë ditëve të njëpasnjëshme, duke ndarë 5 përqind të depozitave të mbetura pas çdo dite për qëllime të operimit të bankës në ditët vijuese. Ndarja e 5 përqind të depozitave për qëllime operacionale nënkupton që, nën paraqitjen e skenarëve të supozuar, rezerva e detyrueshme prej 10 përqind do të përgjysmohej. Skenari po ashtu është ndërtuar mbi supozimin se gjatë kësaj periudhe mundësia e konvertimit të mjeteve likuide në para të gatshme do të ishte 80 përqind e mjeteve likuide, përderisa mundësia e konvertimit të mjeteve jo-likuide në para të gatshme do të ishte vetëm 1 përqind e këtyre mjeteve brenda ditës. Skenari në të cilin bazohet kjo analizë është mjaft konservativ edhe për faktin se nuk është

³⁶ Metodologjia e llogaritjes së mjeteve likuide ka ndryshuar për të qenë konform rregullores së BQK-së për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit. Paraprakisht mjetet likuide për qëllim të analizës stres-test janë llogaritur sipas metodologjisë së Treguesve të Shëndetit Financiar të FMN-së.

marrë parasysh mundësia që bankat të plotësojnë një pjesë të nevojave të likuiditetit përmes burimeve të jashtme të financimit.

Skenarë shtesë: Krahas skenarit të lartpërmendur, si skenarë shtesë në analizën mbi rrezikun kreditor janë konsideruar edhe dështimi i depozitorëve më të mëdhenj në secilën prej bankave, si dhe niveli përbalues i tërheqjes së depozitave për secilën bankë para se të paraqitet nevoja për likuiditet shtesë.

Përfundimisht, qëndrueshmëria e sektorit bankar në këtë analizë është testuar në kuptim të vlerësimit të mjaftueshmërisë së aseteve likuide të bankave për të përballuar tërheqje mjaft të mëdha të depozitave si dhe mjaftueshmërinë e aseteve likuide për të përballuar rrezikun e mundshëm nga koncentrimi i depozitave.

Rezultatet

Spektori bankar i Kosovës u karakterizua me likuiditet të lartë në vitin 2015, ku indikator i kyç i likuiditetit (raporti i mjeteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtëra) qëndroi në 44.9 përqind. Andaj, si rezultat i pozitës së mirë të likuiditetit, sektori bankar në tërësi tregoi aftësi të kënaqshme të përballimit të skenarëve të supozuar të tërheqjes së depozitave.

Rezultatet e skenarit bazë të tërheqjes së 8 përqind të depozitave në ditë, për pesë ditë radhazi, sugjerojnë se sektori bankar i Kosovës do të fillonte të ketë nevojë për likuiditet shtesë vetëm në ditën e katërt, ku tri banka do të kishin mungesë të mjeteve likuide prej gjithsej 13.8 milionë euro (tabela 11). Në fund të ditës së pestë, problemet do të shfaqeshin edhe në një bankë tjetër, duke rritur në katër numrin e bankave që do të kishin mungesë të mjeteve likuide për përballim të tërheqjeve të supozuara të depozitave. Shkalla e tërheqjes së përgjithshme të depozitave në ditën e pestë do të arrinte në 34.1 përqind, dhe shuma e mjeteve likuide shtesë të nevojshme për tejkalimin e problemeve të likuiditetit do të arrinte në 41.73 milionë euro (0.72 përqind e vlerës reale të BPV-së për vitin 2015).

Tabela 11. Përmbledhje e rezultateve të stres-testit: Rreziku i likuiditetit

Përshkrimi	Numri i bankave 1/	Mjetet likuide shtesë të nevojshme (në milionë euro)	Mjetet likuide shtesë të nevojshme si % e BPV-së
Pas ditës së parë	0	-	0.00%
Pas ditës së dytë	0	-	0.00%
Pas ditës së tretë	0	-	0.00%
Pas ditës së katërt	3	13.77	0.24%
Pas ditës së pestë	4	41.73	0.72%

Shënim:1/ Nga nëntë bankat e konsideruara në analizën stress-test, numri i bankave të cilat bien nën nivelin e nevojshëm rregullator, i ndarë sipas kategorive

Burimi: BQK (2016)

Supozimi i dështimit të depozitorëve më të mëdhenj në secilën nga bankat paraqitet të mos jetë shumë shqetësues për gjendjen e përgjithshme të likuiditetit në sektorin bankar. Rezultatet e këtij skenari sugjerojnë se sektori bankar i Kosovës nuk ka koncentrim të theksuar të burimeve të financimit (depozitat si përbërësit kryesorë të detyrimeve); prandaj, tërheqja e menjëhershme e depozitorëve më të mëdhenj në secilën bankë, nuk paraqet rrezik serioz për pozicionin e përgjithshëm të likuiditetit të sektorit bankar.

Niveli përbalues i tërheqjes së depozitave për tërë sektorin bankar para se të shfaqen probleme me likuiditet ishte afër 30.1 përqind, që nënkupton se sektori bankar mund të jetë në gjendje të përballojë tërheqjen e rreth një të tretës (1/3) së gjithsej depozitave pa pasur nevojë për mjete likuide shtesë. Në këtë rast, nën supozimin që vlera e kredive nuk do të rritet, raporti kredi/depozita për sektorin bankar do të arrinte në 106.3 përqind. Poashtu nivelet përbaluese të

tërheqjes së depozitave për secilën bankë para se të shfaqen probleme me likuiditet rezultojnë të jenë të larta në përgjithësi. Banka me pragun më të ulët qëndron në 17.0 përqind, ndërsa ajo me pragun më të lartë në 42.0 përqind.

6.6. Infrastruktura Financiare në Kosovë

6.6.1. Sistemi i Pagesave

Sistemet e pagesave luajnë rol të rëndësishëm në sistemin financiar dhe ekonominë e një vendi, duke marrë parasysh që funksionimi efikas dhe i sigurt i tyre paraqet një faktor shumë të rëndësishëm në ruajtjen dhe promovimin e stabilitetit financiar të vendit. Në Kosovë funksionon një sistem i vetëm për pagesa ndërbankare, Sistemi Elektronik i Kliringut Ndërbankar (SEKN), operuar dhe mbikëqyrur nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.

Sistemi Elektronik i Kliringut Ndërbankar është sistem hibrid i pagesave, përmes të cilit procesohen pagesat me vlera të vogla, me vlera të mëdha si dhe pagesa urgjente.

Numri i transaksioneve të përpunuara nga SEKN në vitin 2015, arriti në 9.8 milionë (9.1 milionë në vitin 2014), duke shënuar rritje vjetore prej 8.7 përqind. Kurse, vlera e gjithsej transaksioneve në vitin 2015, arriti në 7.5 miliardë euro (6.8 miliardë në vitin 2014), që paraqet një rritje vjetore prej 9.4 përqind. Mesatarja ditore e transaksioneve përmes SEKN arriti në 39.5 mijë të tilla, ndërsa vlera e tyre në 30.0 milionë euro.

Në raport me numrin e transaksioneve, pagesat e rregullta masive vazhdojnë ta kenë pjesëmarrjen më të lartë prej 38.3 përqind në kuadër të instrumenteve të pagesave (tabela 12). Këto pagesa janë kryesisht të realizuara për institucionet qeveritare. Më pas vijjnë pagesat prioritare masive me një pjesëmarrje prej 35.2 përqind, që janë kryesisht të realizuara nga institucionet qeveritare (siç janë pagesat e pagave dhe pensione), dhe pagesat xhiro të cilat kanë një pjesëmarrje prej 13.7 përqind, dedikuar kryesisht pagesave të shërbimeve publike. Pagesat e letrave me vlerë, edhe pse kanë peshën më të vogël në numrin e gjithsej pagesave, janë pagesat të cilat kanë shënuar rritjen më të shpejtë në numër (976 në vitin 2015 nga 618 në vitin 2014).

Në raport me vlerën e transaksioneve, pagesat e rregullta vazhdojnë të kryesojnë strukturën e pagesave (49.2 përqind në gjithsej vlerën e transaksioneve), po ashtu këto pagesa shënuan rritje vjetore në vlerë prej 10.4 përqind. Pagesat xhiro vazhdojnë të qëndrojnë në vendin e dytë me pjesëmarrje prej 14.0 përqind në vitin 2015. Këto pagesa rritën pjesëmarrjen nga 13.9 përqind sa ishin në vitin 2014, kryesisht si rezultat i rritjes prej 10.4 përqind në vlerë (1.05 miliardë euro në vitin 2015 nga 949.3 milionë euro në vitin 2014). Pagesat e rregullta masive u karakterizuan me rritjen më të theksuar në vlerë gjatë kësaj periudhe, gjë që u reflektua edhe në rritjen e pjesëmarrjes së tyre në strukturë të pagesave.

Tabela 12. Pjesëmarrja e instrumenteve të pagesave në gjithsej transaksionet e SEKN-së, në përqindje

Përshkrimi	Numri i gjithsej transaksioneve		Vlera e gjithsej transaksioneve	
	Dhjetor 2014	Dhjetor 2015	Dhjetor 2014	Dhjetor 2015
Të rregullta	11.4%	12.3%	48.8%	49.2%
Prioritare	0.3%	0.3%	9.8%	9.5%
Të rregullta - masive	41.2%	38.3%	7.9%	8.0%
Prioritare - masive	35.7%	35.2%	9.4%	9.5%
Pagesat xhiro	11.2%	13.7%	13.9%	14.0%
Letrat me vlerë	0.0%	0.0%	10.2%	9.7%
Debitim Direkt	0.2%	0.2%	0.1%	0.1%

Burimi: BQK (2016)

Pagesat prioritare masive rritën pjesëmarrjen në 9.5 përqind nga 9.4 përqind në vitin 2014 dhe arritën vlerën në 707.5 milionë euro (645.3 milionë euro në vitin 2014). Pagesat e letrave me vlerë përmes SEKN gjatë kësaj periudhe shënuan rritje më të ngadalësuar prej 4.0 përqind (723.0 milionë euro në vitin 2015 nga 695.4 milionë euro në vitin 2014) që rezultoi me rënie të pjesëmarrjes së tyre në strukturë për 0.5 pikë përqindje. Ko rënie e pjesëmarrjes në gjithsej vlerën e transaksioneve përmes SEKN mund të jetë ndikuar nga ngadalësimi i rritjes së letrave me vlerë në sektorin bankar krahasuar me rritjen e theksuar gjatë periudhës së njëjtë të vitit të kaluar prej 30.2 përqind.

Numri i gjithsej llogarive të vlefshme bankare arriti në 1.89 milionë llogari në vitin 2015, që nënkupton që mesatarisht gati çdo qytetar në Kosovë është i pajisur me llogari bankare.³⁷ Nëse e krahasojmë numrin e llogarive bankare në vend me vitin e kaluar kemi një rënie të gjithsej llogarive bankare për 1.6 përqind.³⁸

Llogaritë bankare E-banking përmes të cilave shfrytëzuesit i qasen shërbimeve bankare 'online' nga interneti kanë vazhduar të rriten. Në vitin 2015 numri i gjithsej llogarive E-banking arriti në 187,297, që paraqet rritje vjetore prej 18.7 përqind. Rrjedhimisht, numri dhe vëllimi i transaksioneve përmes shërbimit E-banking është rritur. Numri i gjithsej transaksioneve të realizuara përmes llogarive E-banking arriti në 2,311,564 në vitin 2015 (1,579,838 në vitin 2014). Vlera e gjithsej transaksioneve të realizuara përmes llogarive E-banking arriti në 5.75 miliardë euro (4.22 miliardë në vitin 2014).

Struktura e llogarive E-banking vazhdon të dominohet nga llogaritë rezidente me një pjesëmarrje prej 97.6 përqind në vitin 2015. Në kuadër të llogarive të rezidentëve, llogaritë individuale bankare përbëjnë 79.4 përqind të gjithsej llogarive të rezidentëve dhe pjesa e mbetur nga 20.6 përqind nga llogaritë afariste. Ngjashëm, struktura e llogarive të jo-rezidentëve dominohet nga llogaritë individuale (91.3 përqind në vitin 2015), përderisa llogaria afariste ka një pjesëmarrje prej 8.7 përqind.

Numri i gjithsej kartelave (kartela debiti dhe krediti) që ofrojnë shërbime për tërheqje të parave të gatshme dhe pagesa të ndryshme shënoi rritje vjetore prej 28.1 përqind në vitin 2015. Numri i kartelave me funksion debiti në vitin 2015 arriti në 837,747, kurse me funksion krediti në 203,845. Numri i kartelave të debitit u karakterizua me rritje vjetore prej 23.5 përqind, kurse kartelat e kreditit me rritje vjetore prej 67.6 përqind në vitin 2015. Pjesëmarrjen më të lartë si në kartelat e debitit dhe kreditit në vitin 2015 e kishin kartelat Visa (73.2 përqind përkatësisht 92.4 përqind), pasuar nga kartelat Master Card (21.5 përqind përkatësisht 6.4 përqind).

³⁷ Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, në dhjetor 2014 popullsia e përgjithshme rezidente ishte 1,804,944.

³⁸ Numri i gjithsej llogarive bankare përfshinë: numrin e llogarive rrjedhëse, të kursimit dhe të tjera në bankë.

Infrastruktura bankare në vend sa i përket rrjetit të bankomatëve (angl. Automated Teller Machine: ATM) dhe pajisjeve POS (angl. Point-of-Sale) ka shënuar rritje. Numri i pajisjeve ATM dhe POS (që mundësojnë pagesat në pika të shitjes) shënuan rritje vjetore prej 8.4 përqind përkatësisht rritje prej 3.8 përqind në vitin 2015. Numri i ATM-ve të instaluara nga bankat komerciale në vitin 2015 ishte 540 përderisa numri i POS arriti në 9,705 (tabela 13). Numri i tërheqjeve përmes ATM-ve arriti në 10.4 milionë (9.9 milionë në vitin 2014), me një qarkullim prej 1.22 miliard euro (996.2 milionë në vitin 2014). Numri i pagesave përmes pikave të shitjeve me kartela në терминалет POS në vitin 2015 arrit në 5.5 milionë me vlerë prej 303.2 milionë euro.

Tabela 13. Rrjeti i sektorit bankar

Përshkrimi	Dhjetor 2012	Dhjetor 2013	Dhjetor 2014	Dhjetor 2015
Numri i degëve bankare	43	44	45	45
Numri i nëndegëve bankare	258	245	223	210
Numri i ATM-ve	483	496	498	540
Numri i POS-ve	8,592	9,071	9,349	9,705
Numri i llogarive 'e-banking'	97,089	131,365	157,761	187,297

Burimi: BQK (2016)

Vlera e tërheqjes së parave përmes ATM-ve ndaj gjithsej transaksioneve me kartela arriti në 70.8 përqind në vitin 2015, që tregon për nivel të lartë të përdorimit të parasë së gatshme. Ndërsa, vlera e pagesave përmes POS ndaj gjithsej transaksioneve me kartela arrit në 17.5 përqind (tabela 14).

Tabela 14. Pjesëmarrja e vlerës së transaksioneve me kartela sipas terminaleve në gjithsej vlerën e transaksioneve me kartela, në përqindje

Përshkrimi	Dhjetor 2012	Dhjetor 2013	Dhjetor 2014	Dhjetor 2015
ATM tërheqje në para të gatshme	81.1%	81.0%	78.9%	70.8%
ATM depozitime	0.0%	0.2%	1.1%	10.5%
Kredit transfere nëpërmjet ATM	0.1%	0.1%	0.0%	0.0%
Tërheqje cash në terminale POS	2.3%	2.1%	1.1%	1.2%
Pagesa me kartela në terminale POS	16.5%	16.6%	18.9%	17.5%

Burimi: BQK (2016)

Përkundër pjesëmarrjes së lartë të tërheqjeve cash në vlerën e përgjithshme të transaksioneve me kartela, nga tabela 14 vërehet se krahasuar me vitet e mëparshme është shënuar rënie e pjesëmarrjes së tërheqjeve cash në vlerën e përgjithshme të transaksioneve me kartela. Përderisa tërheqjet cash në terminale ATM në vitin 2014 përbënin 78.9 përqind të vlerës së përgjithshme të transaksioneve me kartela, në vitin 2015 tërheqjet cash përbëjnë 70.8 përqind të vlerës së përgjithshme, duke zvogëluar pjesëmarrjen e tyre me 8.1 pp. Rritja e numrit të ATM-ve të cilët mundësojnë depozitimin e parave në llogaritë e klientëve ka ndikuar që kjo kategori të rris pjesëmarrjen në 10.5 përqind në vitin 2015 nga 1.1 përqind sa ishte në vitet e kaluar.

7. Sektori Pensional

Vlera e aseteve të sektorit pensional në vitin 2015 arriti në 1.24 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 13.1 përqind (figura 110). Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) përfaqëson pjesën më të madhe të aseteve të sektorit (99.5 përqind), ndërsa pjesa e mbetur (0.5 përqind) menaxhohet nga Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve (FSKP) (tabela 15).

Tabela 15. Struktura e sektorit pensional, në përqindje


Përshkrimi	Dhjetor 2012	Dhjetor 2013	Dhjetor 2014	Dhjetor 2015
Kosovë	99.3%	99.4%	99.5%	99.5%
Slloveni-Kosovë	0.7%	0.6%	0.5%	0.5%

Burimi: BQK (2016)

Struktura e aseteve të FKPK-së, në vitin 2015, u dominua nga investimet në tregun e jashtëm, në formë të aksioneve dhe bonove të thesarit të qeverive të huaja, me një pjesëmarrje prej 88.1 përqind të gjithsej investimeve (figura 111). Pjesa e mbetur e aseteve prej 11.9 përqind përbëhet nga investimet brenda vendit. Investimet brenda vendit janë të shpërndara në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës (61.2 përqind), depozita në BQK (34.7 përqind) dhe çertifikata të depozitave (4.1 përqind). Përkundër faktit që investimet në tregun e jashtëm dominojnë strukturën e aseteve të FKPK-së, krahasuar me vitin paraprak, ka një ngadalësim të rritjes së investimeve jashtë vendit krahas rritjes së investimeve brenda vendit.


Struktura e aseteve të FSKP-së po ashtu dominohet nga investimet jashtë vendit, të cilat përbëjnë 86.4 përqind të gjithsej aseteve, përderisa investimet në Kosovë janë të përfaqësuara me 13.6 përqind. Investimet brenda vendit janë të shpërndara në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës (78.6 përqind) dhe depozita (21.3 përqind). Për më tepë, në strukturën e aseteve të FSKP-së investimet jashtë vendit kanë rritur pjesëmarrjen krahasuar me vitin paraprak duke vazhduar kështu me trendin disa vjeçar rritës, ndërsa investimet në vend u karakterizuan me ngadalësim të rritjes (figura 111).

Figura 110. Asetet e sektorit pensional



Burimi: BQK (2016)

Figura 111. Struktura e investimeve të sektorit pensional, në përqindje



Burimi: BQK (2016)


Performanca financiare e sektorit pensional

Sektori pensional gjatë vitit 2015 u karakterizua me performancë pozitive financiare, duke marrë parasysh që të dy fondet shënuan kthim pozitiv në investime dhe ngritje të çmimit të aksionit. Megjithatë, fondet shënuan rritje me ritëm më të ngadalësuar të gjithsej aseteve.

Në vitin 2015, vlera e gjithsej aseteve të FKPK-së arriti në 1.23 miliardë euro, që përkon me rritje vjetore prej 13.1 përqind krahasuar me rritjen vjetore prej 19.1 përqind të regjistruar në vitin 2014 (figura 112). Ngadalësimi i atribuohet ecurisë së arkëtimeve të reja dhe performancës së kthimit në investime. Arkëtimet e reja të FKPK-së në vitin 2015 arritën në 137.5 milionë euro nga rreth 508.0 mijë kontribues, që përkon me një rritje vjetore prej 6.8 përqind. Rrjedhimisht, ka një ritëm më të ngadalshëm të rritjes krahasuar me vitin 2014 kur u arkëtuan 128.7 milionë euro nga rreth 476.6 mijë kontribues që paraqiste një rritje vjetore prej 8.0 përqind. Gjatë vitit 2015 kthimi në investime u karakterizua me rënie, ku deri në dhjetor 2015 vlera e kthimit ishte 29.6 milion euro krahasuar me kthimin prej 66.7 milion euro deri në dhjetor 2014. Kjo ishte si rezultat i kthimit negativ nga investimet në sektorin e jashtëm gjatë tremujorit të dytë dhe të tretë të vitit 2015. Kthimi


më i ulët në investime gjatë vitit 2015 u ndikua nga lëvizjet në tregjet financiare globale gjatë tremujorit të dytë dhe të tretë të vitit 2015, si rezultat i zhvillimeve ekonomike dhe politike në disa vende të eurozonës dhe ngadalësimi i rritjes së ekonomisë kineze, që u reflektuan edhe në ekonominë e SHBA-ve, dhe rrjedhimisht ndikuan në performancën e tregjeve ku janë të investuara asetet e FKPK-së. Për kundër këtyre zhvillimeve, FKPK mbylli vitin 2015 me çmim më të lartë të aksionit krahasuar me vitin paraprak. Në ditën e fundit të muajit dhjetor 2015, çmimi i aksionit arriti në 1.317 euro (1.288 euro në dhjetor 2014). Ngjashëm, FSKP gjatë vitit 2015 shënoi rritje vjetore të aseteve dhe kthim pozitiv nga investimet. Në vitin 2015, vlera e gjithsej aseteve të FSKP-së arriti në 6.0 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 3.7 përqind, që paraqet një ngadalësim të ritmit të rritjes krahasuar me normën vjetore të rritjes prej 9.2 përqind të regjistruar në vitin 2014 (figura 113). Ngadalësimi i rritjes ishte pasojë e rritjes më të ngadalshme të arkëtimeve të reja dhe po ashtu kthimit më të ulët nga investimet. Vlera e kontributeve të arkëtuara në vitin 2015 arriti në 461.4 mijë euro nga 4,025 kontribues, që përkon me një rritje vjetore prej 1.8 përqind. Kjo paraqet një ngadalësim të theksuar krahasuar me vitin 2014 kur ishin arkëtuar 453.2 mijë euro nga 393.0 mijë kontribues (rritje vjetore prej 17.3 përqind). Kthimi bruto nga investimet e FSKP-së deri në dhjetor 2015 arriti në 158.7 mijë euro, që është dukshëm më i ulët krahasuar me kthimin prej 371.9 mijë euro të regjistruar në

Figura 112. Asetet e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës



Burimi: BQK (2016)

Figura 113. Asetet e Fondit Silloveno-Kosovar të Pensioneve



Burimi: BQK (2016)

vitin 2014. Ngjashëm me FKPK-në, performanca e investimeve të FSKP-së u ndikua nga lëvizjet në tregjet financiare globale gjatë tremujorit të dytë dhe të tretë të vitit 2015. Në ditën e fundit të dhjetorit 2015, çmimi i aksionit të FSKP-së arriti në 145.30 euro (145.16 euro në dhjetor 2014).³⁹

³⁹ Vlera bazë e aksionit të FSKP-së është 100 për dallim nga ajo e FKPK-së që është 1.

8. Sektori i Sigurimeve⁴⁰

Struktura e sektorit të sigurimeve vazhdon të dominohet nga shërbimet e sigurimit 'jo-jetë' i cili përfaqëson 90.05 përqind të tregut të sigurimeve, ndërsa pjesën e mbetur prej 9.95 përqind e përfshijnë shërbimet e sigurimit 'jetë'. Në tregun vendor operojnë 12 kompani që ofrojnë produkte të sigurimit 'jo-jetë', ndërsa tri kompani vazhdojnë të ofrojnë produkte të sigurimit 'jetë'.

Sektori i sigurimeve vazhdon të dominohet nga kompanitë me pronësi të huaj, të cilat menaxhojnë 71.7 përqind të gjithë asetëve të sektorit. Pjesa e mbetur prej 28.3 përqind e asetëve të sektorit të sigurimeve menaxhohet nga pesë kompanitë vendore të sigurimit.

Sa i përket origjinës së pronësisë së huaj, 27.1 përqind e asetëve të sektorit janë në menaxhim të katër institucioneve me origjinë të kombinuar nga Austria dhe Shqipëria. Nga Sllovenia dhe Shqipëria veprojnë nga dy kompani të cilat menaxhojnë 14.1 përqind dhe 15.3 përqind, përkatësisht, të asetëve të sektorit. Kurse, nga Turqia dhe Kroacia veprojnë nga një kompani të cilat menaxhojnë 8.0 përqind përkatësisht 7.2 përqind të gjithë asetëve të sektorit (figura 114).

Shkalla e koncentrimit të tregut në sektorin e sigurimeve mund të konsiderohet e ulët, sidomos në krahasim me shkallën e koncentrimit të tregut bankar. Indeksi Herfindahl-Hirschman i kalkuluar për asetet e kompanive të sigurimeve tregon 787 pikë në vitin 2015 (887 pikë në vitin 2014). Megjithatë, shkalla e koncentrimit sa i përket primeve ishte më e lartë se në raport me asetet, ku në vitin 2015 Indeksi Herfindahl-Hirschman për primet ishte 1038 pikë (1077 pikë në vitin 2014). Rënia e shkallës së koncentrimit vërehet edhe te pjesëmarrja e tri kompanive më të mëdha në gjithë asetet dhe primet e sektorit, ku në vitin 2015 pjesëmarrja në gjithë asetet ishte 31.2 përqind, ndërsa në gjithë primet ishte 41.4 përqind. Rritja vjetore më e shpejtë e kompanive më të vogla krahasuar me tri më të mëdhatë, ndikoi në zvogëlimin e shkallës së koncentrimit në asete.

8.1. Aktiviteti i sektorit të sigurimeve

Gjithësej asetet e sektorit të sigurimeve në vitin 2015 arritën vlerën 152.7 milionë euro që përkon me një rritje vjetore të përsheptuar prej 9.1 përqind (5.5 përqind në vitin 2014) (figura 115). Rritja e asetëve të sektorit të sigurimeve kryesisht u evidentua në kuadër të sigurimeve 'jo-jetë'

Figura 114. Struktura e asetëve të sektorit të sigurimeve, sipas pronësisë





Figura 115. Asetet e sektorit të sigurimeve



⁴⁰ Të dhënat për sektorin e sigurimeve janë të bazuara në pasqyra financiare jo të audituara.


të cilat shënuan rritje vjetore prej 9.2 përqind (5.1 përqind në vitin 2014). Ndërsa, asetet e sigurimit 'jetë' në vitin 2015 shënuan rritje vjetore prej 7.7 përqind që paraqet një ngadalësim në krahasim me vitin paraprak (9.2 përqind në vitin 2014).

Struktura e aseteve të sektorit të sigurimeve, vazhdoi të dominohet nga depozitat, të cilat përbëjnë 52.2 përqind të gjithsej aseteve. Pjesa tjetër përfaqësohet nga asetet fikse, asetet teknike, paraja e gatshme, etj. (figura 116). Në kuadër të gjithsej aseteve të sektorit të sigurimeve, kategoritë që shënuan rritjen më të theksuar ishin asetet tjera financiare që përfshijnë investimet në letra me vlerë të cilat gjithashtu kishin kontributin kryesor në rritjen e gjithsej aseteve të sektorit. Kurse, asetet e paprekshme dhe depozitat shënuan rëniet më të theksuara vjetore prej 7.3 përqind dhe 5.7 përqind, përkatësisht.

Në kuadër të detyrimeve dhe burimeve vetanake, rezervat teknike kryesojnë me 60.3 përqind të gjithsej financimit, ndërsa në pjesën e mbetur hyjnë kapitali vetanak, detyrimet tjera dhe kreditë (figura 117). Rezervat teknike gjithashtu shënuan rritjen më të theksuar vjetore prej 13.6 përqind, pasuar nga vlera e kapitalit vetanak që shënoi rritje vjetore prej 12.7 përqind. Në rritjen e kapitalit vetanak, kontributin më të lartë e kishte shtimi i kapitalit aksionar prej dy kompanive të reja të cilat kanë filluar të operojnë në tregun e sigurimeve.


Vlera e gjithsej primeve të shkruara të sektorit në vitin 2015 arriti në 80.0 milionë euro që paraqet një rënie vjetore prej 2.6 përqind, për dallim nga viti i kaluar kur primet e shkruara kishin shënuar rritje vjetore prej 3.8 përqind. Struktura e primeve të shkruara kryesohet nga primet e sigurimit 'jo-jetë' të cilat përfaqësojnë 96.6 përqind të gjithsej primeve të shkruara. Primet e shkruara për sigurimin 'jo-jetë' në vitin 2015 arritën vlerën 77.3 milionë euro që përkon me një rënie vjetore prej 3.0 përqind, krahasuar me rritjen vjetore prej 3.4 përqind të regjistruar në vitin 2014. Pjesa tjetër e gjithsej primeve të shkruara nga sektori i sigurimeve përbëhet nga primet e sigurimit jetë, të cilat përfaqësojnë vetëm 3.4 përqind të gjithsej primeve të sektorit. Në vitin 2015, primet e

Figura 116. Struktura e aseteve të sektorit të sigurimeve, në përqindje




Burimi: BQK (2016)

Figura 117. Detyrimet dhe kapitali i sektorit të sigurimeve, në përqindje



Burimi: BQK (2016)

Figura 118. Bruto primet e arkëtuara, në milionë euro



Burimi: BQK (2016)


sigurimit jetë arritën vlerën 2.7 milionë euro që paraqet një rritje vjetore prej 11.1 përqind (18.9 përqind në vitin 2014) (figura 118).

Në kuadër të gjithsej primeve të shkruara, kategoria e Përgjegjësitë ndaj Palës së Tretë (PPT) vazhdon të jetë kategoria kryesore me pjesëmarrje prej 51.8 përqind në vitin 2015, pasuar nga kategoria e sigurimeve kufitare, të cilat shënuan rënie vjetore të pjesëmarrjes prej 5.4 pikë përqindje (në 12.6 përqind). Në vendin e tretë vazhdojnë të jenë primet e sigurimit të shëndetit, të cilat rritën lehtësisht pjesëmarrjen e tyre në 12.0 përqind në vitin 2015 (11.2 përqind në vitin 2014). Në pjesën e mbetur prej 10.8 përqind të kategorizuar si të tjera hyjnë primet e sigurimit nga aksidentet personale, të udhëtimeve, mallrave dhe transportit, dëmtimeve në pasuri etj. Primet e sigurimit të jetës vazhdojnë të kenë një pjesëmarrje relativisht të ulët prej 3.4 përqind në vitin 2015 (figura 119).

Sa i përket ecuresë së primeve sipas kategorive, rritjen më të madhe e shënuan kategoritë PPT+ (26.6 përqind), kasko (16.3 përqind) dhe të shëndetit (4.2 përqind), përderisa me rënien më të theksuar u karakterizua kategoria e sigurimeve kufitare (31.7 përqind).


Në strukturën e primeve bruto të shkruara të sigurimit 'jetë', kategoria 'jeta e kombinuar' që nënkupton sigurimin shëndetësor bashkë me sigurimin e jetës, dominon me pjesëmarrje prej 66.3 përqind. Për më tepër, kategoria 'jeta e debitorit', që nënkupton sigurimin e kredisë, ka pjesëmarrje prej 29.0 përqind (figura 120). Në pjesën tjetër prej 4.7 përqind, hyjnë primet nga sigurimi i jetës në grup, jetës në kursim dhe jetës së depozitorit. Sa i përket ecuresë së këtyre kategorive të primeve, rritjen më të lartë e shënuan kategoritë jeta e debitorit (265.3 përqind nga 216 mijë euro në 789 mijë euro) dhe jeta në grup (32.3 përqind), përderisa me rënie u karakterizuan kategoria e jetës me kursim (40.3 përqind) dhe jetës së kombinuar (14.3 përqind).

Figura 119. Struktura e primeve të shkruara bruto




Burimi: BQK (2016)

Figura 120. Struktura e bruto primeve të shkruara të sigurimit 'jetë'



Burimi: BQK (2016)

Figura 121. Dëmet e paguara, në milionë euro



Burimi: BQK (2016)


Gjithsej dëmet e paguara nga kompanitë e sigurimeve dhe Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) në vitin 2015 arritën vlerën 36.8 milionë euro, duke shënuar një rritje vjetore prej 13.8 përqind, për dallim nga viti i kaluar kur vlera e dëmeve të paguara kishte shënuar rënie vjetore prej 16.8 përqind (figura 122). Ndikim të rëndësishëm në rritjen e gjithsej dëmeve të paguara ka pasur rritja e dëmeve të paguara për sigurimet 'jo-jetë', që shënuan rritje vjetore prej 14.6 përqind, krahasuar me rënien vjetore prej 16.4 përqind në vitin 2014. Po ashtu, rritje kanë shënuar edhe pagesat për dëmet e paguara për sigurimet e jetës, të cilat shënuan rritje vjetore prej 38.3 përqind, krahasuar me rënien vjetore prej 5.0 përqind të regjistruar në vitin 2014. Dëmet e paguara nga Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) po ashtu shënuan rritje, duke regjistruar një normë vjetore të rritjes prej 6.8 përqind (rënie prej 18.2 përqind në vitin 2014).

Rritja e dëmeve të paguara dhe zvogëlimi i vlerës së primeve të shkruara rezultoi në rritje të raportit të gjithsej dëmeve të paguara ndaj primeve të shkruara, në 46.0 përqind krahasuar me 39.4 përqind sa ishte në vitin 2014 (figura 121).

8.2. Performanca financiare e sektorit të sigurimeve


Indikatorët kyç të performancës dhe stabilitetit të sektorit të sigurimeve në vitin 2015 kanë shënuar rënie krahasuar me vitin 2014. Profitabiliteti vazhdon të paraqes shqetësimin kryesor për sa i përket performancës së këtij sektori. Në vitin 2015, sektori i sigurimeve regjistroi humbje në vlerë prej 7.7 milionë euro, krahasuar me humbjen prej 2.5 milionë euro në vitin paraprak. Thellimi i humbjes ishte rrjedhojë e humbjes së shënuar në kuadër të sigurimit 'jo-jetë', përderisa performanca financiare e sigurimit jetë ishte pozitive. Gjatë vitit 2015, sigurimi 'jo-jetë' shënoi humbje neto prej 8.1 milionë euro (humbje prej 3.0 milionë në vitin 2014), ndërsa sigurimi jetë regjistroi fitim neto në vlerë prej 377.9 mijë euro në vitin 2015 (487.5 mijë euro në vitin 2014). Thellimi i humbjes së sektorit shkaktoi përkeqësim të mëtutjeshëm të indikatorëve të profitabilitetit. Kthimi në Mesataren e Aseteve (KMA) u përkeqësua në -5.3 përqind (-1.8 përqind në vitin 2014), kurse Kthimi në Mesataren e Kapitalit (KMK) në -16.0 përqind (-5.5 përqind në vitin 2014) (figura 123). Ecuria e sektorit të sigurimeve ishte më e mirë për sa i përket nivelit të kapitalizimit, ku u shënuua përmirësim krahasuar me vitin paraprak. Në vitin 2015, norma e kapitalizimit arriti në 33.6 përqind, nga 32.5 përqind sa ishte në vitin 2014. Sektori i sigurimeve u karakterizua me rënie të pozicionit të likuiditetit. Raporti ndërmjet parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj ndaj rezervave zbriti në 101.1 përqind në vitin 2015 (119.3 përqind në vitin 2014), përderisa raporti ndërmjet parasë së

Figura 122. Primet e pranuar dhe dëmet e paguara, në milionë euro



Burimi: BQK (2016)

Figura 123. Treguesit e profitabilitetit të sektorit të sigurimeve



Burimi: BQK (2016)


gatshme dhe ekuivalentëve të saj ndaj gjithsej detyrimeve zbriti në 91.9 përqind (102.3 përqind në vitin 2014).

9. Sektori mikrofinanciar dhe Ndhmësit Financiar

Sektori mikrofinanciar u karakterizua me rritje të përshpejtuar të aktivitetit, ku vlera e asetëve në vitin 2015 arriti në 119.7 milionë euro, që përkon me një rritje vjetore prej 6.0 përqind (figura 124). Në tregun vendor operojnë 18 institucione mikrofinanciare⁴¹ nga të cilat 13 kanë pronësi të huaj, duke dominuar tregun me pjesëmarrje prej 92.6 përqind të gjithsej asetëve të sektorit ndërsa 5 janë me pronësi vendore.


Shkalla e koncentrimit të tregut në sektorin mikrofinanciar mund të konsiderohet e ulët në krahasim me shkallën e koncentrimit të tregut bankar mirëpo është më e lartë në raport me sektorin e sigurimeve. Indeksi Herfindahl-Hirschman i kalkuluar për asetet e sektorit mikrofinanciar tregoi 1291 pikë në vitin 2015, që paraqet nivel të ngjashëm me vitin paraprak. Ecuri e ngjashme e shkallës së koncentrimit vërehet edhe në raport me pjesëmarrjen e tri institucioneve më të mëdha në gjithsej asetet e sektorit, që në vitin 2015 ishte 51.6 përqind (52.8 përqind në vitin 2014).

Figura 124. Asetet e sektorit mikrofinanciar, në milionë euro



Burimi: BQK (2016)

Figura 125. Struktura e asetëve të sektorit mikrofinanciar, 2015



Burimi: BQK (2016)

9.1. Aktiviteti i sektorit mikrofinanciar

Struktura e asetëve të sektorit mikrofinanciar dominohet nga kreditë që përbëjnë 68.8 përqind të gjithsej asetëve të sektorit. Kategoria e dytë më e rëndësishme për nga pesha janë lizingjet me pjesëmarrje prej 18.2 përqind në gjithsej asetet e sektorit mikrofinanciar (figura 125). Gjatë tre viteve të fundit vërehet një tendencë e zhvendosjes së peshës së asetëve nga lizingjet, të cilat ndoqën trend rënës, tek kreditë që u karakterizuan me trend rritës në strukturën e gjithsej asetëve.

Kreditë

Vlera e gjithsej kredive të sektorit mikrofinanciar në vitin 2015 arriti në 82.4 milionë euro, që paraqet rritje të përshpejtuar vjetore prej 10.7 përqind (2.9 përqind në vitin 2014). Vlera mesatare e kredisë si raport i gjithsej kredive ndaj numrit të kredive në vitin 2015 ishte 2,441.7

⁴¹ Këtu përfshihen edhe pesë institucione financiare jo-bankare që kryejnë aktivitet kredihënës, lizingut dhe faktoringut

euro (2,156.7 euro në vitin 2014), që paraqet një rritje vjetore prej 13.2 përqind në krahasim me vitin e kaluar.


Gjatë vitit 2015, kreditë ndaj ndërmarrjeve shënuan normë më të lartë të rritjes vjetore (15.6 përqind) krahasuar me kreditë ndaj ekonomive familjare (8.2 përqind). Megjithatë, ishin kreditë ndaj ekonomive familjare, si kategoria kryesore e kredive të sektorit mikrofinanciar, ato të cilat dhanë kontributin kryesor në rritjen e gjithsej kredive të lëshuara nga ky sektor.

Kreditë ndaj ekonomive familjare në vitin 2015 regjistruan rritje vjetore prej 8.2 përqind, që paraqet rimëkëmbje të theksuar krahasuar me rënien vjetore prej 0.4 përqind të shënuar në vitin 2014. Kreditë për ekonomitë familjare përfaqësuan 64.5 përqind të gjithsej kredive të sektorit mikrofinanciar në vitin 2015.

Struktura e kredive të ekonomive familjare sipas afatit të maturimit vazhdon të dominohet nga kreditë me afat maturimi 'mbi 1 deri në 2 vite' që përfaqësojnë 47.0 përqind të gjithsej kredive, pasuar nga ato me afat maturimi 'mbi 2 deri në 5 vite' që përfaqësojnë 29.9 përqind të gjithsej kredive. Kreditë afatshkurtra 'deri në 1 vit' përfaqësojnë 21.4 përqind të gjithsej kredive, ndërsa pjesëmarrjen më të vogël në kreditë ndaj ekonomive familjare e kanë kreditë me afat maturimi 'mbi 10 vite' të cilat përfaqësohen me 0.2 përqind (figura 126).


Kreditimi i ndërmarrjeve, në vitin 2015, shënoi rritje vjetore prej 15.6 përqind krahasuar me rritjen prej 9.9 përqind të shënuar në vitin 2014. Struktura e kreditimit të ndërmarrjeve sipas sektorëve ekonomik mbetet e ngjashme me periudhat paraprake. Kategoria kryesore mbeten kreditë e destinuar për shërbime tjera të cilat, në vitin 2015, përbënë 26.5 përqind të gjithsej kredive të sektorit mikrofinanciar. Për dallim nga sektori bankar, ku kreditë për bujqësinë paraqesin kategorinë me pjesëmarrjen më të ulët, tek institucionet mikrofinanciare bujqësia gëzon një mbështetje më të madhe duke përfaqësuar kategorinë e dytë për nga pesha, me pjesëmarrje prej 25.4 përqind. Kreditë për sektorin e ndërtimit, të cilat kanë një pjesëmarrje prej 19.9 përqind në gjithsej kreditë e sektorit mikrofinanciar, mbetet kategoria e tretë për nga pjesëmarrja në gjithsej kreditë e sektorit mikrofinanciar. Ndërsa, kreditimi i sektorit të tregtisë përfaqëson 18.9 përqind të gjithsej kreditimit mikrofinanciar për dallim nga kreditimi bankar ku ka pjesëmarrjen më të madhe. Sektori i industrisë mbetet sektori me qasjen më të ulët në financimin mikrofinanciar me pjesëmarrje prej 9.0 përqind (figura 127).

Figura 126. Kreditë ndaj ekonomive familjare sipas afatit të maturimit, në përqindje



Burimi: BQK (2016)

Figura 127. Kreditë e sektorit mikrofinanciar sipas veprimtarive ekonomike, 2015



Burimi: BQK (2016)

Sa i përket ecurisë së kreditimit sipas sektorëve të ekonomisë, kreditë për sektorin e tregtisë regjistruan rritjen më të lartë vjetore prej 22.7 përqind në vitin 2015 (19.1 përqind në vitin 2014) (figura 128). Kreditimi i sektorit të industrisë u karakterizua me rritje vjetore prej 21.7 përqind (20.6 përqind në vitin 2014), përderisa kreditimi i sektorit të ndërtimitarisë shënoi rritje vjetore prej 18.3 përqind (12.8 përqind në vitin 2014). Rritja më e theksuar e kreditimit mikrofinanciar për sektorin e tregtisë në kohën e ngadalësimit të rritjes së kreditimit bankar për sektorin e tregtisë; si dhe rritja e theksuar e kreditimit mikrofinanciar për sektorin e ndërtimitarisë krahas rënies së kreditimit bankar për këtë veprimtari mund të shërbejë si evidencë për rritjen e aftësisë së sektorit mikrofinanciar për të plotësuar kreditimin bankar dhe në të njëjtën kohë mund të paraqes rritje të presioneve konkurruese të sektorit mikrofinanciar kundrejt sektorit bankar. Kreditimi për sektorin e shërbimeve tjera në vitin 2015 shënoi rritje vjetore prej 6.4 përqind.

Kreditimi i sektorit të bujqësisë gjithashtu shënoi rritje vjetore të përshpejtuar prej 15.4 përqind (3.6 përqind në vitin 2014). Rritja e kreditimit bankar dhe mikrofinanciar për sektorin e bujqësisë gjatë kësaj periudhe mund të reflektojë edhe zhvillimet në anën e kërkesës për kredi bujqësore, duke pasur parasysh shtimin e aktivitetit bujqësor si rezultat i dyfishimit të buxhetit të alokuar për këtë sektor nga ana e Qeverisë dhe rritjes së subvencioneve dhe granteve të USAID dhe Komisionit Evropian për këtë sektor gjatë vitit 2015.

Sipas afatit të maturimit, kreditë e lëshuara për ndërmarrjet vazhdojnë të kenë kryesisht maturim afatmesëm. Në vitin 2015, kreditë me afat maturimi 'mbi 1 deri në 2 vite' përfaqësuan 42.8 përqind të gjithsej kredive për ndërmarrjet, pasuar nga kreditë me afat maturimi 'mbi 2 deri në 5 vite' të cilat u përfaqësuan me 40.3 përqind. Kategoria e tretë për nga pesha ishin kreditë afatshurtëra 'deri në 1 vit' me pjesëmarrje prej 15.6 përqind. Pjesëmarrjen më të vogël prej 1.2 përqind e kishin kreditë me afat maturimi 'mbi 5 deri në 10 vite' (figura 129).

Lizingjet

Për dallim nga aktiviteti kredidhënës, i cili shënoi rritje të përshpejtuar gjatë vitit 2015, akviteti i lizingut në institucionet mikrofinanciare shënoi një rënie të lehtë. Vlera e lizingjeve të sektorit mikrofinanciar në vitin 2015 zbriti në 21.8 milionë euro, duke shënuar rënie vjetore prej 2.5 përqind (figura 130).

Figura 128. Rritja e kredive të sektorit mikrofinanciar ndaj ndërmarrjeve, sipas veprimtarive ekonomike





Figura 129. Kreditë ndaj ndërmarrjeve sipas afatit të maturimit, në përqindje



Rënia e gjithsej lizingjeve kryesisht i atribuohet rënies së lizingjeve për ekonomitë familjare të cilat shënuan rënie vjetore prej 3.7 përqind në vitin 2015. Gjatë vitit 2015, lizingjet për ekonomitë familjare u karakterizuan me rënie si në kategorinë hipotekare ashtu edhe në kategorinë e lizingjeve tjera. Kontributin më të madh në rënien e lizingjeve për ekonomitë familjare e kishin lizingjet hipotekare, të cilat shënuan një rënie vjetore prej 3.7 përqind krahasuar me rritjen vjetore prej 110.8 përqind të shënuar në vitin 2014. Lizingjet tjera regjistruan një rënie vjetore prej 2.9 përqind (rritje vjetore prej 15.2 përqind në vitin 2014). Lizingjet për ekonomitë familjare diktojnë ecurinë e gjithsej lizingjeve sepse përbëjnë kategorinë kryesore me pjesëmarrje prej 52.8 përqind në strukturën e përgjithshme të lizingjeve (figura 131). Lizingjet për ekonomitë familjare vazhdojnë të dominohen nga lizingjet afatgjata 'mbi 10 vite' të cilat kanë pjesëmarrje prej 46.8 përqind në gjithsej lizingjet e ekonomive familjare pasuar nga lizingjet me afat maturimi 'mbi 5 deri në 10 vite' me pjesëmarrje prej 39.5 përqind. Ndërsa, lizingjet për ndërmarrjet përbëjnë 47.2 përqind të gjithsej asetëve. Në kuadër të tyre pjesën më të madhe e përbëjnë lizingjet afatmesme 'mbi 2 deri në 5 vite' me 89.4 përqind të gjithsej lizingjeve për ndërmarrje, pasuar nga lizingjet me afat maturimi 'mbi 1 deri në 2 vite' me pjesëmarrje prej 7.6 përqind.

Rënie shënuan edhe lizingjet për ndërmarrjet, vlera e të cilave ishte për 1.0 përqind më e ulët se sa në vitin e kaluar. Në kuadër të lizingjeve për ndërmarrjet ishte kategoria e lizingjeve për pajisje që ndikoi në rënien e kësaj kategorie. Në të njëjtën kohë, lizingjet tjera, si kategoria më e madhe në peshë (pjesëmarrje prej 83.2 përqind në strukturën e gjithsej lizingjeve të ndërmarrjeve), ndikuan që kjo rënie të jetë jo shumë e ndjeshme për këtë kategori. Në vitin 2015, lizingjet për pajisje shënuan rënie vjetore më të theksuar prej 36.5 përqind, pasuar nga lizingjet hipotekare të cilat shënuan rënie prej 12.6 përqind. Për dallim nga këto kategori, lizingjet tjera u karakterizuan me rritje vjetore prej 9.8 përqind duke zbutur rënien e ndjeshme të gjithsej lizingjeve ndaj ndërmarrjeve.

Detyrimet

Aktiviteti i sektorit mikrofinanciar financohet kryesisht nga huamarrja prej sektorit të jashtëm. Në dhjetor 2015, gjithsej huamarrjet nga sektori i jashtëm shënuan vlerën prej 62.7 milionë euro, që paraqet rritje vjetore prej 1.4 përqind (rënie prej 1.4 përqind në dhjetor 2014).

Figura 130. Lizingjet e sektorit mikrofinanciar, në milionë euro





Figura 131. Struktura e lizingjeve të sektorit mikrofinanciar



Normat e Interesit

Norma mesatare e interesit në kreditë e sektorit mikrofinanciar gjatë vitit 2015 shënoi rënie, duke ndërprerë kështu trendin rritës të ndjekur gjatë tri viteve të fundit. Në dhjetor 2015, norma mesatare e interesit në kreditë e sektorit mikrofinanciar u zvogëlua në 22.3 përqind nga 23.3 përqind sa ishte në dhjetor 2014 (figura 132). Megjithatë, kjo ecure reflekton kryesisht rënien e normës mesatare të interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve, përderisa norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare vazhdoi të përcjellë trendin rritës të tre viteve të fundit. Në dhjetor 2015, norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare është rritur në 24.4 përqind nga 23.8 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Kurse, mesatarja e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve në dhjetor 2015 u zvogëlua në 19.9 përqind (22.6 përqind në dhjetor 2014), që paraqet një rënie prej 2.7 pikë përqindje (figura 132). Në kuadër të kredive ndaj ndërmarrjeve, kreditë ndaj sektorit të shërbimeve u kredituan me normën mesatare të interesit më të ulët nga të gjithë sektorët ekonomik. Kjo kategori njëkohësisht u karakterizua me rënien më të theksuar prej 1.8 pikë përqindje duke arritur në 19.9 përqind në dhjetor 2015 nga 21.7 përqind në dhjetor 2014. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj sektorit të industrisë po ashtu shënoi rënie, duke arritur në 23.6 përqind në dhjetor 2015 nga 23.8 përqind sa ishte në dhjetor 2014. Ndërsa, norma mesatare e interesit në kreditë ndaj sektorit të bujqësisë mbeti në nivel të ngjashëm me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, duke qëndruar në 25.5 përqind (figura 133). Rënia në normat e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve mund të ketë kontribuar në rritjen e kërkesës së ndërmarrjeve për kredi nga sektori mikrofinanciar.

9.2. Performanca e sektorit mikrofinanciar

Sektori mikrofinanciar u karakterizua me përmirësim të performancës financiare në krahasim me tre vitet e fundit. Në vitin 2015, sektori mikrofinanciar realizoi profit në vlerë prej 2.5 milionë euro, krahasuar me profitin prej 0.7 milionë euro të realizuar në vitin 2014. Rritja e theksuar e profitit ishte kryesisht rezultat i rritjes së përshpejtuar të të hyrave, përderisa shpenzimet u rritën me ritëm të ngadalësuar.

Në vitin 2015, sektori mikrofinanciar realizoi të hyra në vlerë prej 21.1 milionë euro, që paraqet rritje vjetore të konsiderueshme prej 9.4 përqind krahasuar me rritjen prej 0.5 përqind të shënuar në vitin 2014. Ndërsa, shpenzimet në vitin 2015 arritën në 18.7 milionë euro, duke paraqitur një rritje të lehtë prej 0.5 përqind për dallim nga rënia prej 4.9 përqind në vitin 2014 (figura 134).

Figura 132. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar





Figura 133. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar, sipas veprimtarive ekonomike



Rritja e përshpejtuar e të hyrave në vitin 2015 ishte kryesisht rezultat i rritjes së të hyrave nga interesi me rritje vjetore 7.0 përqind (rritje prej 3.3 përqind në vitin 2014) dhe të hyrave nga jo-interesi me rritje vjetore prej 21.4 përqind (rënie prej 11.4 përqind në vitin 2014). Në kuadër të të hyrave nga jo-interesi, të hyrat nga shërbimet shënuan rritje vjetore prej 164.9 përqind për dallim nga rritja prej 11.2 përqind në vitin 2014. Të hyrat administrative në vitin 2015 patën një rritje prej 23.2 përqind në krahasim me rritjen vjetore prej 5.6 përqind në vitin paraprak. Ndërsa, të hyrat tjera operative shënuan rritje të konsiderueshme prej 2.0 përqind në krahasim me rënie prej 18.0 përqind në vitin 2014.

Në anën tjetër, rritja e shpenzimeve ishte kryesisht si rezultat i rritjes së shpenzimeve nga jo-interesi të cilat në vitin 2015 arritën në 12.3 milionë euro rritje prej 0.1 përqind në krahasim me rënie prej 8.5 përqind në vitin paraprak dhe shpenzimeve nga interesi të cilat arritën në 4.0 milionë euro që paraqet një rritje prej 5.0 përqind (0.3 përqind në vitin 2014). Në kuadër të shpenzimeve nga jo-interesi, shpenzimet për provizionet për humbjet nga kreditë shënuan rritje të theksuar vjetore prej 8.7 përqind për dallim nga rënia prej 46.7 përqind në vitin 2014, ndërsa shpenzimet e personelit dhe administrative u karakterizuan me rënie vjetore prej 0.7 përqind (rënie prej 1.5 përqind në vitin 2014). Shpenzimet tjera operative po ashtu shënuan rënie të theksuar prej 4.5 përqind në krahasim me rritjen prej 7.3 përqind në vitin paraprak. Rënie në shpenzimet e personelit dhe në shpenzimet tjera operative ndikuan që të ngadalësohet rritja e shpenzimeve të sektorit mikrofinanciar.

Raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave të sektorit mikrofinanciar ka shënuar përmirësim të dukshëm krahasuar me vitin e kaluar. Në vitin 2015, ky indikator u zvogëluar në 88.4 përqind, krahasuar me 96.2 përqind sa ishte në vitin 2014. Kjo ishte si rezultat i rritjes së përshpejtuar të të hyrave të sektorit mikrofinanciar në vitin 2015 dhe ngadalësimit të shpenzimeve gjatë kësaj periudhe.

Rrjedhimisht profiti i realizuar në vitin 2015 ndikoj në përmirësimin e konsiderueshëm të treguesve të profitabilitetit ku Kthimi në Mesataren e Aseteve (KMA) u përmirësua në 2.1 përqind (0.6 përqind në vitin 2014), ndërsa Kthimi në Mesataren e Kapitalit (KMK) u përmirësua në 7.6 përqind (2.4 përqind në vitin 2014) (figura 135).

Sektorit mikrofinanciar vazhdon të karakterizohet me nivel relativisht të ulët të kredive joperformuese dhe nivel të kënaqshëm të provizioneve për mbulimin e kredive joperformuese. Në vitin 2015, pjesëmarrja e kredive joperformuese në gjithsej kreditë u zvogëluar në 4.2 përqind, në krahasim me normën prej 4.8 përqind sa ishte në vitin 2014, ndikuar kryesisht nga ritmi më i

Figura 134. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar





Figura 135. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar




lartë i rritjes së stokut të kredive krahas rritjes së vlerës së kredive joperformuese. Gjithashtu, edhe mbulueshmëria me provizione u përmirësua konsiderueshëm në 124.7 përqind në vitin 2015, krahasuar me nivelin prej 113.1 përqind në vitin 2014 (figura 136).

9.3 Ndhmësit Financiar

Struktura e ndihmësve financiar përbëhet nga byrotë e këmbimit dhe agjensionet për transferim të parave

(ATP). Ky sektor përbënë numrin më të madh të institucioneve financiare në vend, mirëpo menaxhon pjesën më të vogël të aseteve të sistemit financiar (0.2 përqind në vitin 2015). Vlera e aseteve të ndihmësve financiar në vitin 2015 arriti në 10.8 milionë euro, që paraqet rritje vjetore prej 22.3 përqind. Deri në dhjetor 2015, të hyrat e ndihmësve financiar arritën vlerën 7.1 milionë euro, duke paraqitur rritje prej 6.1 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Struktura e të hyrave të ndihmësve financiar dominohet nga kategoria e të hyrave nga transferet, me pjesëmarrje prej 72.5 përqind, që u karakterizuan me rritje vjetore prej 3.0 përqind. Në anën tjetër, shpenzimet arritën vlerën prej 3.7 milionë euro, që paraqet rënie vjetore prej 4.8 përqind. Neto fitimet për sektorin e ndihmësve financiarë në vitin 2015 arritën vlerën prej 3.4 milionë euro, që paraqet rritje vjetore prej 20.8 përqind.

Figura 136. Treguesit e kualitetit të portfolios kreditorë të sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK (2016)

10. Shtojca statistikore

Tabela 1. Indikatorët e qëndrueshmërisë financiare, në përqind

Sektori bankar	Grupi bazë i indikatorëve	Dhjetor 2012	Dhjetor 2013	Dhjetor 2014	Dhjetor 2015
Mjaftueshmëria e kapitalit	Kapitali rregullativ ndaj asetëve të peshuara ndaj riskut	14.2	16.7	17.8	19.0
	Kapitali i klasit të parë ndaj asetëve të peshuara ndaj riskut	11.6	12.8	14.6	16.7
	Kreditë jo-performuese neto ndaj kapitalit	7.4	7.8	4.7	3.0
Cilësia e asetëve	Kreditë joperformuese ndaj totalit të kredive	7.5	8.7	8.3	6.2
Shpërndarja sektoriale e kredive ndaj totalit të kredive	Korporatat tjera financiare	1.1	1.1	0.4	0.4
	Korporatat publike jofinanciare	0.08	0.01	0.03	0.03
	Korporatat tjera jofinanciare	66.7	66.4	65.7	65.6
	Ekonomitë familjare	30.8	31.3	33.9	33.9
	OJSHEF	0.02	0.05	0.01	0.01
	Jo-rezidente	1.3	1.1	0.0	0.0
	Gjithsej	100.0	100.0	100.0	100.0
	Profitability	Kthirni në asete (ROA)*	0.8	1.0	2.2
Kthirni në kapital (ROE)*		8.3	10.6	22.6	29.0
Margjina e interesit ndaj te hyrave bruto		74.7	73.1	75.9	75.8
Shpenzimet e jo-nteresit ndaj te hyrave bruto		87.8	84.8	66.6	51.6
Likuiditeti	Asetet likuide (bazë) ndaj totalit të asetëve	25.3	27.7	25.9	24.2
	Asetet likuide (baza e gjërë) ndaj totalit të asetëve	32.6	36.6	32.8	29.2
	Asetet likuide (bazë) ndaj detyrimeve afatshkurtëra	31.7	35.7	32.4	30.9
	Asetet likuide (baza e gjërë) ndaj detyrimeve afatshkurtëra	40.8	47.1	41.0	37.3
Senzitiviteti ndaj riskut të tregut	Pozicionet neto të hapura në valutë të huaj ndaj kapitalit	0.7	2.3	1.8	1.8
Grupi i zgjeruar i indikatorëve					
	Kapitali ndaj asetëve	10.0	9.7	10.8	12.2
	Ekspozimi kreditor ndaj kapitalit	93.4	129.7	97.1	65.7
	Shpenzimet e personelit ndaj shpenzimeve nga jointerеси	38.1	38.5	41.7	36.8
	Dallimi në mes të normës së interesit për kredi dhe depozita	9.1	8.7	8.1	6.5
	Depozitat e klientëve ndaj totalit të kredive (jo ndërbankare)	122.6	131.6	129.3	130.3
	Detyrimet në valutë të huaj ndaj gjithsej të detyrimeve	4.3	4.6	0.0	3.7

* Janë konsideruar të hyrat neto para taksës.

Udhëzuesi: Financial Soundness Indicators, Compilation Guide, IMF (2006)

Tabela 2. Bilancet e gjendjes së bankave komerciale, dhjetor 2015, në milionë euro

Raiffeisen Bank

(Në milionë euro)

Asetet		Detyrimet	
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	86.1	Bilanci nga bankat tjera	2.2
Bilanci me bankat komerciale	55.3	Depozitat	674.4
Letrat me vlerë	227.3	Huamarrjet tjera	0.0
Kreditë	470.6	Detyrimet tjera	52.4
Asetet fikse	8.2	Borxhi i ndërvarur	19.0
Asetet tjera	6.0	Burimet vetanake	105.4
GJITHSEJ ASETET	853.4	GJITHSEJ DETYRIMET DHE BURIMET VETANAKE	853.4

Burimi: BQK (2016)

Procredit Bank

(Në milionë euro)

Asetet		Detyrimet	
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	162.2	Bilanci nga bankat tjera	0.3
Bilanci me bankat komerciale	84.25	Depozitat	671.9
Letrat me vlerë	87.2	Huamarrjet tjera	8.0
Kreditë	460.2	Detyrimet tjera	31.5
Asetet fikse	16.7	Borxhi i ndërvarur	7.5
Asetet tjera	7.0	Burimet vetanake	98.3
GJITHSEJ ASETET	817.4	GJITHSEJ DETYRIMET DHE BURIMET VETANAKE	817.4

Burimi: BQK (2016)

NLB Prishtina

(Në milionë euro)

Asetet		Detyrimet	
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	50.6	Bilanci nga bankat tjera	0.2
Bilanci me bankat komerciale	44.3	Depozitat	398.7
Letrat me vlerë	67.9	Huamarrjet tjera	0
Kreditë	313.1	Detyrimet tjera	30.9
Asetet fikse	12.0	Borxhi i ndërvarur	-
Asetet tjera	1.7	Burimet vetanake	59.7
GJITHSEJ ASETET	489.6	GJITHSEJ DETYRIMET DHE BURIMET VETANAKE	489.6

Burimi: BQK (2016)

TEB Bank

(Në milionë euro)

Asetet		Detyrimet	
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	67.6	Bilanci nga bankat tjera	6.6
Bilanci me bankat komerciale	10.2	Depozitat	342.0
Letrat me vlerë	10.2	Huamarrjet tjera	-
Kreditë	339.7	Detyrimet tjera	30.1
Asetet fikse	5.5	Borxhi i ndërvarur	5
Asetet tjera	3.8	Burimet vetanake	53.8
GJITHSEJ ASETET	437.0	GJITHSEJ DETYRIMET DHE BURIMET VETANAKE	437.0

Burimi: BQK (2016)

Banka Kombëtare Tregtare

(Në milionë euro)

Asetet		Detyrimet	
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	51.3	Bilanci nga bankat tjera	0.1
Bilanci me bankat komerciale	59.0	Depozitat	249.2
Letrat me vlerë	36.5	Huamarrjet tjera	9.5
Kreditë	144.1	Detyrimet tjera	15.7
Asetet fikse	2.8	Borxhi i ndërvarur	0.0
Asetet tjera	3.0	Burimet vetanake	22.3
GJITHSEJ ASETET	296.8	GJITHSEJ DETYRIMET DHE BURIMET VETANAKE	296.8

Burimi: BQK (2016)

Banka Ekonomike

(Në milionë euro)

Asetet		Detyrimet	
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	25.5	Bilanci nga bankat tjera	1.8
Bilanci me bankat komerciale	7.5	Depozitat	163.3
Letrat me vlerë	21.6	Huamarrjet tjera	0.0
Kreditë	132.1	Detyrimet tjera	10.8
Asetet fikse	6.5	Borxhi i ndërvarur	1.1
Asetet tjera	0.8	Burimet vetanake	16.9
GJITHSEJ ASETET	193.9	GJITHSEJ DETYRIMET DHE BURIMET VETANAKE	193.9

Burimi: BQK (2016)

Banka për Biznes

(Në milionë euro)

Asetet		Detyrimet	
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	28.9	Bilanci nga bankat tjera	0.0
Bilanci me bankat komerciale	5.2	Depozitat	115.8
Letrat me vlerë	10.4	Huamarrjet tjera	0.0
Kreditë	91.4	Detyrimet tjera	6.8
Asetet fikse	1.2	Borxhi i ndërvarur	4.9
Asetet tjera	1.2	Burimet vetanake	10.8
GJITHSEJ ASETET	138.3	GJITHSEJ DETYRIMET DHE BURIMET VETANAKE	138.3

Burimi: BQK (2016)

Komercijalna Banka

(Në milionë euro)

Asetet		Detyrimet	
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	6.0	Bilanci nga bankat tjera	0.0
Bilanci me bankat komerciale	48.9	Depozitat	51.8
Letrat me vlerë	0.0	Huamarrjet tjera	-
Kreditë	3.3	Detyrimet tjera	0.7
Asetet fikse	0.0	Borxhi i ndërvarur	0.0
Asetet tjera	1.4	Burimet vetanake	7.1
GJITHSEJ ASETET	59.7	GJITHSEJ DETYRIMET DHE BURIMET VETANAKE	59.7

Burimi: BQK (2016)

Türkiye İş Bankası

(Në milionë euro)

Asetet		Detyrimet	
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	6.9	Bilanci nga bankat tjera	31.5
Bilanci me bankat komerciale	1.2	Depozitat	19.7
Letrat me vlerë	9.7	Huamarrjet tjera	0.0
Kreditë	42.4	Detyrimet tjera	1.1
Asetet fikse	0.9	Borxhi i ndërvarur	0.0
Asetet tjera	0.3	Burimet vetanake	9.1
GJITHSEJ ASETET	61.4	GJITHSEJ DETYRIMET DHE BURIMET VETANAKE	61.4

Burimi: BQK (2016)

Ziraat Bank

(Në milionë euro)

Asetet		Detyrimet	
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	5.8	Bilanci nga bankat tjera	0.0
Bilanci me bankat komerciale	0.0	Depozitat	2.0
Letrat me vlerë	2.5	Huamarrjet tjera	0.0
Kreditë	1.6	Detyrimet tjera	0.1
Asetet fikse	1.3	Borxhi i ndërruarur	0.0
Asetet tjera	0.0	Burimet vetanake	9.3
GJITHSEJ ASETET	11.4	GJITHSEJ DETYRIMET DHE BURIMET VETANAKE	11.4

Burimi: BQK (2016)

Tabela 3.1. Pasqyra e korporatave financiare - asetet e jashtme neto dhe kërkesat e brendshme

(Të dhëna kumulative, fundi i periudhës, në milionë euro)

Përshkrimi	Asetet e jashtme neto								Kërkesat e brendshme							
	Kërkesat ndaj jorezidentëve							Detyrim e ndaj jorezide ntëve	Kërkesat ndaj qeverisë			Kërkesat ndaj sektorëve tjerë	prej të cilave: Kreditë			
	Ari monetar dhe DST-të	Depozita	Letrat me vlerë përveç aksioneve	prej të cilave:		Kërkesat ndaj qeverisë qendrore	Detyrime t ndaj qeverisë qendrore		prej të cilave:							
				Kuota në FMN	Asetet dhe ekuit- ete tjera				Korpor at. tjera jofinan.	Ekon Fami- ljare						
2005	827.3	890.9	—	422.6	242.4	—	145.3	63.6	348.9	-225.7	—	225.7	574.6	565.6	439.6	126.0
2006	1,173.6	1,245.7	—	660.0	341.3	—	170.8	72.1	231.7	-475.0	—	475.0	706.6	694.3	548.2	146.1
2007	1,622.4	1,704.6	—	955.0	408.9	—	175.4	82.3	124.5	-853.3	—	853.3	977.8	965.9	765.1	200.6
2008	1,593.1	1,726.7	—	795.1	661.6	—	128.2	133.6	419.6	-871.8	—	871.8	1,291.5	1,276.8	995.7	281.0
2009	1,700.5	2,036.2	60.3	910.1	724.5	64.3	144.3	335.7	571.5	-846.3	—	846.3	1,417.8	1,396.1	1,052.3	343.5
2010	1,957.5	2,387.7	64.0	1,257.8	525.2	68.5	269.3	430.2	766.8	-824.8	—	824.8	1,591.6	1,568.3	1,127.7	434.2
2011 Dhjetor	2,067.8	2,446.0	65.1	1,359.4	230.0	70.1	533.1	378.2	987.5	-798.4	—	798.4	1,785.8	1,785.8	1,242.1	514.6
2012 Mars	2,087.9	2,449.5	63.8	1,179.7	346.9	68.8	580.9	361.6	1,000.8	-788.9	29.9	818.8	1,789.7	1,762.0	1,238.7	521.1
Qershor	2,081.2	2,445.1	66.4	1,257.2	239.1	71.9	598.7	363.9	1,057.1	-801.1	29.9	831.0	1,858.3	1,832.9	1,281.9	548.6
